

HALIL RAMA



SKËNDER CALA

"Mjeshtër i Madh"
në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare

-Monografi, 2019-

Halil Rama

SKËNDER CALA

“Mjeshtër i Madh”

në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare

Monografi

BOTIMET M&B

Tiranë, 2019

Titulli: Skënder Cala, “Mjeshtër i Madh” në gjerdanin
e artë të kulturës kombëtare

Autor: Halil RAMA

Redaktor: Ramazan KICA, *shkrimtar*

Recensentë: Dr. Gidiola HYSA
Sakip CAMI, *publicist & poet*

Korrektore letrare: Dr. Gidiola HYSA

Art grafik: Artemida Arbri Nako

Foto e kopertinës: Arben BICI

ISBN: 978-9928-256-95-9

©: Autori

*Kushtuar Mjeshtrit të Madh
Skënder Caka,
një ndër ikonat e artit
dhe kulturës kombëtare,
në 80-vjetorin e ditëlindjes*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

I jep

ZOTIT SKËNDER CALA

Titullin “MJESHTËR I MADH”

*“Në vlerësim të kontributit të shquar në fushën e regjistrës,
aktrimit dhe muzikës, si një nga përfaqësuesit e denjë të
përcjelljes së vlerave, traditave dhe kulturës së komunitetit
dihëran në mbarë vendin tonë dhe më gjerë”.*

Nr. Dekreti 9469
Tiranë, më 17.03.2016

PRESIDENTI I REPUBLIKËS



Bujar Nishani
BUJAR NISHANI

Pasqyra e lëndës

Në vend të parathënies	7
Prolog.....	11

Një jetë plot sakrifica, me punë dhe pasion

Origjina, familja, tradita.....	21
Mësues; Ndërshenë, F. Lurë, Arras, Tartaj, Vilë, Soricë.....	31
Ajo natë dimri, që i prishi gjumin	36
Në gjimnazin e kuadrove të arsimit në Tiranë	39
Sërish - mësues në Soricë të Dardhës	42
Nëpër udhën e vështirë të artit	54
Student i shkëlqyer në degën dramatike	47
Teatri profesionist, një ëndërr e madhe e dibranëve	51
Nga trupat amatore te teatri profesionist.....	55
Vlerësimi për kolegët që i dhanë emër artit dibran	58
Fejesa dhe ndërtimi i familjes me Ferihanë	65
Kujtime që të dalldisin shpirtin.....	68
Katër vëllezërit Cala	71

Profil

I virtytshmi dhe kurajozi Skënder Cala	77
Kryetar i PR-së dhe Nënkryetar i Këshillit të rrethit	80
Dhimbje dhe lotë.....	83
Një vit në Amerikë.....	86
Shef i sektorit të artit në bashkinë e kryeqytetit.....	93

Libri dhe intervistat për librin

Një intervistë në kohën e duhur	97
Autori i librit “ Magjia e Dibrës”	100

Koha të zbardhi, fisnikëria të dha shkëlqim.....	101
Flet regjisori, aktori dhe këngëtari Skënder Cala.....	112
Mendimi dhe ligjërimi politik i Skënder Calës.....	120
37 premierat që ka vënë në skenë dhe ku ka interpretuar	123

Bashkëkohësit për Skënder Calën

Bujar Kapexhiu	133
Zenel Hoxha.....	140
Neshat Ndreu	142
Dervish Biba	143
Inajet Shehu	147
Zef Çoba.....	151
Hamit Lumi.....	154
Shaban Xhajku.....	157
Ymer Seferi.....	159
Edmond Zhulali	161
Ramazan Kica	163
Rifat Poga.....	166
Mevlud Buci.....	168
Azis Keta.....	171
Namik Selmani.....	177
Besim Ndrejoni	179

Epilog

Dibra e kishte zbutur e burrëruar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë dibranët	184
Curriculum Vitae.....	193
Letër falënderimi.....	197

Në vend të parathënies

Vlerat e Skënder Calës shkojnë përtej kontributit të artit shqiptar¹

Bujar Nishani



I nderuar z. Cala!
E nderuar zonjë!
Të nderuar miq të pranishëm!

Jemi mbledhur sot në institucionin e Presidentit të Republikës, për të vlerësuar punën e palodhur të një artisti të vendit tonë, z. Skënder Cala, një njeri i shkëlqyer, jeta profesionale e të cilit vazhdon të zhvillohet me intensitet edhe sot e kësaj dite.

Kontributi i tij i jashtëzakonshëm për artin tonë kombëtar, vepra e tij, janë një shëmbëlltyrë e pashoqe që ka lënë gjurmë të thella në mbresat e çdo shqiptari dhe jam i bindur që do të vazhdojë të jetojë brez pas brezi, si një dëshmi e artit, kinematografisë dhe folklorit shqiptar.

Arti shqiptar, në fondin e vet, ka shumë artistë të njohur.

¹ Fjala e ish-Presidentit të RSH, z. Bujar Nishani, në cermoninë e dekorimit të z. Skënder Cala, me titullin “Mjeshtër i Madh”, më 17.03.2016.

Midis tyre, patjetër që zë një vend të veçantë edhe regjisori, aktori, këngëitari dhe së fundmi edhe shkrimtari i librit “Magjia e Dibrës”, Skënder Cala.

Zoti Cala është një ndër regjisorët e parë profesionist që hodhi themelet e artit dramatik në qytetin e Peshkopisë, ku në fakt u angazhua fillimisht në shfaqjet teatrale të zonës që në vogëli.

Krijmtaria e tij shumëplanëshe ka bërë që ai të jetë një figurë e vlerësuar e artit shqiptar, e skenës, por edhe e muzikës.

Janë me dhjetëra vepra të ndryshme dramatike të vëna nga vetë ai në skenë, në Shtëpinë e Kulturës, ku Skënderi ishte jo vetëm regjisor i shfaqjes, por në shumë raste edhe aktor kryesor i saj. Kontributi i tij, në pasurimin e artit shqiptar i dha një vrull të mëtëjshëm, jetës artistike dhe krijimit të teatrit profesionist në qytetin e tij, qytet, në fakt, ku lindën dhe u rritën shumë njerëz që lanë gjurmë në muzikën etnike, kulturën, traditën dhe historinë e Shqipërisë.

Kërkesa e lartë artistike, profesionalizmi dhe krijmtaria e tij mjaft e veçantë, ndihmuan që veprimtaritë artistike ku ai përfshihej, të ishin të veçanta dhe çdo veprimtari e ndërmarrë nga ai të sjellë vlerësime dhe çmime të ndryshme kombëtare.

Me personalitetin e tij artistik, Skënderi u imponua në rritjen kulturore të qytetit të Peshkopisë, ku krijoi një shkollë të vlerave dhe shtroi një rrugë që ndiqet edhe sot nga të gjithë artistët, jo vetëm nga ato të Dibrës, por të të gjithë vendit.

Z.Cala!

Aftësitë tuaja artistike dhe jo vetëm, por edhe ato njerëzore, janë shijuar dhe vlerësuar, si brenda edhe jashtë vendit. Dashuria juaj e madhe ndaj artit ka mundur t'i tejkalojë të gjitha vështirësitë dhe ta përhapë këtë pasion gjerësisht, duke kontribuar në organizimin e jetës artistike të rrethit të Dibrës, si regjisor, këngëtar, prezantues, publicist dhe në krijimin e koncerteve të ndryshme.

Ju keni dhënë nga vetja juaj gjithçka mundet të japë një

artist; kohën, mundin, përkushtimin, pasionin, talentin, për të mundësuar kënaqësinë e artit të vërtetë si dhe për të bërë të mundur që kjo formë e të shprehurit artistik të mund të shijohet dhe të ndikojë te jeta sociale e gjithkujt.

Vlerat e Skënder Calës shkojnë përtej kontributit të artit shqiptar. Ai, mbi të gjitha, kontribuoj në zbulimin e artistëve të rinj, i cili, i përgatiti duke ju dhënë shumë nga vetja e tij, në mënyrë që ato të ishin të përgatitur për të konkuruar në skenën e artit shqiptar por edhe më gjerë. Dhe sot, ata, duke ecur në hapat e mjeshtrit të tyre, profesorit të tyre, kanë një emër në jetën artistike si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Natyrisht, që kur flet për një artist fokusohesh dhe ndalesh te vlerat artistike, te pjesa e krijmtarisë, por, një njeri me arritje të tilla, kontribute të tilla artistike dhe profesionale, nuk mundet kurrsesi të jetë i tillë pa dimensionin njerëzor, pa dimensionin intelektual, pa dimensionin atdhetar, pa dimensionin familjar, pa dimensionin shoqëror. Ndaj unë besoj plotësisht që në personalitetin e Skënderit, si artist, si njeri, kanë ndikur dhe kanë ndihmuar të gjithë aktorët dhe individët që e kanë njohur atë në jetën familjare, shoqërore, profesionale, qytetare dhe kombëtare.

Ndaj sot, dëshiroj që në rastin e vlerësimit dhe shprehjes së mirënjohjes ndaj Skënder Calës, ti bëjmë një nderim të gjithë familjarëve të tij, miqve të tij, bashkëpunëtorve të tij, bashkëkombësve të tij, me të cilët ndau vështirësitë e tij, ndau pasionin, ndau mendimin, ndau profesionin dhe se bashkë me ta, ofroi kontributin për vendin, kulturën, për të sotmen dhe të ardhmen. Kështu që dëshiroj një falenderim të përbashkët, mirënjohje të përbashkët për Skënderin dhe të gjithë ata që ishin pjesë e këtij suksesi dhe e këtij rrugëtimi, i cili do të vazhdojë ende në pritshmëritë tona, në dëshirat tona, në interes të kulturës, në interes të jetës, në interes të përparimit dhe zhvillimit të shoqërisë dhe vendit tonë.

Për këto vlera të treguara ndaj artit shqiptar, për

dimensionin e tij njerëzor intelektual, për kontributin e vyer në krijmtarinë artistike dhe folklorike, sot kam kënaqësinë t'i akordoj **titullin e lartë, “Mjeshtër i Madh”**, i cili besoj që është një vlerësim domethënës për punën e tij të palodhur, një inkurajim për vijimin e mëtejshëm të këtij angazhimi dhe një mirënjohje e tërë për plejadën e të gjithë atyre që kanë përfituar nga aktiviteti, nga puna, nga djersa, munda dhe pasioni i Skënderit.



Presidenti Nishani duke i dhënë z. Cala dekoratën me titullin “Mjeshtër i Madh”, më 17.03.2016.

Prolog

Skënder Cala, i magjepsur nga “Magjia e Dibrës”

• *Si shpëtoi artisti pas tre incidenteve që i kurdisën ish-agjentët e Sigurimit të Shtetit?!*

• *Kur i doli e drejta e studimit dhe po vinte për në Tiranë, u betua se do ta rrallonte rrugën për në Dibër, sepse dega që kishte zgjedhur kërkonte punë, prova e studim. Por Dibra, sado të mundohesh për t’iu larguar, ajo t’i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare. Dibra ishte si një dashuri klandestine, që vjedhurazi të pushtonte mendjen e zemrën dhe dalëngadalë të mbërthente plotësisht duke të bërë për vete.*

Qyteti i Peshkopisë, nga dibranët, por dhe nga të ardhurit e shumtë prej rretheve të ndryshme të vendit, njihet si *qyteti i blirëve*. Ai njihet për atë bulevardin me blirët e famshëm anash, nga ku dekada të tëra gjithë qyteti merrte frymë e jetë nga një copë udhë e asfaltuar, ku nga njëri krah në tjetrin ishin rreshtuar politika, ideologjia, burgu e dajaku, ekonomia e financat, bankat, institucionet kulturore, teatri, estrada, kinemaja, teatri i kukullave e gjimnazi...

Sot, pas më shumë se tre dekadave, njëri nga intelektualët e njohur dibranë, që ka lënë gjurmë në themelimin dhe konsolidimin e institucioneve kulturore, artisti i mirënjohur Skënder Cala, shpreh dhimbjen për bulevardin e qytetit të Peshkopisë, tashmë të lodhur, që po plaket çdo ditë e më shumë...

Ky rrënim ka nisur pikërisht atëherë kur dinjiteti i njeriut shtypej e poshtërohej nga qëndrimi prej bajraktarësh i pushtetarëve, që, të veshur me pushtet nuk ndaleshin para asgjëje, në emër të ligjit partiak e ideologjisë proletare. Regjisori, këngëtari dhe aktori i roleve në disa filma e teatro e

ka provuar vetë trysinë e atij pushteti makabër. Pikërisht në sallën, fare pranë “bulevardit të blirëve”, për të cilin sot ndien dhimbje, para tri dekadash iu bë “gjqin në kolektiv”, sepse sigurimsat kishin sinjalizuar lart se “Skënder Cala shikon çdo natë në televizor stacione të huaja, duke iu kundërvënë hapur vendimit të Komitetit të Partisë së rrethit për zhdukjen e antenave televizive”. Nomenklatura e asaj kohe ishte shqetësuar dhe po i bënte gjyqin në kolektiv, për të përcaktuar se çdo të bëhej me këtë njeri të pabindur që shkante kundër rrymës?!

E mbrojtjën artistin e qindra roleve të spikatura, Artisti i Merituar Hazi Ndreu, ish-drejtori Adil Shehu dhe kolegu Abdyl Sturçe, mbrojtje kjo, që i detyroi të dërguarit e nomenklaturës të largoheshin me bisht ndër shalë...

Kështu kishte ndodhur me Skënder Calën edhe pas debatit të tij me ish-ministrin e Energjetikës, Farudin Hoxha, si i deleguar në një mbledhje të Këshillit të Rrethit Dibër, kur me kurajo civile e intelektuale kishte denoncuar projektet e apartamenteve të atëherëshme, nga ngushtësia e të cilëve, qytetarët ishin të detyruar të zhvisheshin që në sallon e të kërcenin si kinezët, direkt e në krevat. Këtyre “incidenteve”, si dhe atij të korrikut '65, kur e përjashtuan nga aksioni i parë i rinisë studentore sepse kishte mbrojtur shokët që një të shtunë ishin larguar nga aksioni në *fermën Hamallaj* dhe kishin shkuar në Tiranë të laheshin e të bëheshin gati për të hënë, ai u shpëtoi falë zgjuarsisë prej dibrani të sprovuar. Ato vite ishte stërholluar lufta e klasave dhe veçanërisht shtrirja e veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit, në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare dhe kishte krijuar një gjendje terrori në gjithë vendin... Këtë terror e ka përjetuar me ankth edhe S. Cala, që si artist ka interpretuar mjeshtërisht role në flimat “Guximtarët” (me partner “Artistin e Popullit” Sandër Prosi), “Kërcënimi” përkrah Rajmonda Bulkut e Stavri Shkurtit, apo dhe te “Çeta e Vogël”, ku pati rastin të ketë partnerë aktorët e mëdhenj

Ndrekë Luca e Marie Logoreci. Por, bashkëkohësit e mbajnë mend Skënderin edhe te filmi “Skënderbeu”, kur në moshë krejt të njomë gjendet mes dhjetra fëmijëve, grave e pleqve, i veshur me lecka si malësor i vogël, në atë mori flakësh, britmash e ulërimash prej tmerrit të turqve...

Në rrugën drejt artit, mes dy dashurive të mëdha

Skënder Cala e nisi rrugën drejt artit, mes dy dashurive të mëdha, Korabit hijerëndë e kreshnik dhe Drinit plak, që e kishte zbutur e burrëruar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë Dibra dhe dibranët. Ai kujton vitet kur turrej me tersëllimë nëpër zabelet e Përroit të Madh, kur kalonte dushqe, kërcunj, lisa, kanale, prita e porene arash dhe ndjente mbi shpinë grahmën tërbuese të egërsirave.

Ashtu si Qatip Cala, i cili si i lidhur me historitë e fisit, atë që dinte e hodhi në librin e tij “Në kërkim të një fisi”, edhe Skënderi kërkon që njerëzve e ngjarjeve t’u vendosë emër, që të mos mbeten anonime, si mjaft gjëra të papërsëritshme në historikun e fiseve...

Për herë të parë, kur sapo kishte mbaruar klasën e tretë, filloi të dëgjojë *jaren shkodrane*, ta mësojë e këndojë atë. Këngët: “Për mue paska qenë kismet”, “Pra në kjoftë kjo e vërtetë”, “Kalaja e Shkodrës”, “Dalin vajzat prej mejtepi”, etj, u futën në repertorin e tij me tekst e muzikë origjinale, që në fëmijërinë e tij, kur s’i shkonte ndërmend se do të bëhej këngëtar...

Fare i ri, 15-të vjeç, ai do të shërbente si mësues në shkollat fillore të Reçit e Dardhës, nga ku mësoi me zell filozofinë dibrane. Kur futej nëpër zabele, këngët e bilbilave, trumcakëve e laureshave e çonin peshë shpirtërisht dhe ndjente sikur rritej orë e çast, bashkë me ritmin e tonalitetin dhe tingujt fantastikë të atyre mjeshtërve, që Zoti i kishte krijuar për të hijeshuar natyrën e për të zbutur egërsinë e jetës... E tërhiqnin veshjet e

krahinës së tij që janë me larmi formash e kolorit ngjyrash, ku dhe puna artistike që është përdorur për realizimin e tyre është shprehje e shpirtit krijues të nënave, motrave, nuseve e vajzave tona, të cilat, kanë derdhur në këto veshje artin e papërsëritshëm të popullit. Po ashtu mahnitej nga veshja e burrave prej koporaneve dhe tirqtë e zinj, brezit të mesit me një pafundësi ngjyrash, ku e zeza, e kuqja dhe e bardha bien më në sy..., nga çorapet e leshit të burrave, të thjeshtë ose me midiskame, me kolor ngjyrash dhe figurash të ndryshme me yje, lule, rrathë, trekëndësha, me vlera të veçanta artistike...

Me përshkrimin e veshjeve që përdornin malësorët e Dardhës, Skënder Cala të krijon përshtypjen se “malësori pa kësulë, tirq e koporane, pa çorape leshi e opinga me norta, nuk mund të ketë ato vlera burrërore që jemi mësuar të shohim në qënien e tij. Këto elementë sikur e kompletojnë atë, i japin vlera më burrërore, e bëjnë më të pranueshëm në sfondin e legjendave të maleve, bëmave dhe ngjarjeve të historisë... Duke argumentuar institucionin e shenjtë të burrave në kryet e vendit, z. Cala arrin në përfundimin se “dibranët janë një specie e veçantë, sepse, sido që të vijë puna nuk e prishin shtëpinë e tyre.

Të mençurit, ata që e stërhollonin fjalën duke e përpunuar në laboratorin e inteligjencës dibrane, dinin që t’i vendosnin gjërat në vendin e tyre; vlerësonin dhe burrat që kishin me vete peshoren, metrin, dhe kunjin e mprehur në të dyja anët...”. Në këtë kontekst e rendit ai përkuqdesjen e Hazis Ndreut, porosinë e tij për kujdesin që duhej të tregonte për zërin, që ta ruante atë se e kishte pasuri që ia kishin dhuruar nëna e baba. “Mësoi këngët e Dibrës, se janë flori, kanë melodi të bukur dhe tekste përrallore...”. Kështu i dukej Hazisi, edhe muzikant, edhe poet, edhe i ditur.

Rrugës duke shkuar për në Vilë, ku ishte mësues, filloi të thurë ëndrra në mendjen e tij prej të riu. E shihte vetën nëpër skena, duke kënduar si *Hozelito i vogël* te filmi “Dëgjoni

këngën time”.

Hazisi ia kishte futur keq fitilat si Sheherezadja, që çuditi mbretin e Persisë në “Njëmijë e një netë”. Ideja e Hazisit për të përvetësuar foklorin e popullit e tërhoqi shumë. Ai e dinte se dernjani sa bie prej djepi e gjer kur bëhet gati për të shkuar n’atë botë, kërcen... Ëndërronte si muzikantët më të mëdhenj të botës, si Bah, Bethoven, Verdi, Puçini, Moxarti, të cilët ishin ulur këmbëkryq në shpirtin e popullit dhe kishin marrë prej tij nektarin e këngës popullore...

Gjimnazisti i shkëlqyer i gjimnazit të kuadrove të arsimit

Më pas do të ishte gjimnazi i kuadrove të arsimit në Tiranë, shkolla që e përgatiti S.Calën si mësues me njohuri e dije shkencore, dhe nga ana tjetër, nxorri në pah dhuntitë e talentin e tij për t’u marrë, veçanërisht, me futbollin dhe rrethet artistike, sidomos me këngën.

Me repertorin e tij muzikor, u mor vetë drejtori Riza Hajro që kishte mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, që e njihte muzikën ruse mjaft mirë, këndonte me pasion dhe kishte dëshirë të interpretonte bukur...

Në një konkurs final me shkollat e kryeqytetit, Skënderi ka kënduar dy këngë “Azerbajxhani ynë” (e kënduar nga këngëtari Reshit Bejbutov) dhe “Kënga e dashurisë së parë”. Krahas këngëve ruse, repertorit të tij iu shtuan edhe këngë italiane, sidomos ato napolitane. Për të ishin mjaft të dashur këngëtarët italianë si: Domenico Modunjo, Klaudio Vila, Pepino di Kapri, Luçiano Tajoli. Por, ato që e mahnitnin dhe e linin pa gjumë gjithë natën ishin këngëtarët operistikë, Mario Delmanok, Henriko Karuzo dhe më vonë Luçiano Pavaroti e Plaçido Domingo. Ndërkohë, filloi të magjepsej pas zërave të bukur të Llukë Kaçajt, Mentor Xhemalit, Avni Mulës, Ramiz Kovaçit, Stavri Rafaelit, Kristaq Antoniut dhe Gaqo Çakos. Gjithësesi, adoloshenca e tij, si dhe e qindra e mijëra

bashkëmoshatarëve, u shtyp nga trysnia e halleve. Më vonë, kur u burrërua dhe mori rrugën e vërtetë të artit, duke u bërë artist i skenës si këngëtar, aktor e regjisor, e ka takuar si mik të paharruar Riza Hajron, i cili për erudicionin kulturor e artistik që zotëronte, u bë drejtor i Teatrit Kombëtar dhe më vonë drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit...

Ditën që mbaroi gjimnazin dhe mori në dorë dëftesën e pjekurisë, ndjeu sikur një ngërç i madh ia pushtoi të gjithë trupin dhe iu duk vetja si i paralizuar, sepse ëndërronte Tiranën, ndërkohë që do t'i duhej të endej nëpër malësitë e Dibrës, duke ndërruar shkollë një herë në gjashtë muaj apo çdo vit, për një copë bukë. Por, gjithësesi, ato vite i shërbyen për të mësuar gjuhën e veçantë të dibranëve me shifra e kode, që gosdiste me pambuk, por therte gjer në palcë, mjeti artistik i të cilëve ishte humori që përdornin, i cili në esencë kishte një dramacitet e tragjizëm të thellë, që digjte e përvëlonte si zjarr.

Suksesi i parë si profesionist me shfaqjen
“Të fala nga Korabi”

Duke shfletuar jetën e tij në udhën e vështirë të artit, Skënderi kujton kohën kur nga Sorica e largët, ku shërbente si mësues, shkon në Peshkopi si këngëtar në Estradën e qytetit. Kujton repertorin e tij të parë muzikor që përbëhej nga këngët “Shkurta e Hoklit”, duetin “Kufitarët” me Muharrem Zajmin dhe këngën e “Hatixhes”. Ai kujton me nostalgji duetin e parë me këngëtares e mirënjohur Melita Shehu, me këngën “Ma ke gishtin për unazë”.

Djali i ri nga Lugjejt e Zall-Dardhës kishte një vokal të pastër dhe arrinte në nota tenori, pavarësisht se ishte bariton. Të gjithëve u bëhej qejfi, por veçanërisht Hasis Ndreut që e kishte prezantuar si këngëtar dhe Tonin Rrotës, i cili si kompozitor shpresonte të bënte punë të mira me të. Dhe këto “punë të mira” u dukën fare qartë në turrneun më të gjatë e të

suksesshëm të Estradës Profesionte të Peshkopisë, në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë, në maj të vitit 1961, me shfaqjen “Të fala nga Korabi”.

Në Institutin e Arteve shkoi i burrëruar, ndoshta më i pjekur se shumica e studentëve të kursit të tij. Asgjë s’i mungonte që t’i përkushtohet shkollës dhe profesionit të bukur, por të vështirë të aktorit. Fati i madh ishte për të që këtë kurs e drejtonte udhëheqësi artistik Kujtim Spahivogli dhe pedagogët Naim Frashëri, Pjetër Gjoka, Mihallaq Luarasi dhe Prokop Mima.

Kur i doli e drejta e studimit dhe po vinte për në Tiranë, u betua se do ta rrallonte rrugën për në Dibër, sepse dega që kishte zgjedhur kërkonte punë, prova e studim. Por Dibra, sado të mundohesh për t’iu larguar, ajo t’i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare. Dibra ishte si një dashuri klandestine, që vjedhurazi të pushtonte mendjen e zemrën dhe dalëngadalë të mbërthente plotësisht duke të bërë për vete.

Ndaj, në shenjë respekti për artistët që në vite krijuan dhe ekzekutuan me mjeshtëri artin dibran, dhe si një gur diamanti e vendosën atë në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare, Skëndër Cala shkroi dhe botoi librin “MAGJIA E DIBRËS”, i mirëpritur nga lexuesi dibran e më gjerë.




Skënderi, fëmijë




Feri, në Lugje



Zogisti Selman Cala, 1938



Selman Cala



Jahe Cala

- I -

Një jetë plot sakrificë, me punë dhe pasion



Feri me nipin



Selmani, Hajrija, Skënderi, dhe Beshiri i porsalindur

Origjina, familja, tradita...

Atë vit që ikën nga Tirana dhe u vendosën në një fshat të thellë të Dibrës, në Lugjej, Skënderi ka qenë fëmijë i rritur. E vuajti shumë ikjen nga kryeqyteti dhe s'po mësohej të përshtatej me vendbanimin e ri.



Lugjej, trojet e të parëve të Skënderit

Në kujtesën e tij është ngulitur si “parajsa e re”, vendi ku i kishte vendosur baba, një përrua i thellë mes dy kodrash ku zhurmonte uji i Gjordes dhe dallgëzimi i kreshtave të lisave të vjetër.

“Shtëpia e re ku ishim strehuar, ishte një kullë e moçme me dy kate, me gurë të rëndë e të mëdhenj, sa një bojë njeriu, që ishin nxirë nga pluhuri dhe tymnaja e viteve pambarim. Në këtë ngrehinë të stërmadhe e të stërvjetër kalonim ditët dhe netët me kokat kthyer nga trarët e nxirë të dushkut dhe gurët e çatraveshur të mureve, të cilët sterronin nga nata e zezë. Flakët e një lllambe me vajguri dhe të një kandili që ishin ngulur në

faqe të mureve, krijonin ca shëmbëlltyra të frikëshme në mur, të cilat na kishin tmerruar”, - rrëfen Skënderi. Më tej, ai kujton me detaje, çastin kur ra të flinte, i kruspulluar pas nënës, mbuluar me jorgan e batanije, ku mezi e zuri gjumi. Pikërisht këtu do t’i duhej të kalonte një fëmijëri të vështirë.

* * *

Në vitin 1954, kur ikën nga Tirana, ku kishin lindur e ishin rritur, Skënderi, vëllezërit e tij, Beshiri e Petriti, si dhe motra e vetme, Ganimetja, Përroi i Madh ku u vendosën përfundimisht, u dukej si stacion i fundit që i ndante me jetën, dritën, të mirën e të bukurën. Nëna e tyre, Hajria, me origjinë nga Shkodra, lindur e rritur në Tiranë, e kishte bërë kryeqytetin lanet dhe kishte ardhur mbas burrit, Selmanit, për të krijuar një jetë të re, edhe pse vendin ku kishte ardhur e njihte prej vitesh. Nëna nxinte dhe qante. Ndërsa fëmijët e saj, s’dinin ç’të bënin.

Skënderi Cala, fëmija i madh i familjes, i ka të ngulitura në memorie ato kohëra kur: “Dita edhe kalohej duke u ngjitur e zbritur si majmunë nëpër lisa, duke thirrur, kënduar e bërtitur kot së koti si banorë të fiseve të egra nëpër xhungël, por nata ishte e padurueshme. E gjithë kulla dykatëshe ishte e pandarë. Trarët nxinin nga tymi e bloza, ku lala Mersim, vëllai i Jahes, kishte lyer me ngjyrën e zezë gurë, drurë, baltë, tjegulla, me tonelata lisash të prerë nga zabelet përreth. Flakët e qirinjve, të kandilit e llambës së varur nëpër kunjat të ngulur në mure, ngjanin me sfondin e varrezave”.

Nëna nxinte, nëna qante, nëna mallkonte.

Baba i ulur në një qoshe, këmbëkryq, shikonte nënën dhe thoshte: “Po mos u mërzhit, oj grue, se ma mirë do të bëhet.”

Optimist për nga natyra, ai zbutej, qeshte si fëmijë. Kur qëllonte që të shkonte mysafir ndër miq, në ndonjë dasmë apo mort, në kthim miqësie për fejesa etj, fëmijët e tij mbeteshin

vetëm, si tufa e deleve mes shoqërisë së ujqërve.

Shtëpia mes pyllit ishte e bukur për poezi e ndjenjë turistike. Bukuria e rrallë e atyre trojeve në mes të përroit të Madh, ku frynin erërat e Korabit e depërtonin prej Lisivalles në pyllin e Gjordes, në Shulla e Leknat e Pirës, përplasen në Drinin e Zi, duke krijuar një pështjellim të ashpër, që ngrinte ujët përpjete të Bunari i Xhafer Lucës.

Më i madhi i familjes ishte Skënderi dhe në një farë mënyre nëna komunikonte me të për çdo gjë, sidomos që të zbatonte urdhërat e saj për të mbushur ujë te rrasa e Dikës, për të mbledhur dru e krande për gatim dhe punë të ndryshme, që kishte shtëpia. Skënderi mundahej t'ia lehtësonte dhimbjen dhe vuajtjet nënës, që kishte lënë nënën, motrën, vëllanë e farefisnin në Tiranë dhe kishte ardhur në këtë vend të zymtë për të ngrysur vitet e gjata të jetës, kur sapo kishte kaluar të tridhjetat.

Si pa dashje, nëna, duke dashur të nxjerrë dufin që e kishte pushtuar se s'ishte e lehtë të mësohej me punët e një amvise fshati, si të milte lopën e dhitë, të tundte kosin, të ndante bulmetin nëpër sheka², të hidhte farën në arë, të mbillte kopshtin, ta prashiste, ta plehëronte atë e ta vadiste, që toka të mbetej e lagësht e perimet e freskëta, të mblidhte fasule, të priste e vilte misrin etj, po bëhej edhe një mësuese për Skënderin, Beshirin, Petritin e Ganimeten.

Por edhe babai i tyre, Selmani, ishte punëtor i madh. Duke punuar ditë e natë, kryesisht vetë, por edhe me argat, sistemoi tokën dhe vuri një grusht bagëtish. Sidomos, suksese pati në mbarështimin e lopëve, mbolli pemë të reja me fidanë të blerë në shtet, sidomos mollët “Belfior”, “Gold”, “Starking”, “dardha verore” etj.

Ndërsa nënë Hajria, megjithëse nuk ua dinte mirë punëve të bujqësisë, së bashku me Skënderin e me ndihmën e kunatës (nuses së Vexhiut), ndërtuan një kopësht model, ku veç

² Shekë - enë druri.

qepëve, specave e domateve mbollën për herë të parë në atë zonë pjepër, shalqin, bishtaja, bamje të cilat dhanë prodhime të mbara dhe gjithë fshati filloi të fliste për kopështin e tyre.

Përroi i Madh filloi të gumëzhinte nga zërat e jetës. Shokët, farefisi, vëllazëria shkonin e vinin çdo ditë, takoheshin me Selman Calën, jepnin e merrnin, shkëmbenin mendime për punën e jetën e re. Oda e miqve nuk mbetej bosh, netëve të gjata të dimrit, sepse nata i grishte për të ndarë gjysmën e lekut me muhabet Dibre. Dalëngadalë, me kalimin e 2- 3 viteve të para, përroi i Madh u bë edhe për fëmijët e Selman Calës një oaz shprese e gëzimi, ku filluan të ndjenim romantizmin e fshatit, bukuritë e pyjeve e zabeleve, u përshtatën me punët e fshatit, aromën e ugarëve pas shiut të verës, të barit dhe jonxhës së thatë.

* * *

Udhën, që gjarpëronte mes kepave poshtë arës së Abaz Calës e lanë prapa, e sa çel e mbyll sytë iu ngjitën termalese të egër, poshtë shtëpisë së tij. Kur u afruan pranë kopshtit, iu duk se iu këputën gjunjët. Ç'kishte ndodhur vallë? A thua Zoti e kishte parë të udhës të ndryshonte pozicionin gjeografik të trojeve të tij, duke i vendosur në një pozicion të pambrojtur si koka e zbardhur e një rekruti?

Lisat buzë udhës, që të çonin drejt përroit, ishin prerë e rrafshuar baras me tokën. Pjergullat e rrushit "Thanz"³, që vareshin nëpër degët dhe trupin e lisave që i kishin prerë, ishin shtrirë përdhe duke u shkarravitur deri poshtë në mejën e kopshtit. Ferrat kishin dalldisur si zabel, ku kishin lulëzuar

³ "Thanz" quhet varieteti "Afuzali" i rrushit, që bën pjesë të "Kultivarët për tavolinë" (për ngrënie, ose për konsum të freskët).

kumbulla të egra, e rrush Larush, si për të thënë se ky vend i tillë ka qenë dhe kështu do të mbetet gjithmonë.

Shtëpi s'kishte, as bahçe jo. Kumbullat e ëmbla, dardhat, mollët e rrushi Amerikan para oborrit të kullës kishin dhënë shpirt. Qershitë e manat në mes të arës me jonxhë, poshtë shtëpisë, ku hanin gjithë katundi, ishin prerë gjithë inat, duke mos lënë *nam e nishan*.

- Mo' o Zot, ma keq s'mund të bëhet - foli si nëpër dhëmbë Skënderi e dy pika loti i shkuan përfaqesh e u shuan në tokën e djegur.

Askush s'i priti, askush "njatjeta" s'u tha, as fjalën "Bujrum" se dëgjoi, ndoshta për herë të parë në trojet e të parëve të tij.

Për çudi, vetëm një rrënjë trëndafil, sa një bojë njeriu, me një gonxhe erëmirë në ngjyrë të kuqe, hijeshonte oborrin e shkretë.

Ndoshta, ishte Selman Cala, ndoshta Hajria, apo ndoshta shpirti i babës dhe nënës së tij ishin shkrirë në një trëndafil si për t'ju uruar mirëseardhjen.

E këputi atë trëndafil, e mbështolli me një letër të butë dhe e futi me kujdes në xhepin e brendshëm për t'u çmallur çdo çast me prindërit e tij.

- Feriha, - i tha gruas, - hape çantën se do të hamë bukë! Dhe, siç ishte, u ul në tokë. Ashtu bëri edhe Safeti, nipi i tij dhe gruaja. Nga çanta nxori kanoçet me "Coca Cola" dhe gotën e tij e përplasi me trëndafilin: Gëzuar, Selman, gëzuar Hajrie!.. Dhe e derdhi gjysmën e lëngut të zi në tokën e zezë.

Dheu e përpiu lëngun e ëmbël dhe në çast iu kujtua babai, kur hante petë me lakra, hithra, apo gjethe preshi.

Dhe kujtimet marrin udhë.... Skënder Cala i rrëfen ato mjeshhtërisht, siç i ka të ngulitura në memorie.

"Nama at' mashtrape, oj grue, se u dogja", i thoshte nënës e duke e ngritur gotën e mbushur me dhallë, menjëherë ndjente kënaqësinë e shuarjes së etjes. Një "Oh" e gjatë shkrihej në

gurmazin eshkë të babait dhe atëherë ndihej i çliruar nga sikleti, që të jep etja, - kujton Skënderi.

Nëna, një shkodrane e thekur, lindur e rritur në derën e fisit Rada, me emër në Drisht e Postribë, me humorin e saj të hollë e ngacmonte shpesh babën e tij, të cilit i fliste në emër, kurse Ai (baba) gjithmonë i thoshte “Ej” ose “Oj grua”!...

Babai, kur hante bukë, dimër apo verë qoftë, i shkonin djersët çurkë. Nëna, që e respektonte shumë të shoqin, kishte qejf t’ia ngrinte nervat në qiell babës, sepse atëherë ai bëhej më i lezetshëm e nxirrte qyfyre nga goja.

- Ofshe, or Selman, u sose krejt. Djersë në kooperativë, djersë në mexhlise e në katund, djersë edhe tue ngranë bukë.

- Po unë jam i gjallë dhe jo i vdekun! Të gjallët punojnë, ecin, flasin, djersitin. Prandaj, vdekja ka frikë me u afrue se s’kam mish e tule, por vetëm kocka. Ej, jam biri i së keqes unë, oj shkodranel!”

Kështu i mban mend “babën” e “nanën” Skënder Cala, që atëherë kur vunë këmbën në oborrin e kësaj kulle, pasi u shpërngulëm nga Tirana, në vitin 1954 e gjer në ditët e fundit të jetës, kur ata përcillnin njëri-tjetrin në atë botë...

* * *

Rruga që lidh përroin e Gjordes me qarrin e Rrahim Pirës dhe zabelin e Trajshës, mbuluar me lisa të fortë e të moçëm, quhet “Trojet e Përroit të Madh”.

“Den-baba-den”, aty kanë qenë dy troje, njëra e Rexhë Calës te Lama dhe tjetra te “Bahçja e vjetër” e Hazis Calës.

“Përroi i Madh” është banuar vonë, në kohën e stërgjyshit të Skënderit, Selman Cala i Parë.

Fisi i Hasanallarëve (Hasanagjej) ka qenë vendosur në Xhoxhaj, ku kishte ngrehë kullën edhe Selman Cala me të bijtë e vet, Rexhën, Hazizin, Beshirin, dhe më të voglin Ramadanin.

Toka në Xhoxhaj ishte e pakët dhe në brinjë, e cila nuk jepte ndonjë prodhim të lakmueshëm. Shtëpia mbahej më shumë me bagëti, sidomos dhi, të cilat i përshtateshin terrenit të thyer dhe me dushk.

Selman Cala i Parë kishte pasë shok veten dhe për kollaj nuk ta lëshonte udhën. Luftëtar i dorës së parë, por pleqëria e kishte lënë në furrë të zjarrit, por disa cilësi burrërore akoma vegjetonin në shpirtin e atij plaku.

Tregojnë, se kur i vinin mysafirë e kafeja ishte sosë merrte tunin e sëpatës e ia çonte tuxharit, duke i thënë: - “Bjer një okë kafe, or Tuxhar dhe sëpatën mbaje si peng, por dije se s’ta kam shitur! Kur të vinë djemtë, merr paret e kthemë sëpatën!”

Miqtë e Selmanit ishin sojli. Për punë burrash të ndodheshin gajt (afër). Me Xhedikun kishte pasur dy herë miqësi, kishte marrë motrën e Xheledin Xhedikut për Hazis Calën, të birin dhe kishte dhënë vajzën te Xheledini. Kësaj miqësie i erdhi era barat sepse dajat e nipi i tyre u lidhën në të keqe e veç varret i ndanë.

Sufë Xhediku, Him Xhediku e Halit Xhediku, djemtë e Xheladinit dhe Jahe Cala, djali i Hazizit, ishin katër trupa e një shpirt. Kur mortja i ndau këto burra, deri në të mbramen frymë, dashuria e të vdekurve (dajallarëve) për nipin e derës u zëvendësua nga Halit Xhediku, djali i tretë i Xheladinit, i cili mbeti gjallë.

Miqësinë e Selmanit me derën e shkëlqyer të Bajraktarit të Kalisit, Can Rexhën, e lidhi dashuria dhe respekti, për nishane të burrërisë. Kanë kaluar afro 120 vjet, kur Can Rexha i thotë Selman Calës:

- O Selman, kam qejf të bahemi miq, si thue?
- Qoftë i hajrit ai dekit, por i kemi torbat bosh, s’kemi djalë e vajzë për t’i fejuar.
- M’kanë thanë gratë, - vazhdoi Cani, - se e ke renë me izër (shtatzënë).
- Nuk të kanë rrejtë, - u përgjigj Selmani, - ene ti e ke një

re me izër.

- Ene ty nuk të paskan kobitë, - foli Cani flakë për flakë.

- Po dëgjo, or Selman Cala. Këtu, në zarmin e shtëpisë seme po t'i thom dy llafe.

- Fol, or Can, se i kam veshët e shpue.

- Kur të plasin këto torbat (kur të lindin nuset), po pata unë cucë e ti voc, mos hajde me e lypë, se ta kam dhanë. Po lindi reja jote cucë e djali im voc, mo ma luj llafin, or Selman, se ajo është për derë teme.

- Hajrli qoftë or mik!

- Kafet!, - briti Cani, - t'i presim denamën e për hajër miqësia!

S'kaluan dy muaj e në derën e Bajraktarit lindi Adem Rexha, kurse reja e Selmanit, lindi vajzë, Xhemile Calën. Kur mbushën moshën, ata që ishin fejuar barrë në bark, u martuan e kaluan një jetë të tërë bashkë deri në vdekje. Ajo miqësi vazhdon. Qatip Cala, i ka dhënë nipit të Canit Islam Bajraktarit, vajzën për re. Nga kjo miqësi, bajraktarit i lindën katër djem e një vajzë dhe miqësia e nisur njëqind vjet më parë vazhdon e pastër, si atëherë, por ka ndryshuar vend, sepse nga Dibra e Luma është transferuar në Tiranë.

Nga Çidhna e muhabetit dhe e mendjes inteligjente, Selman Cala bëri miqësi me fisin e Totës. Atje ai mori nusen për Rexhë Calën. Dije Tota u bë shpejt gruaja burrëreshë, që mbante mbi shpinë rregullin, pastërtinë, gatimin, edukimin dhe rritjen e fëmijëve, pse jo, mendjen e zgjedhur.

Kishte pas fat Rexhë Cala me çidhnaken. Edhe kur ai ishte në luftë, përkrah forcave të kolonelit Tomson kundër ushtrisë rebele të Haxhi Qamilit, edhe kur luftonte në krah të Elez Isufit, si roja e tij personale, kundër forcave serbe edhe kur i lodhur dhe i dërmuar nga jeta e rrebeshi i luftërave dha shpirt, shtëpia e tij mbeti e hapur për miqtë. Djemtë e tij Hasani e Vexhia u rritën pa e ndjerë mungesën e të atit, sepse Dije Tola u bë nënë e babë për ato.

Djali i tretë i Selmanit quhej Beshir, me profesion terzi (rrobaqepës). E donte shumë Selmani këtë djalë, se ishte punëtor i madh dhe i pafjalë. Ndërsa Hazizi ishte punëtor më i madh sepse ai s'ndalej duke hapur tokë të re, duke filluar nga Thatina, rrafshet e Mëdha, ara e Hisës, Rrahu tek ara e Urovit etj. Siç na thoshte baba, tokat më të mira i hapi lala Haziz, i cili të kishte jetuar edhe pak, do t'i kishte rrafshuar kodrat e do t'i mbushte përrenjtë, duke i bashkuar me rrafshet e Mëdha, por exheli ia preu krahët atij, e ndoshta riskun edhe ne.

Beshiri plotësonte nevojat e shtëpisë me blerje bereqeti e ushqimore, veshje për burrat gratë e fëmijët, përmbushte kërkesat e të zotit të shtëpisë për miqtë që vinin shpesh, por edhe shokët e vëllazërinë.

Selman Cala e fejoj Beshirin me Ahmedije Pirën në Lugje, një derë e fisme, me prejardhje nga Tartajt e Dardhës. Shumë e shkurtër qe dashuria e këtyre dy të rinjve, të cilët pas dy vitesh martese vdiqën rresht, njëri pas tjetrit, duke lënë vetëm një djalë, Selmanin, i cili u rrit jetim nga nëna e Jahes, Mihane Xhediku.

...Dhe duke rrëfyer për të parët e derës së tij, Skënder Cala vijon: “Baba ka pasur një kushëri të parë (nënat motra) me Mustaf Ndreun, djalin e Hysen Ndreut të Dardhës. Ata janë dashtë shumë me njëri-tjetrin dhe përngjanin nga portretet, duart dhe sidomos nga shpirti i dhimbsur dhe bujar që kishin të dy.

- Shyqyr, or kushëri, që ajo tezja jote më bani mue, vrej k e vrej k, se për pak qe tue mbetë pa kushëri, - i thoshte baba Mustafës.

I fundit i derës së Selmanit qe Ramadani, djalë mjaft i zoti dhe i shkathët. Ai shkante e vinte shpesh në Shehër të Dibrës për të blerë drithë. Pothuajse, pas çdo dy muajsh ai shkarkonte 2-3 kuaj me drithë në shtëpi. Kishte aftësi për t'u lidhur me njerëzit e për të krijuar miqësi e shoqëri. Në Shehër, Ramadani bëri mik Strazimirin, një fis me merita të rralla për nga mendja,

urtësia e trimëria.

Kulmi i dashurisë e respektit që atëherë, kur Strazimiri dërgoi si dhuratë dy mazerka Turqie në Dibër të Poshtme, njëren për Sufë Xhelilin e tjetrën për Ramadan Calën. Ramadani pati afër vdekjen, e cila i erdhi në moshën 22 vjeçare dhe s' e la që të martohej.

Selmani do të kishte dashtë një mik, ndoshta edhe në Shehër të Dibrës, por që babë i pa fat.


* * *

Duke mos pretenduar të shkruaj për prejardhjen e derës së Selman Calës, as për historikun e familjeve që rrjedhin prej tij, shpirti i pezmatuar nga trojet e mbetura shkretë, ku edhe qeremitet, qoshet dhe gurët e themeleve ishin vjedhur e plaçkitur, si mall i huaj e i pazot, e bën Skënderin që të rikujtoj kohën e shkuar, kur këto troje gjallonin nga jeta, puna, lufta, dasmat e vdekjet.



Prindërit e Skënderit, Hajrie & Selman Cala

Mësues në Ndërshenë, Fushë-Lurë, Arras, Tartaj, Vilë e Soricë



Skënder Cala – Mjeshtër i Madh, që i ka dhënë aq shumë artit e kulturës kombëtare, në të vërtetë ka hequr shumë në jetën e tij, është burrëruar para kohe. Ndoshta si ai dhe të tjerë kanë sakrifikuar rininë, janë lodhur e dërmuar në moshë të njomë, kanë mbajtur mbi shpatulla fëmijësh barrën e të mëdhenjve për të siguruar bukën për njerëzit e shtëpisë... Ai mban mend: kur ishte në moshën 14-të vjeçare dhe nëna e përkëdhelte në shtrat, që të ngrihej të lëshonte lopët.

Kishte rënë dielli e ai përgjumshëm i lutej asaj të flinte edhe pak.

Një ditë baba e zgjoi në orën katër të mëngjesit dhe bashkë me të udhëtuan drejt Peshkopisë. Kishte mbetur pa vazhduar studimet, sepse dëshira e tij për të vazhduar liceun për të cilin kishte prirje sidomos në pikturë, kishte dështuar. Arësyeja e këtij dështimi shpjegohej se në lice për pikturë duhej të shkonte, sapo të kishte mbaruar filloren.

Ku vallë po e çonte babai?

Kohë më parë ai u kishte thënë Skënderit dhe Beshirit se përroi i Madh ka qenë fati i tij... Aty ku kishte lindur, donte që edhe të vdiste, ndërsa djemve u kishte premtuar se do t'i dërgonte në shkollë.

Binte një shi i imët vjeshte, pak i ftohtë. Të dy, babë e bir, s'kishin çadër. U lagën e u bënë qull, por nga të ecurit e shpejtë u dilte avull e tereshin, si toka e njomur, kur thahet nga rrezet e diellit.

Pa mbërritur te përroi i Blliçes shiu filloi të binte me rrebesh. E kaluan atë ujë të rrëmbyer e të turbulluar pa i hequr

opingat. U lanë me ujë Grame në brez e poshtë dhe vazhduan rrugën pa u ndalur në asnjë vend.

Selmani nxori xhaketën t'ia vendoste në kokë Skënderit për t'i shpëtuar rrebeshit që binte, por i biri nuk pranoi. I vinte keq për babain, se kishte marrë një të ftohur duke nxjerrë plehun nga ahuri i bagëtisë e s'ishte mirë, fytyra i rrinte e verdhë. Kështu, herë lagu e herë thaju, më në fund arritën në Peshkopi. U futën në një gjellëtore dhe morën nga një salep me bukë. Pasi hëngrën, u rregulluan nga uniforma dhe shkuan në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit. Hynë në një zyrë, ku i priti një burrë i shëndoshë e simpatik, me dy sy të mëdhenj, me pamje të qetë. Pasi i përshëndeti filloi të fliste shtruar:

- Dëgjo, Skënder, ti je i ri, sapo ke mbaruar shkollën 7-vjeçare, por në trup qenke i zhvilluar. Ne kemi nevojë për mësues dhe ti do të bëhesh mësues i mirë. Të kemi emëruar mësues me katër klasë në Ndërshenë Reç. Suksese dhe mirupafshim!

Skënderi doli nga zyra si i shastisur dhe ashtu, bashkë me babanë e tij vazhduan rrugën për në Lugjej.

Po fillonte një jetë të re në një ditë të turbullt me mjegull dhe shi.

Baba po i fliste me këmbë e me duar, sikur ishte zëvendësi i Shefit të Seksionit të Arsimit, Selim Alliu.

...Në Ndërshenë, Reç, njohu fshatin me 20 shtëpi ashtu siç ishte, me shtëpi të thjeshta njëkatëshe, dykatëshe, me dritare të vogla, oda të shtruara me baltë e hasra, me hasra thekre, mutafë dhie e rrallë ndonjë qilim apo sixhade. Varfëria ishte e tejskajshme, bukë s'kishte, veshje e mbulesa jo. Lampa ndriçimi s'kishte dhe në vend te tyre përdorej pisha dhe kandili. Ushqimet më të përdorshme ishin grosha, shëllira, kripa edhe qepa. Buka e misrit hahej e fortë, sepse harxhohej më pak. Edhe pse ishte kjo gjendje njerëzit ishin të qeshur, të çiltër dhe shumë të dashur, sidomos me jabanxhinjtë.

Skënder Cala ishte fëmijë, por meqë e kishin caktuar

mësues të fshatit, njerëzit e respektonin sikur kishte mbaruar universitetin.

Ishte viti 1954 dhe nëpunësit e shtetit ishin të rrallë. Meqë fshati ishte i vogël, shumë shpejt ai njohu të gjithë fshatarët me emër, njohu gjendjen ekonomike të tyre, doket e zakonet, burrat me emër që kishin bërë histori në ato anë.

Me nxënësit e shkollës u miqësua shpejt dhe e deshën njëri-tjetrin, si të ishim vëllezër. Vërtetë që nuk kishte ndonjë përgatitje të lartë shkencore e metodike dhe nuk e zotëronte artin e mësimdhënies, por kishte ndjenjë përgjegjësie dhe vullnet për të studiuar e këmbëngulje për t'u shkuar gjërave deri në fund.

I zoti i shtëpisë, ku ndenji në Ndërshenë, quhej Isuf Leka, burrë i rrallë, i urtë, i dashur, i mençur, por edhe idhnak. Ai i fliste çdo natë për krahinën e Reçit dhe reçjanët, traditat atdhetare të tyre dhe mbi të gjitha për ndershmërinë dhe moralin e lartë.

- Me ditë ma pak, or bashi i mikut, s'është marre. Me qenë edepsëz e i pafytyrë është faqja e zezë!

Në atë fshat, mësuesi Skënder Cala ishte për dasma e mort, këndoi e kërcëu me të rinjtë e gjallë e të shkathët, dëgjoji karare të fshatit e të fisit, ku banonte dhe s'i hyri ferrë në këmbë. "Nuk lashë njollë të keqe e nuk mora gjë të keqe me vete", - thotë me shaka Skënderi.

Duke qenë në juridiksionin e Isuf Lekës, baba e nëna ishin të sigurtë se në atë derë ku hyri miqësia familjare që kishin, do të forcohej më shumë.

Në Ndërshenë-Reç ndenji pak, gjashtë muaj gjithsej. Iku, kur duhej të qëndronte, por kjo i bëri mirë mbasi i dha një mësim të paharruar: "Është vështirë të bëhesh i mirë, sepse duhet kohë, ndërsa i keq bëhesh për një minutë".

Sapo kishte mbushur 15-të vjeç, fati i përgatiti një udhëtim të ri. Sërish nëpër male e kreshta po kërkonte "të ardhmen", por ajo ishte mjaft tinëzare, lëvizte shumë, futej nëpër gryka,

kodra, përrenj e pyje dhe s'kapej dot.

Të kishte qenë zanë mali do t'ia gjente anën, por “e ardhmja” s'kishte besë. Dhe kështu, u end për vite të tëra, nga Ndërshena në Fushë-Lurë, Arras, Tartaj, Vilë e deri në Soricë të Dardhës.

Të tjerët e quanin mësues, por ai e konsideronte veten, veç një endacak që endej rrugëve të Dibrës për të siguruar mbijetesën që familja të kishte të siguruar një copë bukë, ca ushqime të rëndomta, si vaj e makarona dhe ndonjë veshje të dalëboje sa për të mbuluar trupin.



Lart, nga e majta: Qazim Marku, Selman Cala, Hasan Cala, Vexhi Cala, Qatip Cala, Seit Lushi

Ulur, nga e majta: Llan Dervishi, Halit Xhediku, Islam Xhelili, Hazis Dervishi, Isuf Gjoka, Hamit Luca - 1982

Megjithëse vuanin se flinin nëpër shkolla 3-4 mësues në një dhomë, me një sobë që nxinte e një krevat me dërrasa të sajuara, si arkivol, me dyshekët gurë e jorganët e arnuar, me një ushqim të përgatitur me groshë të holluara, domate të regjura, shëllirë, marmalatë të shkrirë me ujë, sërish s'e ndjenin vuajtjen, por luanin futboll, këndonin, shëtisnin nëpër rrugët e fshatit, dilnin për piknik nëpër pyje, me bukë kripë e qepë dhe

ishim optimistë se ditë më të mira do të vinin.

Në jetën e tij ka pasur dëshira të ndryshme, ose hobe, siç i thonë sot. Është marrë me pikturë dhe ka pasur dorë të mirë. Vizatimet i ka ruajtur deri vonë si pejsazhe, kulla malësorësh, portrete fshatarësh të vuajtur, por, siç rrëfen tani, kur po i afrohet të 80-tave, qejf më të madh ka ndjerë kur pikturonte pleq të vjetër me rrudha të thella dhe portetin e stërgjatur me xigomatikë si të një kafke të vdekurish.



H. Ndreu dhe H. Xhediku, në valle dyshe, në dasmën e Beshirit, 1966



Bijat në dasmën e Beshirit

Ajo natë dimri, që i prishi gjumin

Ju ka rastisur ndonjëherë që, pa pritur e kujtuar, dikush të ndikojë mbi jetën tuaj, duke tjetërsuar gjithçka, punën, shtëpinë, veshjen, ushqimin, emrin?

Skënder Calës i ka ndodhur! Ndoshta e ka ndihmuar fati, siç thonë plakat. “Kështu është parashikuar jeta juaj më foli një magjistari modern, kur më detyroi të hap pëllëmbën e dorës. Një mik i shtëpisë sime, që më vonë do të mbetej përjetësisht miku më i mirë i imi dhe i familjes, kishte kohë që më shihte me një sy tjetër. Që kur ishim në Tiranë, ai mik vinte vazhdimisht në shtëpinë tonë dhe mua më donte e përkëdhelte veç të tjerëve. Më kujtohet një natë dimri i vitit 1956. Borë kishte pak, por frynte një veri i hollë, që të priste hundë e veshë e të lëshonte për tokë. Kësaj ere të akullt shumbatasit i thonë “Perhode”, ose “Gjrrajk” e përcaktojnë dernjanët...”, rrëfen Skënderi.

Atë natë në shtëpinë e Selman Calës kishte ardhur një mik i veçantë, Hazis Ndreu, i cili në atë kohë ishte kryetar Lokaliteti në Zalldardhë. Shtëpia u mbush plot me miq nga Dardha e Kalisi. Edhe vëllai i Selmanit, Jahja, që banonte prej vitesh në Shumbat, ishte atë natë aty. Siç dukej i kishte çue fjalë "sebepliu" i kësaj darke, Hazis Ndreu, ashtu siç kishte marrë me vete dhe nipin e derës, Halit Xhedikun. Miq më të mirë se atë natë familjes së Selman Calës nuk i kishin ardhur, që kur u vendos në Lugjej. Kaluan një darkë të hareshme që Skënderit do t'i ngulitej në mendje për tërë jetën.

Të nesërmen dolën nga shtëpia bashkë me Hazisin dhe u varën teposhtë arave tona, në përrua të Madh, në Shulla e poshtë te kaikja në rreth të Drinit. Udhën nga kaikja deri në Zalldardhë e bënë ngadalë. Hazisi nisi t'i japë ca porosi për kujdesin, që duhej të tregonte për zërin, që ta ruante atë, se e kishte pasuri që ia kishin dhuruar nëna e baba. Artisti i Merituar Hazis Ndreu (që më pas do të shquhej edhe si

studiues, poet, këngëtar i përmasave mbarëkombëtare, e kishte porositur Skënder Calën që t'i mësonte këngët e Dibrës se janë flori, kanë melodi të bukur dhe tekste përrallore!

Hazisi fliste ngadalë dhe ai e dëgjonte atë sikur ai e kishte në dorë fatin e jetës së tij. I dukej Hazisi edhe muzikant, edhe poet, edhe i ditur. I bashkonte këto tri cilësi dhe nxirrte si konkluzion se Hazis Ndreu ishte njeri i mirë, që e donte dhe duhet të mbështetej tek ai.

Rrugës, duke shkuar për në Vilë, ku ishte mësues, filloi të thur ëndrra në mendjen e tij prej të riu. E shihte veten nëpër skena, duke kënduar si Hozelito i vogël te filmi “Dëgjoni këngën time”.

Në “Lak të Canit” një fshatar e kapi për krahu dhe i tha: “Ku shkon, or voc?”

- Në Vilë, - iu përgjigj.

- Po ç'punë ke që i bie drejt, a do me ra në Dri me u ba copa? Ec djathtas për xhadje, or bir!

E kishte humbur fare. Ëndërronte sikur fluturonte, sikur jetën e tij e kishte mbërthyer për gryke dhe i thoshte se “s’ke nga me ikë tani, je në dorën time, do të bësh si të them unë e do të çoj atje, ku dua unë”.

Hazisi ia kishte futur keq fitilat si Sheherezadja, që çuditi mbretin e Persisë në "Njëmijë e një netë". Ideja e Hazisit për të përvetësuar folklorin e popullit e tërhoqi shumë. Sa këngë të bukura kishin fshatrat e Dardhës!

Skënder Cala, ndonëse fare i ri, pikërisht kur e konsiderinte veten “një copë mësues katundi” e dinte se dernjani sa bie prej djepi e deri kur bëhet gati për të shkuar n’atë botë, kërcen.

Vallet e Dardhës janë me nam në Shqipëri, por jo vetëm këtu. Sa e sa ansamble janë paraqitur me folklorin e kësaj zone dhe kudo kanë fituar çmime të para. Po ku e dinte ai në atë kohë se muzikantët më të mëdhenj të botës, si Bah, Bethoven, Verdi, Puçini, Moxarti ishin ulur këmbëkryq në shpirtin e popullit dhe kishin marrë prej tij nektarin e gurrës popullore?

Ata, në veprat më madhështore operistike dhe simfonike, kanë në esencë melodinë dhe ritmin e këngëve të popullit.

Ndërsa sot, po të rrëmosh në bibliotekën e tij, do të gjesh fletore dhe blloqe të dalëboje, me faqe të grisura, me shkrime të ndryshme, të cilat përmbajnë këngë folklorike, gjëagjëza, lojëra popullore, përshkrime kostumesh popullore, doke e zakone të fshatrave, ku ka qenë mësues.

Në këto blloqe gjen vargje hyjnore, që vetëm populli mund t'i këndojë e të thuri melodi, që të fusin mornica në trup.

*“Njëzet vjet e nantë muj
Nana djalin e ka ruj
Me ja dhanun tjetër kuj”*

Ose:

*“Midishe, Midishe, sa e mëjra ishe,
Sa e mëjra ishe, jelekun që kishe,
Jelekun ta hojmë,
O sa fort u dojmë,
O sa fort u dojmë,
Si shqerat e njomë.”*

Ose:

*“Moj e mira qerpikë me rrema
Mos dil jashta, moj, por rri mrena,
Krif zylyfet me katër rrema.”*

I dëgjonte këto këngë në dasma e perviçe dibrane dhe mrekullohej prej tyre, i dukej vetja se është në një kohë ëndrrash, ku zërat e bukur femërore, të vajzave e nuseve dernjane vijnë nga thellësia e shekujve, ashtu origjinale pa “lajlelule”, siç ishin kënduar qindra vjet më parë.

Në gjimnazin e kuadrove të arsimit në Tiranë

Një ditë vere, pasi kishte mbaruar mësimin, po zbriste nga fshati Vilë drejt Zalldardhës. Ishte vapë e padurueshme. Ca zëra rinorë të “Rrasa e Keqe” i ndollën kërshëri dhe nuk u mendoi dy herë, por u shkëput si zog nëpër porenin e ngushtë të arave të Caneve e Ndreve dhe ra në Dri. Aty ishin mbledhur të rinj nga Zalli i Lugjajt dhe po laheshin. Ishin ndarë në dy grupe dhe po zhvillonin lojën “Hupas”, domethënë kush e zhyt njëri-tjetrin më thellë. Nuk dinte ndonjë not kushedi se çfarë, po kishte garanci se nuk mbytej. U bashkua me ta dhe hip e zbrit në qafë të njëri-tjetrit kaluan nja dy orë të mira. Dolën nga Drini me sy të skuqur, që u digjinin si spec dhe me dhimbje veshësh. Korrieri i Lokalitetit, Ali Topuzi, i afrohet dhe i jep një copë letër. Ishte një urdhër i Seksionit të Arsimit të Rrethit që të bënte dorëzimet në shkollë dhe të bëhej gati për në shtator mbasi i ishte akorduar bursa për në gjimnazin e kuadrove të arsimit në Tiranë, te Qyteti i Nxënësve, ose siç thoshte baba i tij, te Gazermat e Ali Rizasë.



Zall Dardha

Pas tre vitesh po kthehej sërish në Tiranë, në vendlindjen e tij, te njerëzit e tij të afërt, dajat, tezja dhe kushërinjtë.

Shtëpia ku kishte lindur, ishte te Xhamlliku, në lagjen e dibranëve, ndërsa tani për 3-4 vjet do të jetonte pranë Kombinatit, aty ku dikur kishte qenë garnizon ushtarak.

Në Qytetin e Nxënësve ishte mbledhur gjithë Shqipëria. Aty përgatiteshin kuadro të rinj për kulturën, arsimin, ekonominë. Ky qytet ziente nga zhurma dhe aktiviteti rinor.

Çdo ditë, krahas mësimit dhe orëve të detyruara të studimit, nxënësit merreshin me veprimtari sportive, kulturore, artistike. Kishte rrethe shkencore, laboratorë, dhoma kulturore, fusha sportive për futbollin, volejbollin e basketbollin. Qyteti i Nxënësve përgatiste edhe atletë, gjimnastë për paralele, unaza etj.

Në atë shkollë, Skënder Cala, jo vetëm u përgatit si mësues me njohuri e dije shkencore, por nga ana tjetër nxori në pah dhe dhuntitë e talentin për t'u marrë veçanërisht me futbollin dhe rrethet artistike, sidomos me këngën.

Shkolla kishte një drejtor mjaft të përgatitur dhe autoritar. Ai nxiste ecurinë e nxënësve, jo vetëm në orët e mësimit, por sidomos në veprimtaritë kulturore dhe sportive. E quanin Riza Hajro. Kishte mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik. Këndonte me pasion dhe kishte dëshirë të interpretonte bukur.

Me repertorin muzikor të S.Calës u muar vetë drejtori, i cili muzikën ruse e njihte mjaft mirë. Në ato vite, nëpër estrada, radio, mbremje vallëzimi, e kudo, dëgjoheshin këngët ruse.

Në një konkurs final me shkollat e kryeqytetit, Skënderi ka kënduar dy këngë. Njëra titullohej “Ajzerbajxhani ynë” e kënduar nga këngëtari Reshit Bejbutov dhe tjetra “Kënga e dashurisë së parë”, kolonë zanore e të njëjtit film sovjetik.

Edhe në spartakiadat sportive është dalluar. Ndoshta kjo pjesëmarrje me shumë pasion u bë shkak që vitin e fundit, dy muaj para se të mbaronte shkollën, mori një të ftohur shumë të rëndë. Ai mban mend se si doktor Ndroqi, i tha drejtorit, Riza

Hajros, se djaloshi duhej të kurohej në një vend me klimë malore, me bulmet të freskët dhe ca porosi të tjera, të cilat e bënë të pamundur qendrimin dhe kurimin e tij në Tiranë.

Këshilli pedagogjik vendosi që Skënderi të mbyllte vitin e tretë pa pasur nevojë të shlyente provimet në vjeshtë. Kjo gjë ishte pasojë e punës që kishte bërë gjithë vitit, duke mos munguar për asnjë çast.

Më vonë, kur u burrërua dhe mori e rrugën vërtetë të artit duke u bërë artist i skenës si këngëtar, aktor e regjisor, e ka takuar si mik të paharruar Riza Hajron, i cili për erudicionin kulturor e artistik që zotëronte, u bë drejtor i Teatrit Kombëtar dhe më vonë drejtor i Teatrit të Operas e Baletit.



1958: Me skuadrën e futbollit të shkollës

Sërish - mësues në Soricë të Dardhës

Ditën që mbaroi gjimnazin dhe mori në dorë dëftesën e pjekurisë, ndjeu sikur një ngërç i madh i pushtoi gjithë trupin dhe iu duk vetja si i paralizuar. Do të largohej nga Tirana e shumëndrruar për t'iu përkushtuar sërish mësimdhënies në Soricë të Dardhës, një fshat në kufi me Kraj-Reçin.



Populli i Dardhës në inagurimin e Urës Telit, mbi Drinin e Zi

Në Soricë jetoi në shtëpinë e Islam Mëziut, burrë malësor, që e njihnte mirë kodin e mikut dhe mikpritjes. Atje kishte kushërirën, vajzën e Mustafa Ndreut, e cila ishte martuar me Rahman Mëziun.

Edhe në Soricë, si në Ndërshenë-Reç, ku pati “profesor” Isuf Lekën, leksionet për Malet e malësorët, për traditat e Dardhës e Reçit, si dhe marifetin e burrave të dheut, ia jepte çdo ditë Islam Mëziu. Ato mësimet morali i bënë mirë se e përgatitën për jetën.

Në shkollën e Soricës ora e muzikës ishte bërë e dashur për fëmijët. Kishte mjaft raste, që vinin edhe fshatarë të cilët dëgjonin fëmijët e tyre duke kënduar. Mësues Skënderi kishte përgatitur këngë me grupe, të ndara meshkujsh e femrash, si

dhe me përbërje miks me dy-tri zëra.

Adoleshencën e kaloi pa u marrë vesh, i shtypur nga trysnia e halleve. Ai s'kishte kohë të hallakatej në psikologjinë e moshës, dëshirat e të rinjve.

Kur vinte nga Sorica, por edhe më parë, kur ishte mësues në Vilë të Dardhës, blinte orendi shtëpiake, ushqime dhe ndihmonte nënën, duke mbledhur dru të thata për zjarr, mbushte ujë, etj.



Me nxënës të shkollës kur ishte mësues

Që në moshë të re, u mësua me punët e shtëpisë dhe të mos përtojë për t'i shërbyer vetes. Jeta e kishte mësuar të gatujë, të pastrojë shtëpinë, të lajë rrobat, të hekurosë, sepse kushtet e kanë detyruar. "Këtë edukatë e kemi marrë jo vetëm nga nëna, por edhe nga baba, i cili nuk përtonte për asgjë. Baba ishte njeri pa paragjykime. Kur sëmurej nëna ose nuk ishte në terezi, ai gatuate dhe i bënte punët e shtëpisë si të ishte një amvisë shembullore. Kur shoh nga dritarja e kohës së sotme, gjykoj dhe vlerësoj se për atë kohë nuk ka pasur malësor më të emancipuar se baba im.

Nga të katër vëllezërit, më i privileguari ka qenë Naimi. Ai ishte "agai i shtëpisë", sepse nuk e provoi kurbetin që në rini, ashtu siç bënë Skënderi, Beshiri e Petriti. "Edhe ai, si të tjerët, i lagu këmbët, por më vonë. Shkoi nja dy ditë në Greqi të bëhej i pasur, por nuk bëri prokopi dhe u kthye me duar në xhepa...", rrëfen Skënderi.

Kanë kaluar shumë vite, afër një gjysmë shekulli, dhe kujtimet e kohës së shkuar herë turbullohen, herë kthjellohen, por, në esencë, ato mbeten të pashlyera në kujtesën e tij, sepse vuajtjet asnjëherë nuk harrohen.



Me prof. Gjergj Zheji



Riza Hajro, drejtori i gjimnazit

Nëpër udhën e vështirë të artit

Ishte viti 1961. Pranvera kishte ardhur si e vakët nga dimri i egër që kishte kaluar. Edhe pse ishte muaji prill, çdo gjë dukej e vonuar.



Estrada, shfaqje në Kastriot

Skënder Cala po kthehej nga një ditë mësimi e zakonshme nëpër brinjat e Monrosit të Dardhës. Ecte kuturu, pa mendim në kokë. Toka ishte e zezë edhe shpirti nxinte...

Në zyrat e Lokalitetit kishte zhurmë. Ishte kohë fushate për mbjelljet e pranverës dhe kryetari po shpërndante ekipet nëpër fshatra që të mobilizonin fshatarësinë për mbjelljet e stinës.

- Edhe ti për fushatë ke ardhur sot, - i foli njëri nga mësuesit e shkollës së qendrës së Zalldardhës.

- Ne të maleve, në fushatë jemi ditë e natë, - ia ktheu përgjigjen Skënderi pak si me inat.

- Je i ri, mor djalë, hala s'të kanë dalë mustaqet. Do kohë rekruti të bëhet ushtar.

Kur po bëhej gati t'i përgjigjej, kryetari i lokalitetit doli nga zyra dhe erdhi në holl, i zgjati dorën duke e uruar: Urime,

Skënder, më bëhet qejfi për ty!

Skënderi mbeti i shastisur dhe si i zënë ngushtë e pyeti se s'dinte gjë përse po e uronte, se në atë kohë sapo kthehej nga mësimi dhe të parin njëri që takoi ishte ai tersi, mësuesi me të cilin replikoi.

- Ti, - duke ju drejtuar mësuesit të qendrës, - që nesër je emëruar mësues me katër klasë (kështu quhej sistemi shkollor në atë kohë) në Soricë, ndërsa Skënderi shkon në Peshkopi si këngëtar në Estradën e Qytetit.

Në Estradën e Peshkopisë nga larg njihte mjaft artistë, por nga afër s'kishte ndenjur e biseduar me asnjërin. Vetëm njërin njihte nga kjo trupë artistike, njihte Hazis Ndreun.

- Ç'të duhen të tjerët? - i tha babai, kur e shihte që sikletosej se s'njihte njeri e s'dinte si të prezantohej. - Shko ke Hazisi, se t'i mëson ai udhët, ku të shkosh e me kë të takohesh!

Dhe kishte të drejtë babai, sepse Hazisi u bë sebeb, (siç thonë plakat). Ai ia çeli udhën për të nisur një profesion të ri, të vështirë, por të bukur, profesionin e artistit, fillimisht si këngëtar e më vonë si aktor e regjisor.

Edhe Skënderi s'bëri gjë tjetër veçse shtyu kufijtëe babës. Po kështu do të bënin edhe Beshiri, Petriti e Naimi i vogël. Të gjithë bënë karrierë, sipas talentit të tyre, në mësimdhënie, art, kulturë e biznes..

Student i shkëlqyer në degën dramatike

Në Institutin e Arteve shkoi i burrëruar, ndoshta më i pjekur se shumica e studentëve të kursit të tij. Asgjë s'i mungonte që t'i përkushtohet shkollës dhe profesionit të bukur, por të vështirë të aktorit. Fati i madh ishte që këtë kurs e drejtonte udhëheqësi artistik Kujtim Spahivogli dhe pedagogët Naim Frashëri, Pjetër Gjoka, Mihallaq Luarasi dhe Prokop Mima, që të gjithë "Artistë të Popullit".



Aktivite në shkollën e lartë, me prof. Naim Frashërin

Në muajt e parë të shkollës, kur në kryeqytet filloi sezoni i ri artistik, dha disa koncerte me Estradën Tiranës dhe me Estradën e Ushtarit, me repertorin që kishte nga Estrada e Peshkopisë. Preokupacioni kryesor për të ishte shkolla, studimet, por këto koncerte i forconin buxhetin financiar, që linte mjaft për të dëshiruar.

U dobësua shumë, sepse kur kthehej nga shfaqjet studionte gjithë natën. I hyri frika se mos sëmurej, si në vitin e

tretë gjimnaz, kur mori ftohje.

Për këtë i çoi fjalë babës, që t'i përgatisnin një kavanoz tre kilësh me gjalp të shkrirë dhe arra. Prindërit ishin bërë merak dhe ia dërguan urgjentisht.

Kështu e kaloi vitin e parë të studimeve mes peripecish e vështirësish të shumta, duke kapëcyer deri edhe skenarë, që mund ta çonin pas hekurave të burgut.

...Dy vitet e fundit të shkollës qenë vendimtare për të, ashtu edhe për studentët e tjerë, sepse tani s'kishin punë me objekte, me elementë të mjeshtërisë së aktorit, me fragmente dramash e me etyde, por me role të plota.

Në vitin e tretë vunë në skenë dramën "Për ata që janë në det", të dramaturgut rus, Boris Lavrenjev. Skënderit i dhanë rol kryesor, atë të kapiten Maksimovit. Pedagogët e vlerësuan me notën më të lartë, duke e cilësuar punën e tij të lavdërueshme dhe rolin të realizuar plotësisht.

Mbrojtjen e diplomës për aktor e realizoi në vitin e tretë, kështu që vitin e katërt mendoi se do të ishte i lirë, mbasi me lëndët profesionale kishte mbaruar punë. Proekupacioni kryesor tani ishin lëndët teorike, të cilave u kishte kushtuar gjithmonë rëndësinë e duhur dhe s'kishte frikë se do të rrezikohej. Përkundrazi, mendonte që të dilte me rezultate të pëlqyeshme.

Në vitin e katërt, kursi i tij vuri dramën "Halili e Hajria" të Kolë Jakovës. Tre javë para se të dilte premiera, studentit P. Ll që luante rolin kryesor, Halil Garrinë, ia hoqën rolin, sepse ai ishte nga Vlora, dhe Halili nuk tingëllonte në këtë dialekt. Kjo gjë krijoi pështjellim te studentët dhe trupa pedagogjike, pasi do mbesnin pa u diplomuar. Pedagogu Pjetër Gjoka që vinte dramën në skenë, propozoi që këtë rol ta dublonte Skënder Cala, tri javë para premierës.

Për një kohë rekord e realizoi rolin dhe shfaqja u dha disa herë për publik në Teatrin Popullor. Ndonëse ishte vlerësuar një herë në rolin e Maksimovit, në dramën ruse "Për ata që janë

në det", pedagogët i vunë notën "Shumë mirë" (10).

Kur mendoj që tani s'i mbetej gjë tjetër, veç se të merrte diplomën dhe të priste emërimin, një student i vitit të dytë, që ishte marrë për të luajtur rolin e Xhefersonit në komedinë "Avokati Patle" të Foqion Postolit, u sëmur. Edhe kësaj radhe thirrën Skënderin që ta zëvendësonte këtë rol, pasi studentët e tjerë ishin të zënë. S'kishte luajtur ndonjëherë komedi, por, çuditërisht roli iu ngjit pas trupit.

Skënder Cala mban mend që rastësisht, kur e pyeti një personazh në ditën e premierës me batutën:

- Ju, Zoti Xheferson nga Nju Jorku jeni?

- Jo, mor budallë, iu kthye instinktivisht, jam Xhaferi prej Zalldardhe. Salla shpërtheu në duartrokitje të zjarrta.

Me këtë batutë i kishte dhënë fund mjeshtërisë së aktorit, i bindur plotësisht, se ishte i aftë të përballonte kërkesat e një teatri profesionist, pse jo, dhe të Teatrit Popullor.

Të qenurit student në degën dramatike, për kohën kur ka studiuar, ishte privilegj, sepse do të bëhej aktor dhe ky profesion shihej me sy të mirë, pse jo dhe me pak xhelozji nga studentët e fakulteteve të tjera.

* * *

Pasi mbaroi studimet e larta, edhe ëndrrës që të mbetej në Tiranë i erdhi fundi. Skënder Cala parandjente se një kohë e mbrapsht e priste përpara. Gjaknxehëtësia dhe turravrapi për t'u përballë me padrejtësinë kanë qenë pjesë të rëndësishme të karakterit të tij. Ato, herë shfaqeshin e herë fashiteshin, si puna e ajsbergut, por kurrë nuk shuheshin. Sa herë ndeshje me probleme, kur përplaseshin e drejta me të padrejtën, instinktivisht ngrinte kokë shpirti i revoltës, deri në papërmbajtje.

Hazis Ndreu, duke parë se partia e kishte vënë në shenjë Skënderin, bisedoi me babën dhe mixhën e tij, Jahe Calën, të

cilët u shqetësuan pa masë. Ai i qetësoi disi se diçka do të mundohej të bënte për Skënderin...

* * *

Pasi kishte mbaruar Institutin e Arteve dhe mendja i ishte “arratisur” sa në një institucion në një tjetër në Tiranë, i vjen haberi i papritur se duhet të paraqitet në Korpusin e Burrelit, për të kryer zborin ushtarak. Pra, regjisori, aktori dhe këngëtari i mirënjohur duhej të përgatitej edhe ushtarakisht me taktikën dhe strategjinë e luftës partizane, për të qenë i gatshëm çdo çast për t’i dalë zot Atdheut socialist.

Gjashtë muaj me radhë u “ngujua” në Korpusin e hekurt të Burrelit, ku një distancë e afërt i ndante me kushërinjtë, ngujuar në burgun famëkeq të këtij qyteti.

Atje, në fushën e djegur nga dielli, vapa, erërat dhe ngrica u dukej vetja si në *gulakët* e shkretët të Ruisisë.

“Në zbor, që nga mëngjesi e gjer kur binim për të fjetur, në studim, mensë, stërvitje e pushim, në rrezet përvëluese të diellit, në shi e dëborë, në liridalje e vizita në muzetë revolucionarë të qytetit, fjala më e përmendur që na mobilizonte për të qenë përherë të gatshëm ishte “rrethim”. “Jetojmë si në rrethim”, “Na kanë halë në sy e duan të na rrethojnë”, “Rrethim ideologjik”, “Ne në gojë të ujkut hedhim valle”, “Të rrethuar nga shtete borgjezo-revizioniste”, “Rrethim nga shfaqje e mbeturina të huaja” etj”, shkruan Skënder Cala në ditarin e tij të asaj kohe.

Teatri profesionist, një ëndërr e madhe e dibranëve

Në maj të vitit 1968, pasi kishte hequr “lëkurën” e ushtarit, filloi punën si aktor në Estradën Profesioniste të Peshkopisë.

Në gjuhën artistike Teatri i Dramës, i Komedisë, Teatri i Estradës, kanë një emërues të përbashkët, veprimin. Mirëpo, mjetet artistike për të realizuar njërin apo tjetrin zhanër janë të ndryshme.



Kolektivi i Estradës Profesioniste, Peshkopi

Si aktor dramatik e kishte provuar vehten në disa role dhe sipas trupës pedagogjike ishte i aftë të interpretonte role kryesore në një dramë, apo tragjedi. Në komedi e kishte provuar veten në rolin e Xhefersonin në komedinë “Avokati Patle”.

Të interpretonte në estradë, si aktor humori, as nuk i kishte shkuar ndonjëherë ndërmend. Megjithatë nevoja për të mbijetuar e detyronte të dilte në skenë me role jo të sakta nga ana dramaturgjike.

Pak muaj punoi si aktor estrade, sepse në vjeshtë të atij viti, vjen një urdhër nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës që të

paraqitej pranë Akademisë së Arteve për t'u specializuar në kursin e regjisorës, që drejtohej nga regjisori Kujtim Spahivogli.

“Unë nuk e kisha ndjerë lezetin e skenës si aktor, pasi nuk punova si aktor dramatik dhe kur më caktuan si kandidat për t'u bërë regjisor, e ndjeva veten me shumë fat. Ju përkushtova regjisë me gjithë forcat e mia intelektuale e profesionale dhe përfitova mjaft. Ishte koha kur do të çelej Teatri Dramatik i Fierit dhe Ministria e Arsimit më caktoi mua si regjisor. "Kur martohet fukaraja, grisët lodra", thuhet nga anët tona. Kështu ndodhi edhe me mua. Më prenë rrogën se nuk paraqitesha në punë në Peshkopi dhe dërguan një shkresë në Ministri që të kthehesha nga kisha ardhur. Sërish u ktheva në qytetin malor me kokën varur, i prekur pa masë për fatin e keq që paskam pasur dhe me zemër të thyer nisa punën aty, ku e kisha lënë, pa perspektivë, me një rutinë të përhershme”, -shkruan z.Cala në ditarin e tij. Në ato rrethana ishte e kuptueshme që mërzinë dhe pesimizmin t'ia shtonin konservatorizmi dhe xhelozia e ndonjë kuadri gjysmak të institucionit që e shikonin me sy jo të mirë meqë kishte mbaruar shkollën e lartë dramatike.

Lëvizja artistike në qytetin e Peshkopisë ka qenë e zhvilluar. Festivali i estradave, teatrove, i këngës e valleve, takimi i shtëpive të kulturës me veprimtaritë kulturore masive e gjallëronin jetën e qytetit.

Në vitin 1971 organizohej Takimi Kombëtar i Teatrove Amatore, me pjesëmarrjen e 26 trupave teatrore të shtëpive të kulturës së rretheve.

Sipas traditës, për çdo ndërmarrje të qytetit u caktuan regjisorët, që do vinin në skenë dramet me të cilat do përfaqësoheshin në takimin teatral të Rrethit dhe më pas kush të fitonte, do të paraqitej në Takimin Kombëtar në Durrës.

Skënder Calën e caktuan në ndërmarrjen komunale të qytetit. Atje drejtor ishte Ahmet Përleka, prej Lure. Ai ishte burrë klas, i ëmbël, autoritar, por edhe mjaft i këndshëm në

muhabet, shtëpi e shoqëri. Ai s'kishte shkollë të madhe, por natyra e kishte pajisur me një intelekt për t'u pasur zili... Dhe s'kishte se si të mos korrte sukses regjisori Cala, kur për realizimin e dramës “Rrënjët” të Kujtim Spahivoglit, drejtori Përleka përdori gjithë arsenalin ekonomik të ndërmarrjes, vuri në dispozicion të tij si regjizor njerëzit më të talentuar, pa marrë parasysh funksionet drejtuese që kishin, apo detyrat që realizonin në prodhim si këpucarë, teneqepunues, marangozë, teknikë, mekanikë, inxhinierë etj, për të materializuar rolet si aktorë. Ahmeti vinte vetë në prova, ndiqte pjesëmarrjen, bënte vërejtje për disiplinën, këmbëngulte për realizimin e dekorit sipas kërkesave të skenografit.

Ç'është e vërteta edhe drejtuesit e ndërmarrjeve të tjera punonin me përkushtim për të realizuar këtë “aksion ideologjik”, siç quhej në atë kohë, por kërkesat e Ahmetit ishin më konkrete, të vazhdueshme e me efikasitet. Ndaj me të drejtë, juria e takimit e caktoi këtë trupë amatore për të përfaqësuar rrethin e Dibrës në takimin kombëtar.

Takimi i Teatrove amatore u zhvillua në Durrës në qershor të vitit 1971.

Autori i dramës “Rrënjët”, nuk pati mundësi të shikonte shfaqjen në Durrës. Kryetari i jurisë së takimit, dramaturgu Kolë Jakova, gjatë diskutimit krijues tha:

- Do të kisha dëshirë që në këtë diskutim krijues të ndodhej edhe autori Kujtim Spahivogli, por edhe pse nuk është dua t'i them se shfaqja e vërtetë e tij është kjo që ka dhënë Teatri amator i Peshkopisë dhe jo ajo e Teatrit profesionist të Vlorës.

Juria e shpalli fituese me Flamurin e Festivalit Ndërmarrjen Komunale të Peshkopisë. Që nga ai çast Skënder Cala u emërua regjisor i Shtëpisë së Kulturës “Haki Stërmilli” të Peshkopisë.

Sa herë që trupat artistike të Tiranës e rretheve të ndryshme të vendit planizonin shfaqje premierash në *qytetin e blirëve* (siç njihej Peshkopia), ose ftoheshin nga drejtorja e Shtëpisë së

Kulturës, mbeteshin mjaft të kënaqur. Të gjitha trupat shpreheshin me përshtypjet më të mira për publikun e kulturuar të qytetit. Kjo ndodhte se publiku dibran, kur vinte për të respektuar trupat artistike të rretheve të ndryshme, nuk i kursente duartrokitjet dhe fjalët e mira për skenat e realizuara me nivel, këngët apo skeçet, por mbante edhe qëndrim kritik për realizimet amatoreske. Në një farë mënyre, sipas regjisorit Cala, publiku i Peshkopisë ishte bankoprovë për cilësinë e një premiere të re. Kjo ua përkëdhelte sedrën punonjësve të artit e kulturës, se kishin dhënë ndihmën e tyre në kultivimin e shijeve të spikatura estetike të publikut dibran.

Qyteti i Peshkopisë është një qytet me norma dhe vlera të larta morale. Ai është si puna e syrit, që nuk i duron papastërtitë. Në këtë kontekst Skënder Cala e konsideron veten me fat, ndërkohë që është përpjekur që të gjejë gjuhën e përbashkët me qytetarët dibranë, të cilët vlerësojnë mendjen, por mbi gjithçka ndershmërinë. Pikërisht për këto vlerësime e përjetime, ai shkruan në kujtimet e tij: *“Asnjëherë s’ më janë bërë pengesë për pjesëmarrjen e femrave në veprimtaritë që kam zhvilluar, si artistike ashtu edhe ato kulturore. Ndoshta, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur edhe ime shoqe, Ferihaja, e cila merrte pjesë vetë në këto veprimtari dhe u rrinte atyre pranë si shoqe, apo motër e madhe...”*.



Nga drama *"Lumi i Vdekur"*. Luan Hysa, Feriha Cala, Llesh Nikolla.

Nga trupat amatore te teatri profesionist

Teatri ka qenë dhe mbetet ndër institucionet më të



rëndësishme të një shteti a kombi. Në teatër është shkruar e inskenuar historia e kombeve më me emër të botës, është zhvilluar e përpunuar gjuha e popujve, kanë dalë në pah vlerat e vendeve të ndryshme, janë vënë në skenë ndryshimet shoqërore dhe përmbyset e sistemeve, vetitë dhe virtytet njerëzore, veset e tyre etj.

Që nga viti 1969, kur ende nuk kishte filluar punën si regjisor S. Calës i hanin duart për punë, sidomos mendjen e kishte te teatri, ndaj dhe i hyri punës me guxim, duke vënë disa pjesë teatrale si komedinë “Flakë Kashte” të Dionis Bubanit (maj 1969), dramën “Drita” të Mimika Lucës (nëntor 1969), dramën ”Rrënjët” të Kujtim Spahivogli (nëntor 1971) dhe dramën e Loni Papës “Cuca e Maleve” (1971).

Periudha që lidhet me qenien e tij si regjisor ishte pjesë e kulturës, e më vonë si regjisor i Estradës dhe Teatrit është e lidhur ngushtë me rritjen e forcave interpretuese në të gjitha zhanret e teatrit, sidomos pas shkollimit të disa kuadrove të reja, të cilët mbaruan Institutin e Lartë të Arteve. Kështu, krahas aktorëve me zë të atij qyteti, si Adil Shehu, Stefan Roçi, Feriha Cala, Inajet Shehu, Agim Skarra, Violeta Vladi (Zhuka), Behar Mera, filluan punë njëri pas tjetrit edhe aktorët Petrit Turja, Xhetan Kuta, Irma Dani, Hamza Abazi, Luan Hysa, të cilët erdhën nga dyert e Akademisë së Arteve dhe e freskuan skenën e teatrit dhe estradës së Peshkopisë duke dhënë një galeri të gjërë figurash artistik, të interpretuara me ndjenjë e

profesionalizëm.

Rruga e teatrit në Dibër ka kaluar nëpër një kalvar të gjatë mundimesh, me ulje e ngritje të pranueshme, sepse çdo gjë bazohej te vullnetarizmi e amatorizmi. Janë për t'u përgëzuar figura të tilla, si Vasfi Xheladini, Remzi Prapaniku, Ismail Hoxha, Rami Pitarka, të cilët kanë vënë në skenë pjesë teatrale. Në kujtesën e brezave mbetet “Cubat e Shilerit” (1932), ku rolin e femrës e luante Vasfi Prapaniku. Kjo shfaqje është dhënë në zyrën e prefektit Mahmut Golemi. Më vonë, në vitet gjashtëdhjetë janë dhënë premiera të tjera, si “Sikur të isha djalë”, me regji të Ulvi Shehut, që ka mbaruar degën e dramës pranë Liceut Artistik, Tiranë.

Gjithësesi, duke tentuar për një art bashkëkohor me kërkesa të larta interpretuese e ekzekutuese, krahas dëshirës së mirë të regjisorit Cala për ta vënë atë mbi baza të vërteta institucionale, lindnin nevoja të tjera, të cilat lidheshin me një sërë faktorësh objektiv dhe subjektiv, që e vështirësonin realizimin e kërkesave të shoqërisë në nivel profesional.

Në rrethin e Dibrës, si në gjithë traditën tonë të pasur folklorike kombëtare, krahas këngëve dhe valleve, një vend të rëndësishëm zë dhe arti teatral.

Ky art është kultivuar dhe zhvilluar brez pas brezi, deri në ditët e sotme, duke pasqyruar momente të rëndësishme nga jeta e të parëve tanë. Dhe në këtë zhvillim e hop cilësor të teatrit në Dibër, regjisor Skënder Cala ka padyshim peshën dhe meritën kryesore.

“Që kur mbarova Institutin e Arteve, mendja më rrinte veç te teatri. Ëndërroja që Dibra të kishte një teatër, sepse kjo krahinë është e dalluar për zhvillimin e mendimit filozofik popullor, se dibranët kanë të zhvilluar alegorinë, shenjë e një intelektit të fuqishëm dhe fantazie krijuese për të kapur tema të rëndësishme për fatet e popullit të tyre, për të debatuar e zgjidhur me gjuhë të zhdërvjelltë shqetësimet e kohës dhe mbajtur qëndrim dinjitoz dhe të përgjegjshëm ndaj fenomeneve

të ndryshme”, rrëfen mjeshtërisht regjisori, aktori e njëherësh këngari i talentuar Cala.

Dhe në të vërtetë, krijimi i Teatrit në Dibër nuk ishte i lehtë. Duheshin përmbushur disa kushte e kërkesa, që nuk varehin vetëm nga dëshira e dashamirësëve të këtij institucioni. Duhej një pallat kulture me parametra bashkëkohorë, me një skenë të përmasave të mëdha, e denjë për të shfaqur premierat e çdo trupe të vendit me të gjitha kërkesat profesionale.

Për të arritur te teatri, S.Cala e kolegët e tij, që merreshim me veprimtaritë artistike amatore e profesioniste në qytetin e Peshkopisë, kishin menduar se një ditë do t’ju buzëqeshte edhe atyre fati për të pasur një teatër, i cili do të zhvillonte më tej kërkesat estetike e artistike të artdashësve dhe do të rriste mobilizimin e gjithë forcave krijuese për të materializuar me art problematikën shoqërore të Dibrës në vepra të ndryshme dramatike, si dhe rritjen e forcimin e nivelit interpretues të artistëve, që do të militonin në këtë teatër.

Në të njëjtën kohë, regjisori Cala punonte me talente të rrethit e qytetit, që të paraqiteshin çdo vit në konkurse, që zhvilloheshin për vazhdimin e Akademisë së Arteve. Kjo bëri që çdo vit shtoheshin kërkesat për të vazhduar studimet në këtë shkollë artistike dhe dalëngadalë filluan të vinë edhe kuadrot e para të cilët, para krijimit të teatrit, nisën punën si aktorë estrade.



Nga filmi "Kërcënimi"

Vlerësimi për kolegët që i dhanë emër artit dibran

Në librin e tij “MAGJIA E DIBRËS”, Skënder Cala, veç të tjerave, vlerëson bashkëpunëtorët dhe kolegët me të cilët i dha emër artit dibran. (në foto me: H. Ndreu, A. Shehu, T. Krroqi)

“Nëse Dibra është e njohur për një zhvillim harmonik të artit e kulturës dhe të një folklori të spikatur, kjo ka ndodhur edhe në sajë të një prurje të pëlqyeshme forcash krijuese, interpretuese e ekzekutuese, të cilat kanë evindentuar këto vlera me realizime cilësore në zhanret e këngës, valles, humorit, etj.



Gjithkush nga spektatorët që ka ndjekur shfaqet e koncertet e Estradës së Peshkopisë është lumturuar, duke shijuar vokalin e bukur me plot kolor të këngëtarëve: Melita Shehu, Abdyl Sturçe, Besim Çutra, Muharrem Zajmi, Flora Toska, Sadete Myftari, Myrto Boboçi, Muharrem Zajmi, Fatime Bojaxhi, Flora Shabani, Elida Shehu, Ilmi Hoxha e Ali Sturçe të cilët për vite të tëra kanë përballuar me stërmundim një

volum të madh pune, duke u endur në skenat e qyteteve në të gjithë Shqipërinë, në fshatra, qendra pune, reparte ushtarake, në këmbë apo në majë të karrocërive të makinave, pa u ankuar për kushte të vështira, edhe pse emrin e kishin artistë.

Zërat magjik të këngëtarëve: Lirie Rashës e Caje Poleshit janë sintezë e mrekullisë së Zotit, që u fali atyre ëmbëlsinë e fëshfërimës së pyjeve të ahut, pishës e dushkut, ngjyrën e kristaltë të krojeve të maleve. Dhuratë më të bukur se këto

talente s'mund të bënte as shkolla e qytetit tonë, por ia bëri krahina me emër e Dardhës. Tingujt lirik dhe dramatik të zërit të Arif Vladit sikur dalin nga thellësitë e shekujve për të shprehur shpirtin lirik dhe epik të dibranit”, - shkruan z. Cala. Duke mos dashur t'i thurë lavde vetes, ai shprehet se sofrat e artit dibran është e mbushur “me meze” plot e përplot, me artistë cilësorë, që kanë vlerat dhe personalitetin e padiskutueshëm të tyre, që në pozicionin e tyre nuk ta lironin udhën...

...Në vitin 1975, organizohet në Shkodër Festivali i Estradave në shkallë kombëtare.

Estrada e Peshkopisë, që kishte një emër të mirë në publik, duke u krahasuar me trupat më të mira të varietesë në vend, u paraqit në këtë festival me mjaft pretendime.

Premiera mbante vulën e dy artistëve shkodranë, të regjisor Tefë Krroqit dhe dirigjent Tonin Rrotës. Asnjëri prej tyre nuk kishte mbaruar Akademinë e Arteve, por ishin me mjaft kulturë, njohje dhe talent në fushën e artit, që ata ushtronin.

Si Tefa, ashtu edhe Tonini e kishin treguar vehten gjatë viteve, kur e morën trupën e Estradës pothuajse pa emër dhe e ngjitën atë lart, duke e bërë të njohur në të gjithë vendin.

Premierat e kësaj trupe ndiqeshin me ëndje nga spektatorët. Sallat, ku jepeshin shfaqjet, mbusheshin plot dhe artistët ishin të kënaqur, se munda nuk u shkante kot.

Vështirësia e takimit kombëtar të Shkodrës nuk qëndronte te organizimi i spektaklit në përgjithësi, por te trajtimi i problematikës së kohës me kulturë e humor, pa teprime e vulgaritete.

Regjisori dhe dirigjenti kishin punuar me nerv, mbasi konkurronin në qytetin e tyre dhe pretendimet ishin serioze, ashtu siç edhe konkurenca ishte e madhe.

Tefa, duke qenë një regjisor, që dallohej në veçanti për zgjuarsinë dhe kulturën e gjerë, e kishte ndërtuar shfaqjen duke i dhënë përparësi anës muzikore edhe për faktin se ky sektor

ishte më i konsoliduar dhe në rritje në shkallë kombëtare.

Materiali letrar spikaste për një tematikë origjinale të mbështetur në hallet dhe problemet, që shqetësonin rrethin e Dibrës.

Spektakli tingëllonte i freskët, plot gjallëri, humor e muzikalitet.

Nisur nga ky rezultat i merituar, “Mjeshtri i Madh” Skënder Cala, i sjell të freskëta në kujtesën e tij duartrokitjet e spektatorit shkodran, i cili i priti mjaft mirë.

Në shfaqje asistonte edhe zëvendës ministri i kulturës, Mantho Bala, i cili si njeri konjunktural që ishte, nuk gëzonte ndonjë simpati të veçantë për estradën e Peshkopisë e në veçanti për Skënderin që i ruante, si rezultat i një grindjeje shumë vite më parë në Librazhd. Gjithsesi, kundër dëshirës së tij deklaroi, se shfaqja e Peshkopisë ishte e një niveli të kënaqshëm dhe duhet pranuar se këngëtari më i mirë i takimit është Skënder Cala. Nuk kishte se si ta mohonte faktin që S. Cala ka qenë këngëtar profesionist i kësaj estrade dhe ka debatuar me profesionalizëm e sukses në skenat shqiptare dhe ato të Kosovës, Maqedonisë e Turqisë.

Për rritjen e konsolidimin e artit e të kulturës në Dibër, zhvillimin harmonik të tyre dhe suksesin e padiskutueshëm në publik, rol të rëndësishëm kanë luajtur kuadrot drejtuese artistike si regjisorë, kompozitorë, koreografë, muzikantë, puna e të cilëve ka shërbyer për evidentimin e vlerave më të arrira të artit në këtë trevë, si dhe afirmimin e plotë të kësaj krijimtarie, brenda dhe jashtë vendit.

Çdo kohë nxjerr njerëzit e vet përfaqësues, si dhe vlerat e saj, arritjet më të mira për të cilat përmendet në kohërat që vinë pas.

Gjatë bisedës për kolegët, S. Cala vlerëson se drejtuesit artistik në institucionet artistike në Dibër, sipas zhanreve që kanë lëvruar, kanë vendosur edhe personalitetin e tyre krijues në ushtrimin e profesionit artistik. Veçanërisht për Tefë

Krroqin evidenton faktin që ai e vendosi regjinë mbi baza të shëndosha profesionale, duke i dhënë asaj përparësi në organizimin e një spektakli.

Dhe ndërsa shprehet për Tefë Krroqin, “Mjeshtri i Madh” Cala, rendit në krah të tij Tonin Rrotën, një figurë tjetër e madhe që u rrit dhe militoi krah tij, si dirigjent e krijues, si muzikant i formuar dhe me shije të spikatur artistike.

Krijuesit që erdhën pas Tonin Rrotës, sipas S. Calës, e zhvilluan më tej punën e bërë nga ai muzikant i palodhur e me shije. Kështu, Zef Çoba arriti që t’i japë një tingëllimë simfonike orkestrës, duke shtrirë më gjerë mundësitë ekzekutuese të atij formacioni, si dhe duke rritur shkallët e vështirësisë të një muzike serioze. Më tej, regjisori, aktori e këngëtari i mirënjohur vlerëson krijimtarinë e kompozitorit Përparim Tomçinit, i cili me këngët epike, si: “A prite Azem Galicën” dhe “Kënga e Jakup Ferrit”, si dhe interpretimin e mrekullueshëm të tyre nga këngëtari i talentuar Arif Vladi, rriti gamën e këtij sektori për ngjitje të një shkalle më lartë të krijimit e interpretimit të këngës dibrane, duke e bërë atë të njohur edhe në shkallë ndërkombëtare.

Me kalimin e viteve qyteti i Peshkopisë u bë një qendër e rëndësishme e zhvillimit të artit. Me ritme të shpejta po rriteshin zhanret e artit dhe forcat krijuese.

Në vlerësimin e S. Calës, një emër të mirë krijoi dhe muzikanti i ri Xhelil Imeri, i cili me krijimet e tij solli freski në këngën dibrane, fillimisht në qytetin e Bulqizës e më vonë në atë të Peshkopisë.

Jo pak gjurmë, me gjithë kohën e shkurtër të aktivitetit artistik në Peshkopi ka lënë edhe Isak Shehu. Në ato ditë orkestra e Peshkopisë u fuqizua shumë në saj të punës plot pasion e profesionalizëm të këtij kompozitori e instrumentisti të talentuar.

“Një emër të mirë ka lënë në fushën e muzikës dhe sidomos si drejtues i sektorit të orkestrës së Estradës të Peshkopisë

edhe muzikanti, kompozitori dhe dirigjenti Edmond Zhulali. Ai, si më i riu në këtë gjini, i dha ngjyra rinore orkestrës, ia shndërroi asaj portretin, duke e bërë që të tingëllojë e freskët, moderne dhe bashkëkohore. Orkestra e drejtuar nga Mondit, dallohej jo vetëm për trajtimin e veçantë që i bënte muzikës dibrane, por edhe për profesionalizëm në ekzekutimin e pjesëve të ndryshme muzikore. Duke qenë një muzikant me formim të kënaqshëm profesional, me aftësi krijuese si kompozitor dhe stil të pëlqyeshëm dirigjimi, ai rriti kërkesat për aftësimin e orkestrës nga ana profesionale, si dhe ndikoi në forcimin e shijeve estetike të këngëtarëve për interpretimin e repertorit të muzikës së lehtë dhe asaj popullore me nivel të lartë artistik”, shprehet z. Cala.

Në vitet 80-të, veprimtaria e trupave artistike të qytetit të Peshkopisë njohu ritme të larta zhvillimi. Estrada profesioniste u freskua me fytyra të reja krijuese si regjisor, dirigjent, aktorë e këngëtarë, pjesëmarrja e të cilëve u dha një shkëlqim të ri shfaqjeve e premierave.

Në atë periudhë vunë firmën e tyre në fushën e regjisë Inajet Shehu e Hamza Abazi, të cilët konkuruan me mjaft dëshirë për të futur në procesin krijues elementë të rinj artistikë, që stimulonin kërkesat e trupës për arritje të reja. Veç aktorëve të vjetër e me përvojë, që ishin shtylla e shfaqjeve e premierave, një brez i ri aktorësh, me nur të veçantë artistik dhe me një gamë të gjerë interpretimi, erdhën në trupën artistike. Kështu, njëri prej tyre dhe më përfaqësuesi i kësaj prurje të re është edhe aktori i talentuar Behar Mera. Vitet kur Behar Mera filloi punë në Estradë lidheshin edhe me dyshen aktorese Agim Skara dhe Arjan Toçi, sa të talentuar aq edhe të dashur për spektatorin dibran.

Kjo periudhë artistike përputhet me fillimet e Estradës, kur ajo kishte treshen e talentuar: Adil Shehu, Hyqmet Elezi dhe Stefan Roçi, si dhe e vetmja aktore e e ardhur nga Shkodra, Vjollca Gega.

Në vitet '70, pas largimit të Vjollces, trupës iu shtua si aktore bashkëshortja e Skënderit, znj. Feriha. Me freskinë moshës e të një loje plot kolor, bartëse e humorit shkodran, ajo i dha shumë trupës së Estradës së Peshkopisë, por dhe fitoi shumë prej asaj trupe. Artdashësit dibranë shumë e deshën dhe e duartrokitën, nga fshati më i largët i Dibrës e deri në qytetin e Peshkopisë. Ajo ndikoi për mirë dhe në emancipimin e dhjetëra vajzave dibrane në ndërmarrje e shkolla, të cilat ju afruan dyerve të skenës së estradës dhe të teatrit amator; trupa artistike që deri në atë kohë vuanin pikërisht për elementin femëror.

Treshja e viteve 80-të ndryshonte nga moshja dhe cilësitë e veçanta që kishin, sepse të tre, veç materialeve humoristike letrare, si skeçet e monologjet, interpretonin me cilësi, art e temperament edhe paroditë dhe kupletet, sepse kishin vokal mjaft të mirë. Kësaj tresheje iu përshtat edhe aktorja Violeta Vladi e cila vinte nga afirmimi në lëvizjen amatore.

“Qenia në trupë e Inajet Shehut si regjisor e herë si aktor dhe aftësitë e tij për të shkruar materiale letrare e humoristike, krijonte mundësi të mëdha që aktorëve t’u servirej një krijimtari letrare, që u përshtatej mundësive shprehëse të çdo njërit prej tyre.

Inajet Shehu, jo vetëm shkruante vetë, por porosiste dhe qëmtonte skeçe, monologje, parodi e grimca humoristike edhe te bashkëpunëtorët dibranë dhe krijues të tjerë të gjinisë së humorit nëpër rrethe të ndryshme të vendit. Nuk mund të rri pa përmendur disa materiale humoristike të Sami Shehut, i cili ishte mjaft i njohur në lëvizjen amatore të Peshkopisë si krijues dhe ekzekutues. Vlerat e materialeve të Sami Shehut qëndronte te prioriteti, që kishte problematika e fshatit, ku ai shërbente si mësues e drejtues i kulturës. Regjisorët e kishin të siguar suksesin te këto materiale, sepse ato e kishin provuar, suksesin më parë duke u shfaqur e parë nga dhjetëra e qindra spektatorë”, - shkruan Skënderi në kujtimet e tij.



Dimër, në Peshkopi, S. dhe F. Cala, H Ndreu, Nj. Iskurti (Shehu), T. Krroqi

Në vitin 1984 nis udhën krijuese edhe Teatri Profesionist i këtij qyteti, i cili filloi të shtonte nga viti në vit repertorin e tij, ndërkohë që lëvizja amatore kishte krijuar ecurinë e vet dhe vazhdonte rrugën me një traditë të lakmueshme dhe frytdhënëse.

Roli i Skënder Calës si regjisor dhe aktor njëkohësisht është padyshim përcaktor i ardhmërisë së suksesshme të këtij teatri profesionist.

Fejesa dhe ndërtimi i familjes me Ferihanë

Bashkëkohësit e mbajnë mend Skënder Calën, jo si një nga ato “studentët e qejfit”, që u hapeshin rrugët, dhe femrat “binin përmbys” pas tyre, por si studentin serioz e të përkushtuar për degën, që kishte zgjedhur dhe njëkohësisht si të riun për të



cilën familja konsiderohej e shenjtë. Njerëzit e afërt që kishte në Tiranë, sidomos gocat e dajës dhe të tezes, Bukuria, Lili, Beli e Shyqja, i kishin propozuar që të njëhej me vajza, që sipas tyre ishin të mira, por siç thonë plakat "s'ishte e shkruar të ndodhte". Dhe kështu ndodhi. Pa ndonjë arësye të fortë, i mohonte propozimet e tyre, megjithëse ndonjëherë edhe e njëjtte dhe e konsideronte si ndër vajzat e mira.

Një ditë e thërret në shtëpi djali i xhaxhait të nënës, Muhameti, bashkë me të shoqen Nafien. Kur shkoi aty, gjeti edhe një vajzë të re, të gjatë e simpatike. Dhe siç e pohon edhe tani pas 5 dekadash, zemra ia bëri “bam”.

Pas ca ditësh u fejuan me Ferihanë, vajzën nga Shkodra, rritur jetime, me një nënë të shkëlqyer, të urtë e bujare, si Mejreme Shkodra, dy vëllezërit Ibrahimin dhe Fatmirin, si dhe motrën e madhe Myneverin.

Me të marrë fjalën nga pala shkodrane, se ishin dakord për fejesën, i dërgoi telegram Familjes në Dibër, për t'ua bërë të ditur...

Atë vjeshtë, që u fejua me Ferihanë, bereqetet nuk qenë të

mbara dhe kjo për Skënderin do të thoshte më pak ushqim, më pak veshje dhe më pak gjëra të tjera për jetesën.

Nga fejesa pak gjëra mban mend, por gjithësesi disa detaje s'i ka harruar. Kështu ai kujton atë kohë, kur babai i tij shiti një kuintal groshë për t'i blerë unazën e martesës. Ajo unazë jo vetëm e lidhi përjetësisht me gruan e jetës, por u bë një refren i dhimbshëm i varfërisë, që i sillte ndërmend sakrificën e familjes për një çast dinjiteti, që shprehej në një unazë floriri.

“Me qytetin e Shkodrës, gjithmonë kam pasur një lidhje të brendshme shpirtërore, e cila nuk kishte të bënte vetëm si vend i nënës. Që në fëmijëri përpiqesha të flisja si shkodran, të mësoja e këndoja këngë shkodrane, të lexoja për Kalanë e Rozafës e Liqenin e Shkodrës, të shihja me ëndje dhe të mrekullohesha me fotografitë e Marubit e pikturat e Kol Idromenos, Simon Rrotës e Kel Kodhelit, të përpihesha i tëri nga vargjet poetike të të mëdhenjve Fishta, Mjeda e Migjeni. Fejesa m'i forcoi më shumë lidhjet me këtë qytet të vjetër, si qendra më e rëndësishme e kulturës dhe e qytetërimit shqiptar”, - shprehet Skënderi. Nga rrëfimet e tij mësojmë se pasi mbrojti diplomën, dokumentet ia mori Ministria e Kulturës dhe kjo do të thoshte që ai do të emërohej në Teatrin Popullor. Gjithashtu, Instituti i Arteve kishte bërë kërkesë, që të emërohej si pedagog në degën dramatike. Kjo nënkuptonte që në të dyja variantet Skënderi do të mbetej në Tiranë. Këtë gjë e mësuan edhe familja e Ferihasë dhe u gëzuan shumë. Dhe padyshim edhe dëshira e tij ishte që të emërohej në Tiranë. Por Peshkopia nuk e la, sepse, sipas autoriteve të këtushme të asaj kohe, ishte tepër i nevojshëm për atë qytet.

Kur mori vesh e ëma e Ferit, nënë Mejremja, se Skënderi nuk do të qëndronte në Tiranë, kishte thënë: "Po ta dija se do të shkonte në Peshkopi bija ime, jo me kenë Skënderi, por Mbreti, s'kisha për t'ia dhënë vajzën". Ndoshta, kjo shprehje kishte qenë një pakënaqësi e çastit, pasi Peshkopia me Shkodrën s'ishin larg njëra-tjetrën. Më vonë, kur u martuan dhe nënë

Mejremja nisi të vinte më shpesh, jo vetëm që e deshi këtë qytet, por respekt të veçantë pati për prindërit e Skënderit, pas të cilëve shkoi disa herë në fshatin Lugjej, ku ato rrinin.

Feriha e Skënder Cala janë padyshim artistë të mirënjohur, jo vetëm në Dibër, por në gjithë Shqipërinë. Ata i kanë dhënë shumë artit dhe kulturës në Dibër dhe në gjithë Shqipërinë.

Më 23 gusht 2019 ata mbushën 50 vjet martesë. Gjysmë shekulli jetë bashkëshortore dinjitoze. Së bashku në familje, në shoqëri e në skenë. Ata ishin dhe mbetën simbol i bukurisë, mençurisë, fisnikërisë dhe dinjitetit njerëzor.



Në dasmën e Skënderit

Kujtime që të dalldisin shpirtin

Po të ndjekësh muhabetin në një mexhlis burrash në odat dibrane, të duket vetja sikur je në një teatër të vërtetë, sepse fjala merret sipas rëndësisë të personazheve që marrin pjesë në atë mexhlis, duke folur në bazë të pozicionit, ku janë ulur dhe renditjes, si, miqtë, të moshuarit, të zgjuarit etj.



Çifti Cala dhe Jonuz e Sibe Cala

Në këtë teatër të improvizuar, i zhveshur nga shumë aksesore, vetëm fjala është ajo që thur dhe zgjidh intrigën. Duke parë nga jashtë këtë lloj teatri, mrekullohesh prej lojës dhe interpretimit të pjesëtarëve të mexhlisit, të cilët veprojnë pa u diktuar nga organizimi regjisorial. Burrat e ulur në odë dëgjojnë, reagojnë, vlerësojnë, miratojnë, kundërshtojnë, marrin pjesë aktive duke vepruar nëpërmjet fjalës ose duke bluar me monologun e brendshëm ngjarjet, që ndodhin në këtë dhomë të odës dibrane. Ngjarjet në këto shfaqje jetësore janë reale, të njohura, por situatat që krijohen për zgjidhjen e këtyre

ngjarjeve e fakteve bëhen gjithnjë e më të sofistikuarra, sepse vetë gjuha e Dibrës është e tillë, e cila filtrohet nëpërmjet analizave laboratorike, që kalojnë nëpër rrugët plot labirinte për të dalë tek e vërteta.

Po, të tillë janë dibranët, e tillë është Dibra; e bukur, e pasur, e pastër, e zgjuar dhe optimiste për të ecur gjithmonë përpara.

Kush jetoi në Dibër, e krijoi miqësi apo shoqëri me dibranët, ka nostalgji për atë vend e ata njerëz që janë të një race të veçantë njerëzore të bukur e të admirueshëm.

Duke sjellë në vëmendje ngjarje e rrethana që e burruan dhe e mençuruan dhe duke u ndalur veçanërisht te njerëzit e thjeshtë të familjes së tij, Skënder Cala rrëfen një ngjarje gazmore të vërtetë, që lidhet me nënën, me babën dhe vjehrrën e tij.

“Thonë e ç` nuk thonë për vjehrrat. Që janë ngatërrestare, magjistare, ndajnë djalin nga prindërit, bëhen zot e zonja në shtëpinë e dhëndrit. Ndoshta mund të jetë kështu, por ndoshta dhe s`mund të jetë... Por fati e ka dashtë që unë të mos prekem nga sëmundja e rrezikshme e vjehrrave sojsëze. Kushdo që e ka njohur atë plakë të vogël, të imtë, shëndtëligë, të urtë e pa llafe, besoj se më jep të drejtë”, shprehet Skënderi.

Vjehrra e tij quhej Mejreme Shkodra. Them “quhej”, sepse s`është më, iku në atë botë me buzë duke qeshur, e pafajshme, e dashur dhe e mirë, ashtu siç edhe erdhi e jetoi në këtë jetë.

Kur Skënderi u fejua e më vonë u martua me Ferihanë, prindërit e tij flisnin me një respekt të madh për Mejremen. Kjo për faktin se ajo plakë myslimane, qibare, e pastër, e drejtë, siç thonë dibranët “pa shufla”, u ngrit nga Shkodra dhe shkoi në Lugje, te pleqtë e Skënderit edhe pse me shëndet jo të mirë dhe me lodhjen që i shkaktonte njëra këmbë, e cila i dhimbte shpesh herë.

Mejremja nuk e njihte fshatin, por i pëlqeu ai vend mes ujërash e zabelesh, me një baçe për t`u pasur zili, plot pemë,

bar e lule, ku uleshin e ngriheshin çdo ditë njerëz të fshatit e fisit, miq, fëmijë, kalimtarë, të cilët bisedonin a pinin kafe apo një gotë ujë a dhallë me Selman e Hajrie Calën, ndërronin dy llafe e largoheshin plot respekt.

Nëna e Skënderit, Hajria, ishte mjaft e zgjuar dhe e kishte të vështirë të bënte paqe me të gjithë. Mirëpo me Mejremen “i pajdisi muhabeti” dhe bisedonin me njëra-tjetrën pa pasur frikë se mos po nxirrnin ndonjë sekret dhe do ta merrte vesh i gjithë pazari.

Prindërit e Skënderit nuk bezdiseshin nga prania e vjehrrës së tij, sepse siç thoshte babë Selmani “krushka është pa shpenzime, një kafshatë buke, një thërrime djathi e një gotë ujë”.

Aty nga viti 1976, në vjeshtën e mbrame, kishin ardhë me ndenjtë në Peshkopi prindërit e Skënderit. Ndenjën nja një javë dhe kur po bëheshin gati me ikë në fshat, vjen Mejremja nga Shkodra e për hatër të saj qëndruan me të edhe dy-tre ditë të tjera.

Ishin festat e nëntorit dhe siç ishte bërë traditë, para turizmit jepej një koncert i madh me pjesëmarrjen e forcave më të mira artistike të rrethit. Edhe Skënderin e kishin caktuar të këndonte dy këngë: “Korrieri partizan” dhe “Moj Hatixhe”.

Feri së bashku me tre pleqtë kishin zënë vend diku afër verandës, ku jepej koncerti dhe qëndruan aty deri në fund kur u shpërndanë njerëzit. Koncerti shkoi mjaft mirë dhe Skënderin e pritën mirë. Kur shkoi në shtëpi, gjeti një atmosferë të ndezur me plot diskutime, ku Feri drejtonte bisedën për koncertin, por kryefjala e kësaj bisede ishte Skënderi.


Sa hyri brenda, i pari u ngrit babë Selmani e pas tij me rradhë e përqaftuan e uruan për koncertin. Ferihaja gjatë gjithë koncertit kishte regjistruar në memorje gjestikulacionet, dialogjet, belbëzimet, pasthirmat, plastikën dhe mimikën e portreteve të pleqëve, sidomos, kur këndonte Skënderi...

Katër vëllezërit Cala...

S. Cala me vëllezërit, Beshirin, Petritin dhe Naimin

Secili nga katër vëllezërit Cala ka karakterin cilësitë psikofizike, dhuntitë dhe talentin e vet. Çdo njëri ka emrin, dijet dhe formimin e tij.

Me Beshirin, ndonëse vëllezër, respekti e dashuria për njëri-tjetrin, si dhe mosha e përafërt i kishte bërë më shumë shokë.



Që në fëmijëri, ishin bërë si vëllezërit siamezë. Dëshirat për lojërat dhe sidomos për t'u marrë me librin ishin të mëdha. Leximi i librit u bë moto e përbashkët. I lexonte fillimisht Skëndëri librat me tregime, novela, drama, apo romane dhe përfundonin në duart e Beshirit, i cili, si dhe i vëllai, “i përpinte” e nuk i linte të binin në tokë.

Skëndëri e kishte pasion futbollin, duke qenë qendër-

sulmues i lagjes së dibranëve, por futbollist u bë Beshiri, i cili, për disa vite luajti me skuadrën e Peshkopisë.

Kënga është një pjesë e artit muzikor, që krijon një gjendje emocionale të pazakonshme në jetën e njeriut. Këndonin të dy vëllezërit, por Beshiri i binte në qafë atij lloj arti, ndërsa Skënderi ishte i pranueshëm, e pse jo, i suksesshëm! Dhe ai u bë këngëtar, por Beshiri ia kalonte te pjesëmarrja në grupet teatrore. Ai luante skeçe, krijonte poezi satirike, në mbrëmjet e Vitit të Ri bëhej plaku i Vitit të Ri, pavarësisht moshës së re. Kishte qejf të recitonte dhe dallohej në këtë drejtim. Edhe kur ishte pionier dhe më vonë, si nxënës në shkollën pedagogjike dhe si mësues fshati angazhohej nëpër festivale teatrore dhe dallohej si aktor me të dhëna të mira, duke u lauruar si i tillë në takime lokale dhe kombëtare.

Ky prioritet krijonte përshtypjen se ai do të ecte para vëllait të madh, mirëpo regjisor dhe aktor u bë Skënderi. Ai studioi, artin dramatik. Vetëm në një shfaqje kanë luajtur bashkë të dy vëllezërit, në tragjedinë “Ai vdiq në këmbë” të Kujtim Spahivoglit, Skënderi ishte regjisor dhe luante heroin kryesor, Skënderbeun, ndërsa Beshiri ishte në rolin e Lekë Dukagjinit. Në atë kohë ai studionte për dramë në Institutin e Arteve dhe kursi i tij e kishte vënë këtë tragjedi në skenë.

Skënderi tregon se në atë kohë u sëmur aktori që luante Lekën dhe prandaj thirri Beshirin të luante në vend të tij. Rastësia bëri që me vëllanë të luanin bashkë për herë të parë dhe të fundit në një vepër teatrore. Por në një profesion e la Beshirin të marshonte i lirë, pa pasur frikë se do ta konkuronte, në atë të ushtarakut, megjithëse edhe Skënderi u bë oficer rezervist, por pa pretendime për karrierë.

Edhe Naimi, vëllai më i vogël, ndoqi shembullin e Skënderit, por pa arritur të ngjitej në nivele profesionistësh. Ai mbaroi Liceun Artistik “Jordan Misja” për muzikë dhe përfundoi mësues fshati me gjithë dëshirën e madhe për të vazhduar studimet e larta.

Sikur ai të kishte pasur mundësi të shkonte në universitet, do të ecte përpara, sepse aftësitë nuk i mungonin, por ai “u dogj” për hir të prindërve, të cilët s’mund t’i linim vetëm në fshat. Tashmë, ata i kishin mbushur vitet e pleqërisë dhe donin përkujdesje, e cila nuk u mungoi nga Naimi dhe e shoqja, Naxhia, gjer ditën që u larguan nga kjo botë.

Ndërsa vëllai për të cilin Skënderi ka më debulesë është Petriti. Ai ishte më bukuroshi e simpatiku ndër katër vëllezërit, me sytë bojëqielli, flokët e zinj me onde, fytyrën gjatoshë ngjyrë gruri, me trupin të gjatë si fildish. Petriti i ngjasonte babës, për të cilin nëna u thoshte, se *ka qenë mashkull mjaft simpatik*.

Petriti ka qenë dhe mbetet ndër vëllezërit Cala, që gjithë jetën e ka çarë me gjoks, duke iu falur punës me krahët dhe shpatullat e tij.

“Sikur të isha piktor i vërtetë dhe të merrja përsipër të kompozova një detaj, që personifikonte karakterin e një punëtori, padyshim si model do të merrja dorën e vëllait tim. Dora e tij është në harmoni të plotë me trupin dhe krahun e rëndë si tra lisi. Ajo është e madhe, me gishtërinj të gjatë e të fortë, burrërore e çarë si krisjet e tokës nga vapa e verës, apo si degëzime të një përroi të egër që gërryen tokën, gurët e rrënjët e lisave”, - shprehet Skënderi. Ai ndjen dhimbje dhe siç thotë “i djeg në shpirt” kur edhe sot e shikon në gropën e servisit të makinave, duke hapur e vënë pjesë këmbimi, në verën e nxehtë, apo në dimër, ku çdo pjesë metalike e makinës ngrin nga akulli. Megjithëse kokën e ka te “retë” ai ecën me këmbë në tokë, duke qenë optimist për jetën e duke rritur fëmijë të shëndetshëm.



Peshkopi, duke e përcjellur babën për Tiranë



Nga tragjedia "Ai vdiq në këmbë"

-II- Profil



Nga drama "Rrënjët"



Dajat e Shkodrës, në dasmën e Beshirit



Në dasmën e Naimit

I virtytshmi dhe kurajozi Skënder Cala...

Duke dashur ta përmyllë kronologjinë e jetës, në përpjekje të vazhdueshme për të vënë një gur në zhvillimin e artit e kulturës në Dibër, Skënder Cala e ka të vështirë të shkëputet, mbasi kujtimet vërshojnë si ujë i përrenjve të rrëmbyer që turbullojnë lumin e madh të Drinit e si klladat, gurët e drurët që bien me hers në ujë, ashtu edhe fakte e ngjarje të reja dalin në ekranin e kujtesës së tij dhe kuadri i jetës hapet përsëri.

“Jemi në fundin e viteve 80-të, kur mjerimi e fukarallëku na kishte pushtuar mish e shpirt, kur ekonomia socialiste po rrënohej orë e çast dhe kur komunizmi i trumbetuar si emblemë e popujve, po jepte shpirt. Në Dibër, si në gjithë vendin, burgjet po tejngopeshin e neni 55 po bënte kërdrinë. Targat e veturës së Degës së Punëve të Brendshme “Gaz 69” i regjistronin fëmijët që lindnin dhe pleqtë e vjetër.

Kënga "Enver Hoxha, tungjatjeta", marshi "Në ara, fabrika, kantiere", nuk frymëzonin më, “Për ty atdhe”, nuk ngjallte më ndjenja krenarie, sepse atdheu ishte rrënuar nga varfëria e po jepte shpirt.

Valët e tërbuara të tërmetit të demokracisë filluan të japin lëkundjet e veta edhe në Shqipëri. Ra muri i Berlinit.

Në Timishoara të Rumanisë, komunizmi i Çausheskut vulli zjarrin e vdekjes, duke vrarë popullin e pafajshëm.

Në qytetin e Peshkopisë kishte filluar të frynte një erë e re, e cila ndjehej nëpërmjet përplasjes me dimrin e egër që po kalonim.

“Agallarët e kuq të Dibrës” filluan të heqin kostumet e shtrenjta, që kishin veshur dhe “po kërkonin të mbathnin çorape leshi me midiskame, opinga lope, e të vishnin tirq e koporane me kësulë të bardhë”.

..Kur parada e re e modës kishte nisur të paraqitej si një ndryshim i lejuar, një ditë i lajmëruan për një mbledhje të përgjithshme në Shtëpinë e Kulturës.

Ishte vjeshtë e vitit 1989, kur plenumet e jashtëzakonshme të KQ njëri pas tjetrit indirekt jepnin alarmin se PPSH-së, (e sëmura e Ballkanit), duhej t'i zgjatej jeta, sepse ishte në grahamat e fundit. Sekretari i dytë i Partisë së Rrethit, B. Z. donte të tatonte pulsën e punonjësve të artit e kulturës, deri ku kishte arritur mjerimi intelektual dhe frika ndaj Partisë.

- Partia kërkon nga ju ndonjë mendim se ç'duhet bërë që të ecet përpara, ç'duhet ndryshuar në stilin dhe metodën e punës, që të nxitet prodhimi, që të forcohet ekonomia dhe çfarë duhet kërkuar te kuadrot kryesorë të partisë e pushtetit në vend, cilat janë dobësitë, pse kanë ardhur, si duhet luftuar për përmirësimin e gjendjes.

Shihej qartë se punët po merrnin rrokullimën dhe sistemi mezi po mbahej. Që gjendja nuk ishte në rregull shihej qartë, sepse kryetari i shtetit ditë e natë përpëlitej në rrugë, ara, uzina, ndërmarrje, në Plenumet e Partisë, për të gjetur mundësi të reja për ndryshim dhe merrej me kopshte, pula e vezë, me parcela, dhi e keca të furnizonte popullin me qumësht, por e kishte marrë ferra uratën, se çdo gjë kishte shkuar ku s'mbante më.

I pari, pas tij e mori fjalën regjisori Skënder Cala, i cili u ngrit gjithë mllef, sepse për të kishte shumë material. Pak a shumë ai i dha këtë përgjigje funksionarit të lartë të Partisë në rreth:

“Mënyra si na e paraqitet gjendjen, nuk është se ju e ndjeni me të vërtetë se duhet të merrni mendimin tonë për të përmirësuar situatën, por e shihni se gjendjen e keni katandisur si mos më keq, sepse keni marrë rreth vetes një grumbull servilësh, me të cilët ndani të mirat, dhe të këqijat ua jepni popullit. Or baba, ne nuk jemi kosh plehërash që ju të na hidhni pislleqet tuaja... Sepse ti me servilët tuaj, java shtatë dhe e teta në Tiranë...”

Dhe hakmarrja e sekretarit të Komitetit të Partisë që vërtetë e verbër. Aty për aty, i shpërfytyruar, e paralajmëroi Skënderin:

- Do ta shohësh ti, Skënder Cala, kush është aga e servil, unë apo ti që përpiqesh të injorosh Enver Hoxhën... !

Pas këtij hakërrimi të njeriut të kupolës partiake, ishte e natyrshme që Skënderi ta ndjente veten shumë ngushtë, pasi puna mund të shkonte deri tek hekurat.

Vetëtimthi u ngrit në këmbë nga vendi ku ishte ulur dhe me shumë forcë iu përgjigj:

- Mos e zër në gojë Enver Hoxhën, se po të ishte gjallë ai, për këto punë të pista që keni bërë në Dibër do t'u jepte gjysmën e lekut në lule të ballit.

Në kolektiv ra një heshtje mortore. Mbledhja u mbyll.

Në orën një pas mesnate, një nga shërbyesit e tij të devotshëm, pasi trokiti në derën e shtëpisë së S. Calës, i futi një copë letër, ku shkruhej: “Nesër në ora 8:00 të paraqiteni në Komitetin e Partisë”.

Dhe të nesërmen në zyrën e tij, kishte mbledhur tërë aparatit prej afro dhjetë vetësh. Bashkë me Skënderin kishin ardhur edhe dy shokë të kolektivit, Petrit Kuçi dhe Edmond Zhulali. Ky i fundit ishte thirrur njësoj si Skënderi, sepse në mbledhje bëri disa pyetje që e shokuan sekretarin e partisë.




Çifti Cala, në Dubrovnik

Ngjarjet që po rridhnin me shumë shpejtësi ndoshta i shpëtuan nga një arrestim i sigurtë Skënder Calën e Mond Zhulalin.

Kryetar i PR-së dhe Nënkryetar i Këshillit të rrethit Dibër

Eshtë i njohur tashmë fakti që artistët i paraprinë lindjes së pluralizmit politik në Shqipëri. Skënder Cala, që i kishte shfaqur hapur pikëpamjet e tij kundër sistemit të dështuar social-komunist, padyshim që do të ishte në avangardë të ndryshimeve epokale të pas '90-ës. Artisti, që falë talentit të rrallë si regjisor, aktor dhe këngëtar, kishte mundur të shihte me sy realitetin ndryshe në vendet kapitaliste (si në Turqi, Suedi, ish-Jugosllavi, etj) gjatë turneve me trupat artistike të Dibrës, por dhe atyre të Kukësit e Tiranës, do të shpërthente me tërë forcën e mendjes e të shpirtit në funksion të mbarëvajtjes së procesve demokratike.



Skënderi, N/Kryetar i të parit pushtet demokratik, Dibër, 1992

Ndaj, nuk ishte rastësi që pikërisht S. Cala, së bashku me një grup intelektualësh dibranë, më 1991 do të krijonin degën e Partisë Republikane të Dibrës. Me përkushtim maksimal e organizoi këtë degë në gjithë rrethin e Dibrës, deri në skajet më të largëta, Lurë, Kala e Dodës, Katër Grykë e Klenjë, ndërkohë nuk nguroi të kandidonte për deputet, si përfaqësues i PR, në të parat zgjedhje pluraliste parlamentare të 31 Marsit 1991.

Në bashkëpunim të ngushtë me Partinë Demokratike, trajtoi me kurajo e kompetencë problemet e mprehta e serioze të asaj kohe të vështirë, kur mungonin gjërat më elementare, madje edhe buka për qytetarët.

Pas zgjedhjeve të para pluraliste lokale të korrikut 1992, zgjidhet nënkryetar i Këshillit të rrethit Dibër, që ishte i pari pushtet lokal demokratik në këtë rreth pas më shumë se pesë dekadash.

Në harkun kohor të tri viteve 1992-1995, si numri dy i pushtetit vendor në rrethin e Dibrës, S. Cala do të privohej disi nga talenti i tij në art e kulturë për t'iu përkushtuar zgjidhjes së halleve e shqetësime të shumta të bashkëqytetarëve të tij dibranë.

Ishin vërtetë kohë të vështira të fillimit të një tranzicioni të gjatë dhe pikërisht në atë kohë spikatin vlera tjera të këtij artisti të rrallë, tashmë edhe si politikan me pikëpamje perëndimore.

Rënia e regjimit komunist dhe fillimi i sistemit demokratik edhe në Dibër u shoqërua me vështirësi të panumërta, në përballimin e të cilave Skënder Cala do të mbate një peshë të dukshme. Kjo më evidente në procesin e ndërtimit të pushtetit vendor demokratik, pas rrëzimit të sistemit komunist, që kishte lënë pasoja të rënda, ndoshta në Dibër më të rënda se në çdo rreth tjetër të Shqipërisë. Pikërisht në vitet '92-'95 nënkryetari i Këshillit të rrethit Dibër, S. Cala, njëherësh edhe kryetar i Degës së Partisë Republikane të këtij rrethi, do të kontribuonte për një rilindje apo rindërtim të demokracisë, pa pasur një përvojë demokratike të mëparshme. Ishte koha kur ai do të

përqëndrohej kryesisht në trajtimin e dy aspekteve kryesore: atë të transformimit të pushtetit politik dhe ekonomik në Dibrën e rrënuar nga diktatura komuniste gjysmëshekullore.

Skënder Cala mbahet mend nga elita intelektuale e Dibrës për qasje interesante të trajtimit të problematikës që përjetoi shoqëria shqiptare gjatë kalimit nga një sistem politik autoritar në një tranzicion të transformimit demokratik.



Bllatë, 1992, hapja e kufirit me Dibrën e Madhe

Dhimbje dhe lotë

Nga Amerika i erdhi një garanci për të bërë një vizitë si turist. Ishte shoku i tij, Arif Vladi, ai që ishte kujtuar për një gjest të tillë fisnik. Nuk ka se t'a harrojë atë gjest bujarie, që rrjedh nga një zemër e madhe artisti e njeriu të mirë si Arif Vladi, që veç të mira di të bëjë.



Nju Jork, një drekë pas një pune të lodhshme në një nga çatitë e një supermarketi, 1994

Atë ditë që mori rrugën për në Amerikë pati shumë emocione. Njerëzit e afërt të familjes, Ferihaja, Zemritja, Beshiri, Sajmiri e Luani që kishin dalë për ta përcjellë se si i dukeshin. Një mendje i thoshte se s'do t'i shihte më, ndërsa nga ana tjetër luftonte me këto motive ndjellakeqe, duke shpresuar se do të kthehej patjetër në atdhe.

Kështu si Skënder Cala kishin ikur edhe emigrantët shqiptarë nga Korça, Gjirokastra, Përmeti, Kolonja, Shkodra e krahina të tjera të Shqipërisë dhe nuk u kthyen më, nuk i panë më me sy babën, nënën, vëllezërit, kushërinjtë, arën, fushën, pyllin, përroin, krahinën, fshatin, atdheun. Harruan vendin nga kishin ardhur, por edhe vendlindja i nxori nga kujtesa sikur s'kishin qenë kurrë në gjirin e saj.

Kur u nda me Ferihanë, gruan e tij, iu mblodh një lëmsh në

fyt, që sikur po i ngushtonte frymëmarrjen. Lotët që po derdhte i justifikoi, sepse ishte vetëm edhe s'dihej për sa kohë.

Fëmijët e Beshirit, Sajmiri dhe Luani iu hodhën në qafë si për ta ngushëlluar e bërë më të fortë, me bindjen se xhaxhi i tyre do të kthehej shpejt, por tek e fundit ajo kishte të drejtë.

Avioni po ngrihej mbi Rinas dhe sa më lart ngjitej ai, aq më të vegjël e më të padukshëm bëheshin njerëzit, objektet, ndërtesat, qytetet.

Kishte udhëtuar edhe herë të tjera jashtë shtetit, por kishte qenë ndryshe. Udhë më e largët, Turqia e Italia, ndërsa tani shfaqeshin detëra, oqeanë, toka, pyje, lumenj, qytete, shtete të mëdhenj e të vegjël, një pafundësi me ngjyra blu dhe kafe.

Pasi kaluan Europën dhe u futën në pafundësinë e deteve dhe oqeanëve, sytë ju mbyllën dhe mendja filloi t'i punojë sikur po bënte bilancin e jetës. Para syve i dilnin të parët e tij, nëna, babai, të mërëzitur. Gruaja s'i ndahej nga sytë e mendja dhe një pikë loti që i kishte mbetur në mjekër sikur ia zgjatonte portretin e përvuajtur nga dhimbja e moskthimit.

Si qenka kjo botë!? Në moshën 54 vjeç artisti me famë në Dibër, në mbarë Shqipërinë e hapësirën mbarëshqiptare, mbledh gjithë forcat dhe ëndërron të bëhet i fortë, muskuloz dhe të ngjitet e zbresë nëpër billdingjet dhe gradaçelat e Amerikës si një supermen filmash.

Hallakatet mendja në shtete, qytete, fshatra, në njerëz të largët e të afërm, në vite të shumta të punës dhe krijimtarisë në netët e gjymtuara të Dibrës, për të krijuar një premiere të re, një numër estrade, një komedi, dramë apo tragjedi.

Sa më shumë kalojnë vitet dhe shtohen rrudhat dhe thinjat, mendja e tij shpërndahehet në drejtime të ndryshme, për të kapur të gjitha anët e realitetit dibran, të cilat, për hir të së vërtetës, janë të shumta dhe mjaft të larmishme. Kudo ku ndalet, te jeta në përgjithësi, puna, mendja, trimëria, shpirti i lirë, te këngët e vallet, kultura materiale e shpirtërore në doke e zakone, Dibra e tij është e magjishme, plot dritë e hijeshi. Ajo reflekton

përsosmëri dhe originalitet duke u bërë një margaritar i rrallë i tokës shqiptare.

“Edhe në lindje edhe në dasma, edhe në të mirë edhe në të keqe, në karare odash e kuvende burrash, në gjëmime luftërash e në morte trimash e të urtësh, Dibra është shprehje e urtësisë dhe intelektit të fuqishëm, ku çdo gjë e bën jo për t’u dukur, por për nder dhe dinjitet... Jeta e artistit dhe mësuesit ka qenë plot pericepi, si endja e arrixinjeve me leckë e çadra në krah, fushave, maleve, luginave, zabeleve, buzë lumit Drin e rrëzë maleve të larta e burimeve, kudo ku rekëtinte shpirti i dibranit....”

Janë këto shënime të artistit, politikanit, publicistit, të urtit e të mençurit Skënder Cala, që të drithërojnë shpirtin.

Vajin e grave të Dardhës prej nga është edhe vetë e ka dëgjuar në sa e sa morte të miqve, bashkëfshatarëve e njerëzve të afërm. Është drithëruar prej emocioneve dhe dhimbjeve shpirtërore, kur i kanë vdekur xhajallarët Jahja, Vexhiu, Mersimi, babai, nëna, daja, hallat e tezja, por atë që ka provuar, kur vdiq djali i Beshirit, Sajmiri, mos e provoftë njeri. Ishte shpirti i nënës, kunatës së tij Zemrites, që “i çmëndi” me gjuhën e dhimbjes, vuajtjes e vdekjes nëpër breza, peripecitë e një jetimi që jeta kurrë s’e deshi.

Sytë i dhimbnin e digjnin si spec dhe lotët i pikonin mbi gjoks nga malli, që ndjente për Sajmirin. Futi dorën në xhep që të nxirrte një façoletë, kur avioni nisi të ulej e sa çel e mbyll syte u ndalua në një pistë të gjatë sa disa herë bulevardi i qytetit të Peshkopisë.

Një vit në Amerikë...

Kur stjuardesat lajmëruan, që kishin arritur në Amerikë, para tij u shfaqën gradaçelat si majë malesh të thepisura. Në gjirin e Hudsonit, “Statuja e Lirisë” lartësohej me dorën lart, si për t’i përshëndetur dhe uruar mirëseardhjen në tokën e premtimeve të mëdha, në tokën e zjarrtë të lirisë e demokracisë.

Aeroporti “Kenedi” u shfaq si një qytet i madh. Avionë, autobuzë, makineri e agregate moderne, njerëz që qeshnin, uronin, lëviznin me shpejtësi, policë, ushtarakë, ambulanca, taksi me shumicë, shoferë që kërkonin klientë, parulla e pankarta të varura në qafën e pritësve, lot gëzimi fytyra të qeshura mimika të ndryshuar në çast prej habitës dhe hamendësimit të njerëzve që nuk ishin parë kurrë.



Duke ecur nëpër aeroport, S. Calës i dukej vetja liliput. Ishte shastisur fare, sikur nuk kishte parë aeroport me sy. Për një çast qeshi, sepse iu duk vetja si një fshatar që shkon për herë të parë nga fshati në Tiranë.

- Daja Skënder! dëgjoi një zë të njohur, të ëmbël e gjithë dashamirësi.

Timbri i zërit iu duk i njohur, por mbeti i hutuar se s'po merrte vesh nga po vinte. Tek dalja e e aeroportit për nga ishte nisur pa fytirat e qeshura të nipit të tij, Medatit dhe mbesës, Bukuries, të cilët kishin dalë ta prisnin bashkë me fëmijët e tyre.

Në shtëpi e pritën ngrohtë, me plot dashuri. Në sytë e fëmijëve dhe prindërve të tyre pa atë respekt, ngrohtësi e dashuri që e bënë me fletë. Medati e Bukuria e çarmatosën dhe e lanë pa mend. Atyre u qeshte zemra për vizitën e dajës së ardhur nga Shqipëria.

Në shtëpinë e Medatit u ndje qaq rehat, sa nganjëherë mendonte sikur ishte në Dibër të Madhe, tek vëllezërit e tij, Ganiu, Luani e Haxhiu, ndërsa Xhelalin kishte kohë pa e parë mbasi ai kishte kohë që kishte ikur nga Shehri dhe ishte vendosur në Kenerik të Amerikës. "Hallall të qoftë, moj dada Laze, për këto fëmijë që ke rritur, si njeri dhe tjetri, të dashur, të urtë, mikëpritës dhe të aftë për të përballuar jetën!" Dhe fëmijët e saj e deshën dhe respektuan nënën e tyre sa rrallë kush. Laze Sllova (Cala) shkoi në atë botë e kënaqur se e la shtëpinë plot me djem, vajza, nipër e mbesa.

Fëmijët e shëtiten nëpër Ballkan, Evropë e gjer në Amerikë. Nëpër aeroporte, hotele, restorante, në sheshe, në vizita të ndryshme mes miqsh e shokësh, djemtë e vunë përpara nënën e tyre të veshur allaturka, dhe ishin krenar për të, sikur të ishte mbretëresha e Botës.

...Kontakti i parë me Amerikën që mjaft tronditës. Sapo doli në rrugë me nipin, Medatin, u shokua. Për një çast kujtoi se do rrëzohet, por Medati i futi krahun, për ta mbajtur. Ia

largoi dorën si me lezet dhe një mal mallkimesh i dolën nga shpirti.

Amerika e befasoi, e tjetërsoi artistin e madh dibran dhe e bëri si një njeri që vjen nga thellësi e shekujve pa parë qytetërim me sy, pa dije, kulturë e arsim, një qenie pa identitet, me gjymtyrë të cunguara, me mendje të pazhvilluar.

- O Zot, - thirri, nën zë, - çfarë të kemi bërë që mbetëm si relike të një bote mesjetare?

Dhe mallkoi me gjithë shpirt. Do të donte të bërtiste si i marrë, por iu duk vetja shumë i vogël, pothuajse i pafuqishëm për të protestuar. Mallkoi dhe një herë sistemin, që na zhveshi nga besimi, pasuria dhe s'na la asgjë njerëzore.

Tek ecte rrugëve të Nju Jorkut, të atij shteti dhe vendi të madh pa e bezdisur dhe shqetësuar njeri, për një çast krijoi përshtypjen se ishte rritur e kishte marrë përmasa të tjera, si udhët, makinat, ndërtesat, fushat pa mbarim të Amerikës.

Atje s'kishte vlerë raca, ngjyra, besimi, por vetëm puna.

Dhe pasi pa me sy të mirat e Amerikës, kur s'kishte ç'të bënte gjithë ditën, Skënder Cala filloi të interesohet për punë.

Një ditë, pasi veshi një palë rroba pune, e pa veten në një kompani ndërtimi, që e drejtonte një dibran i shquar në komunitetin shqiptar të Amerikës.



Me nipin, Medatin dhe b/shorten e tij, Bukurijen, 1995

Për herë të parë në jetën e tij, po shihite me sy dhe po provonte ç'është kapitalizmi. Atje s'të pyeste njeri çfarë je, ç'shkollë ke mbaruar, çfarë tekash ke, por shtro kurrizin dhe puno me kapacitet të plotë, pa fjalë e pretendime të kota. Sipas punës në fund të çdo jave merrej rroga.

Dalëngadalë, nga regjisor, aktor dhe këngëtar i suksesshëm, S. Cala u kthye në një punëtor të mirë.

I vinte çudi, sa shpejt u përshtat me punën dhe me kërkesat që kishte pronari, me efektivitetin që kërkohej gjatë punës.

Proceset e ndryshme të punëve të rëndomta i dukeshin si premierat e reja të teatrit apo estradës, që realizonte dikur në skenë. Objektet që përdorte gjatë punëve të ndryshme, si çekiçi, metri, mistria, karroca, kazma, lopata etj, u bënë pjesë organike e arsenalit të tij teknik, pa të cilat nuk mund të kryente asnjë punë.

Medati dhe Bukuria e mbanin me gajret, duke bërë humor me të, për ta sjellë në formë, që të mos mërzhitej. Kur kishin pushim, sidomos mbrëmjeve, shkonin në ndonjë lokal apo bënë vizita të ndryshme te disa dibranë të njohur. Ata që ia kishin dëgjuar emrin u treguan të afërt e bujarë me Skënderin. Mbresëlënëse ishin vizitat tek Jonuz Ndreu, Bajram Cani prej Shënllëshni të Dardhës dhe padyshim në Kenerik, ku ishte vendosur nipi i tij, vëllai i Medatit, Xhelal Sllova.

I vinte mirë që tek ata njerëz të mirë e të dashur, pse jo edhe në mërgatën e shqiptarëve të Amerikës, sa herë që shkonte gjente një “copë Dibre” nga gjuha, zakonet e mikëpritja, sadoqë kishin kohë që kishin ikur nga ajo krahinë e përmendur shqiptare. Jonuz Ndreu e njoftoi një natë që të nesërmen do të shkonin në Sllovë. U habit dhe s'po kuptonte se ç'do të thoshte dhe me ç'kuptim e kishte shprehur. Të nesërmen erdhi te shtëpia e Medatit, e mori Skënderin me makinë dhe u nisën për rrugë. Pas dy orëve udhëtim u futën në një rrugë të hollë, mes një zabeli të madh dhe papritur u ndalën në një shtëpi karakteristike amerikane të ndërtuar me dërrasa...

Para shtëpisë, një bahçe e vogël dhe një vend për parkimin e makinës.

Aty kishte pemë dhe lule.

- Eja pas meje të dalim mbas shtëpie, - i tha Nuzi dhe ashtu bënë.

Skënderi habitej me rregullin, ku çdo gjë ishte e menduar me një planimetri sikur të ishte në Sllovë apo Lugje. Një lul ishte e vogël, me pemë të punuara me merak, me vijëza të holla uji, udhëza të ndërtuar me kulturë që të çonin te një kopsht për t'u pasur zili. Mbeti i shashtisur. Një kopsht që i kujtonte kopshtin e shtëpisë së tij në Lugje, që nëna e punonte me qejf të madh.

- Ja, - tha Jonuzi, duke treguar me dorë, - shife veprën time, or Skënder.

Aty kishte specat, domate, qepë, patëllixhanë e një seri asortimentesh bujqësore, që të shtonin kërshtërinë për të mos u larguar nga ai vend.

- Më kënaq, or Jonuz Ndreu, - i tha Skënderi me një farë euforie, që nuk ishte falso, por reale.

Ndërkohë mori tubin e ujit dhe nisi të ujisë lulet, zrazavatet dhe pemët e kopshtit.

Tek shihte atë copë vendi të punuar me sistem, me rregull, iu kujtua babai i tij, kur i fliste, për Cen Elezin, të atin e Jonuzit.

- Cen Elezi ishte aga, por punëtor i madh. Kur Reç e Dardhë shtriheshin nëpër oda e livadhe si kuaj, ai dilte nga mexhlisi, qoftë dimër apo verë, merrte belin apo shatin dhe punonte në bahçe.

Prashiste pemët, i krasiste, u fuste borë në rrënjë, që të mos çelnin lule herët, i vadiste e një sërë shërbimesh të tjera, sepse kishte mbaruar shkollën për agronomi në Turqi. Jo më kot populli thotë: "Bëm baba të të ngjaj".

Shpesh herë, Skënder Calës i shkonte ndërmend që të bëhej qytetar i atij vendi të madh e të bekuar dhe bëri edhe përpjekje për të realizuar një gjë të tillë, por nuk mundi të bëjë asgjë. Vëllezërit nuk ia aprovuan një gjë të tillë, as kunetërit.

Ferihaja u mërziu shumë dhe kur pa që s'po realizohej ajo dëshirë i kërkoi që të kthehej në Shqipëri dhe Skënderi ashtu bëri.

Një vit të plotë, pasi kishte provuar turistin pa para, kurbetliun e vonuar, tokën e premtuar, oshilacionet shpirtërore të një vendi që Zoti e ka bërë me aq dashuri për të jetuar e punuar të gjithë racat njerëzore, mblodhi një dorë plaçka, i futi në një torbë, me ca para të fituara me djersë, të fshehura në gji, si plakati qëmoti, dhe u kthye në vendlindje.

Sa ishte në Amerikë duke punuar nëpër billdingje e majë gradaçelave për meremetime muresh, tarracash, dyer, dritare, ndarje mjedisesh me knauf, i dukej vetja një qytetar i botës së madhe.

Edhe pse punonte me krah, ndjehej tjetër njeri, më i fortë, më i ri, më i ditur dhe i plotësuar në të gjitha anët.

Ishte bërë mjaft praktik, i papërtuar dhe s'e kishte problem që mbante në krah llaç, tulla, zift, mbeturina, karro dore e një arsenal të tërë veglash me të cilat synonte të siguronte paratë për të blerë një shtëpi në Tiranë, se me paratë që mund të shiste shtëpinë në Peshkopi, do të mbetej tërë jetën qiraxhi me lecka në krah.

Nipi i tij, Medat Sillova, tek i cili gjeti strehë për të jetuar sa kohë do rrinte në Amerikë, i fliste me zemër të bardhë, që ta hidhte tej sedrën e sëmurë.

- S'ka punë të keqe, or dajë, sa kohë merr paren e mirë. A më shef mua tri punë në ditë baj!, - i tha një ditë Skënderit, e ai ia ktheu në moment:

- Po, more nip, e kupton mirë daja, por mundin jetës ia pata

bërë për tjetër gjë. Të vij sot në Amerikë, në këtë moshë dhe të ngjitem nëpër pallate, billdingje, në tarraca e gradaçe, me llaç e tulla në krah se si më duket. Kam një barrë me shkollë e një jetë që jam marrë me art e kulturë. Paçin faqen e zezë ata që na katandisën në këtë shkallë, si varfanjakë të botës.

Skënder Cala gjatë një viti në Nju Jork, rendi në Bronks, Manhatan, Bruklin, Kuins e Stetajllon e Longajllon, nëpër dhjetëra e qindra rrugë, pallate, magazina, shtëpi prej tullash e dërrasash, e i dukej sikur ishte bërë qytetar i denjë i Amerikës.

Dibranët, që jetonin në Nju Jork, e njihnin mirë që ishte artist, që këndonte e merrej edhe me punë të tjera artistike, si regjisor, aktor etj. Për këto vlera e respektonin dhe ia dëgjonin fjalën.

Ndërsa vetë Skënderi është i lumtur që në Amerikë, për aq sa qëndroi e punoi, një gjë themelore nguliti në mendje: me mentalitetin që kishim s'mund të ecnim përpara, s'mund të ndërtonim demokraci dhe nuk do të realizonim kurrë ëndrrën e dëshiruar.

Po ndryshuam mentalitet, të ardhmen e kemi përpara dhe demokracia do të na buzëqeshë dhe ftojë në udhën e saj të begatë e të lumtur. Por çfarë po shohim, jemi larg kësaj ëndrre...



Një kujtim me Haki Cen Elez Ndreun, SHBA, 1995

1995-2000, shef i sektorit të artit në bashkinë e kryeqytetit

Në vitin 1995 Skënder Cala transferohet në Tiranë, ku deri në vitin 2000 punoi si Shef i Sektorit të Artit pranë Drejtorisë së Kulturës në Bashkinë e Tiranës. Rikthehet kështu në metropolin shqiptar, ku kishte lindur 56 vjet më parë.

Në qarqet artistike të kryeqytetit ai ishte një personalitet i njohur si regjisor, aktor e këngëtar, por tashmë i duhej të drejtonte një sektor të vëshirë, për të rindërtuar në Tiranë një art të standardeve perëndimore.



S.Cala me ish zv/kryetarin e Bashkisë Tiranë, Buron Kaceli dhe shkrimtarin Sulejman Mato.


Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës në Bashkinë e Tiranës, z. Shaqir Rexhvelaj, duke pasur dhe mbështetjen e Kryetarit të Bashkisë Albert Brojka e të nënkryetarit Buron Kaceli, me gjithë vështirësitë e panumërta do të arrinin transformimin rrënjësor të institucioneve artistike të kryeqytetit.

Veçanërisht në vitet 1995-1996, pati një bum të veprimtarive artistike. Hapja drejt botës perëndimore pati ndikim të dukshëm dhe në këtë kontekst. Bashkia Tiranë do të inicionte dhe mbështeste spektakle muzikore e koncertale, eskpozita të shumta pikturë dhe do sillte në Tiranë grupe e

artistë me famë botërore nga vende të ndryshme. Në këtë larmi veprimtarish, Skënder Cala ishte iniciuesi dhe organizatori parësor i tyre.

Rebelimi mafiozo-komunist i vitit 1997, padyshim do të linte pasoja të rënda, jo vetëm në dëmtimin e imazhit, por edhe të institucioneve kulturore-artistike të kryeqytetit. Por edhe në ato rrethana, Skënder Cala do të jepte shembullin vetjak në ruajtje të vlerave kombëtare artistike.

Ndërkohë që në vitin 1999, ardhja në Shqipëri e mbi gjysëm milioni shqiptarë (gra, pleq, fëmijë) të përzënë nga trojet e tyre në Kosovë, nga genocidi i pashembullt serb, vuri në lëvizje tërë aparatit shtetëror, për të sistemuar të ardhurit në vendstrehime provizore, Skënder Cala do të gjendej pranë tyre për t'ua lehtësuar sado pak dhimbjen. Ai, si dhe i gjithë personeli i bashkisë Tiranë, nën drejtimin e kryebashkiakut Albert Brojka, u bënë promotorë të solidaritetit të kryeqytetit në strehimin, ushqimin e përkujdesjen sociale për vëllezërit e tyre kosovarë, që invadorët serbë u kishin bastisur trojet. Me këtë impenjim, punoi ai deri në vitin 2000, kur doli në pension.



Te monumenti i Lekës Madh, Shkup



Drama "Doktori Pacient"


III

Libri dhe intervistat për librin



*Dueti Shehu - Cala, Ma ke gishtin për unazë.
Në fizarmonikë, L. Kola, J. Tase*

TONIN RROTA



KËNGËT E POPULLIT TIM

Kompozitor dhe kultivues i këngëve popullore dibrane



Festivali i Gjirokastrës, 1983

Një intervistë në kohën e duhur

Libri i ka pëlqyer gjithmonë dhe ka shpenzuar shumë për të. Që i vogël është lidhur ngushtë me leximin dhe është përpjekur të blejë librin e ri. Kështu, dalëngadalë ka krijuar një fond të pasur, sidomos me librin artistik. Ndaj nevojën për të jetuar e plotësuar kërkesat e familjes, pasi doli në pension në Tiranë, e lidhi me krijimin e një biznesi të vogël të shitjes së librit.

Kjo punë nuk e ka bërë të pasur, por e ka ndihmuar në rritjen dhe zgjerimin e rrethit shoqëror, sidomos atij intelektual.

Te libraria "Scala", pranë Ekspozitës "Shqipëria e Re" vinin klientë të sferave të ndryshme intelektuale.

Aty flitej e diskutohej për art, letërsi, shkencë, histori e politikë.

Skënder Cala është i lumtur që duke punuar në atë librari me pretendime modeste, është njohur me shkrimtarë, poetë, studiues, politikanë, historianë e artistë të fushave të ndryshme, të cilët në çdo punë tjetër që do të kishte bërë, s'do t'i jepej mundësia t'i njëhte.

Rastisi një ditë që një grua serioze dhe simpatike hyri në librarinë e tij dhe kërkoi të blinte një libër.

Përnjëherësh nga portreti i amortizuar nga vitet, por që i kishte rezistuar kohës, nga e folura dhe sidomos nga sytë e bukur që kishte, diçka iu fanit si një e njohur e viteve të shkuara, si një zë dhe fytyrë e takuar diku.

- Më falni, mos jeni Skënder Cala? - e pyeti klientja, si me ndrojtje.

- Po, - i tha, - po ju mos punoni në Radio Televizionin Shqiptar?

Buzëqeshi mjaft hijshëm, si një e pafajshme dhe me një lëvizje të lehtë të kokës miratoi pyetjen e tij.

- Të kam kërkuar këto kohë për një problem, që lidhet me zhvillimin e artit në krahinën e Dibrës, sidomos të muzikës

popullore të asaj zone. Pra, i dashur Skënder, duam që me ju të bëjmë një intervistë, të cilën do ta shoqërojmë edhe me repertorin tuaj muzikor që kemi në fondin e Radio Tiranës.

Pasi caktuan datën dhe orën e intervistës, ajo u largua.

Skënderit i erdhi mirë, që do të bënte një intervistë, por në veçanti u gëzua se do t'i krijohej mundësia për të parë se ç'këngë kishte të incizuara në Radio Tirana dhe në ç'gjendje ishin, si tingëllonin në kohën e sotme.

Intervista që e thjeshtë, por ishte ndërtuar në mënyrë të atillë që të rrokte një gamë të gjerë problemesh, që nëpërmjet kujtimeve të nxirrmin në pah punën e bërë dhe kontributet e artistëve dibranë për pasqyrimin e artit dhe kulturës shpirtërore të atyre njerëzve të mrekullueshëm, që jetojnë prej shekujsh në krahinën me emër të Dibrës.

I përmendi me radhë ato krijues, që kishin dhënë shpirtin e tyre në pentagrame për të krijuar fytyrën origjinale të muzikës së kultivuar dibrane. Përmendi Mynir Shehun, Hazis Ndreun, etj, që me krijimin dhe përpunimin e një numri të madh këngësh popullore, të cilat sot këndohen nga dhjetëra këngëtarë dibranë, dhe të krahinave të tjera.

Po kështu vuri theksin në këngën qytetare dhe përmendi si më të spikaturin, Tonin Rrotën, veprimtaria e të cilit la gjurmë të thella në lëvrimin e kësaj gjinie edhe pas largimit të tij nga ky qytet për në Tiranë, pranë Teatrit të Operës dhe Baletit.

Me mjaft simpati foli për krijuesit dhe drejtuesit e talentuar të shkolluar në Akademinë e Arteve në Tiranë, si Zef Çoba, Përparim Tomçini, Isak Shehu, dhe Edmond Zhulali, që e ngritën muzikën dibrane deri në zhanrin simfonik, me një orkestër të lakmueshme për çdo institucion artistik. Gjatë asaj interviste për Radio Tiranën, artisti shumëdimensional Skënder Cala, evidentoi ndihmesën e madhe që kanë dhënë për fuqizimin e artit edhe drejtuesit dhe instrumentistët Nazif Pijaneci, Dan Grosha, Jani Tase, Imer Seferi, Laim Kola, instrumentistët Xhemal Lushi, Nuredin Mazari, Iqmet Hoxha,

Linda Lushi, Faik Vojka, Ilmi Kacani, Abaz Leka dhe sidomos këngëtarët Melita Shehu, Muharrem Zajmi, Besim Çutra, Abdyl Sturçe, Sadete Miftari, Hazis Ndreu, Arif Vladi, Lirie Rasha, Flora Toska, Saje Poleshi, Vera Laçi, Fatime Bojaxhiu, Njovi Samara, Qerim Sula, Sherif Dervishi, Qani Iskurti etj.

Po ashtu solli kujtime për piktorin jetëshkurtër, por të talentuar Bajram Mata si dhe për bashkëpunimin me skenografët Lefko Popa dhe Zaim Elezi, që me aq përkushtim derdhën talentin e tyre në sa e sa premiera teatrale e në veprimtari të tjera artistike.

Qe një intervistë e këndshme ku S. Cala evidentoi gjithashtu edhe valltarët virtuoze popullorë Hazis Ndreu, Sami Selishta, Rifat Roka, Xhevat Fana, Myrvet Hakorja, Shaban Xhajku, Avni Ndreu, Esat Iskurti; instrumentista popullor dhe këngëtar si Myfterim Kupa apo fyellin e Isuf Tushës, që sa herë e dëgjoje te fuste në botën e magjishme... Foli edhe për lodrën e Dan Selmanit dhe meloditë e pafundme të curles së Halil Venishtit, të cilët kanë ngritur në këmbë publikun brenda dhe jashtë vendit.

Me mjaft respekt, kujtoi S. Cala, punën dhe suksesin e teatrit të kukullave, aq i dashur për femijët e Dibrës, duke evidentuar pasionin e regjisorit Veli Vraniçi që e ngriti atë institucion në nivele të larta interpretimi dhe ekzekutimi duke e bërë të njohur në shkallë kombëtare.


Të gjithë këta vepruan dhe derdhën aftësitë e tyre në botën e artit dibran, midis viteve '60-90-të.

Autori i librit “ Magjia e Dibrës”

Gjatë jetës së tij S. Cala ka shkruar shumë, sidomos artikuj studimor për profesionin e artistit, platforma regjisoriale, kritikë për shfaqje e premiera të ndryshme, pse jo edhe publicistikë për probleme jetësore, për politikë etj.

Të shkruante letërsi s’ë kishte provuar asnjëherë. Por edhe në këtë fushë ia doli me sukses, në sajë dhe të ndihmës së pakursyer të vëllait të tij, Beshirit...

Ato që kishte shkruar për vite të tëra i përpunoi artistikisht dhe me një gjuhë letrare të zgjedhur, frazeologji të saktë e stil të veçantë, i përmbloodhi në librin “Magjia e Dibrës”.



Një libër, ku rendit kujtimet e veta, por edhe të miqve e kolegëve, të cilët, për hir të së vërtetës, e kanë freskuar atë e kanë bërë më jetësor e të lexueshëm.

Në ato rreshta të paktë mbushur me ngjarje pikante ndiejmë dridhjen e shpirtrave të shokëve të tij, të cilat rektinë plot dashuri e respekt.

Më me hollësi, për vlerat e këtij libri, shkruan dr. Selman Mëziu, në recensën në vijim.

Koha të zbardhi, fisnikëria të dha shkëlqim (Mendime mbi librin “Magjia e Dibrës”)

Nga Dr. Selman Mëziu

Kam lexuar shumë libra, në gjini të ndryshme, me autor, shqiptar, grek, gjerman, francez, italian, kinez, spanjoll, danez, rus, bullgar etj. Tek të gjithë kam gjetur të ndërthurur personazhe të karaktereve të ndryshme, ku dramaciteti i tyre më ka pezmatuar, mirësia e bëmat heroike më kanë frymëzuar e emocionuar, ndërsa libri “Magjia e Dibrës”, i artistit e regjisorit Skënder Cala, më ka futur me ëmbëlsi e thjeshtësi brenda tij, duke më prushuar ndjenjat dhe elektrizuar trupin nga emocionet, me epikën e lirizmin e ngrohtë. Ai të prek, të zgjon emocione trufulluese duke përshkruar me ndjenjë atë që ai ka përshkuar përgjatë udhëve plot lakore, të përpjetash e teposhtesh të jetës.

Dhe ja me çfarë saktësie e bukurie shprehjesh e përkufizon: “Jeta e artistit dhe mësuesit ka qenë plot peripeci, si endja e arrixinjëve me lecka e çadra në krah, fushave, maleve, luginave, zabeleve, buzë lumit Drin e rrzëzë maleve të larta e burimeve, kudo ku rektinte shpiri i dibranit.” (fq. 236)

Njerëz që të duan

Me ndjenja të holla autori kërkon të japë çdo detaj të peizazhit përrreth apo të një mjeshtri të permendur. Ahmet e Remzi Cala e vinin çiftelinë në dizin e “oda mbushej me tingujt e ngrohtë të melodisë”.

Dan Selmani, mjeshër i violinës dhe i daulles “i ftonte valltarët që të realizonin figura të ndryshme koreografike me forcë dhe elegancë”. Dan Sabedini “ishte i ëmbël në instrument (çifteli) dhe këngë, zërin e kishte të vogël, por llafet i dëgjoheshin tamam dhe me theksin e duhur...”.

Atë natë dimri të vitit 1956, Skënderi u njoh me Kryetarin e Lokaliteit të Zallë Dardhës, Hazis Ndreun, i cili përgjatë librit do të jetë një ndër figurat dibrane më të përmendura. Ai nuk rreket të shkruaj që në faqet e para: *“Mëso këngët e Dibrës se janë flori, kanë melodi të bukur dhe tekste përrallorë”*, - më tha. Një këshillë që i dha zemër, që e frymëzoi dhe e mbajti vath në vesh për një pjesë të mirë në udhët e jetës si këngëtar artist dhe regjisor etj.

Sa me mjeshtëri autori e portretizon Hazisin: *“...fliste ngadalë dhe unë e dëgjoja atë sikur kishte në dorë fatin e jetës sime. Më dukej Hazisi edhe muzikant, edhe poet, edhe i ditur. I bashkoja këto të tri cilësi dhe nxirrja si konkluzion se Hazis Ndreu ishte njeri i mirë, që më donte dhe duhet të mbështetësha tek ai...”*.

Një figurë tjetër i ngulitet në mendjen e tij rinore, Riza Hajro i cili: *“...këndonte me pasion dhe kishte dëshirë të interpretonte bukur...”*. Sa me mjeshtëri dhe mendime konkrete, jep të detajuar portretin e tij: *“Shkolla jonë (gjimnazi i kuadrove të arsimit) kishte një drejtor mjaft të përgatitur dhe autoritar. Ai nxiste ecurinë e nxënësve, jo vetëm në orët e mësimi, por sidomos në veprimtaritë kulturore dhe sportive”*.

Me një valixhe prej dërrase, në të cilën mbante një fletore shënimesh, këngë, piktura e veglat e rrojes, endej monopateve dhe mendonte: Me sa duket do ta ngrys jetën në malet e Dardhës, Reçit e Çidhnës!!!

Profesionin e mësuesit e filloi në Soricë, ku jetoi te shtëpia e Islam dhe Rrahman Mëziut. Dhe ja, sa mirënjohës u është ai njerëzve që gjeti, takoi e bisedoi në mes këtyre maleve: *“...pata ‘profesor’ Isuf Lekën, leksionet për malet e malësorët, për traditat e Dardhës e të Reçit, si dhe marifetet e burrave të dheut m’i jepte çdo ditë Islam Mëziu. Ato mësimet morali më bënë mirë se më përgatitën për jetën”*.

Shkruesit Cala nuk i shpëtojnë nga kujtesa, jo vetëm emrat por edhe dialogjet e përshkrimet më të hollsishtme e më pas ai

të jep me plot logjikë, dhe bindshëm, përfundimet, si sintezë të atyre që ndodhën ose të marrëdhënieve të personazheve që ai takoi. Për karakteret e spikatura dhe gjurmëlënës ai shkruan: *“Gjuha e tyre ishte e veçantë me shifra e kode, godiste me pambuk, por therte gjer në kockë. Mjeti artistik, që përdornin ishte humori, që në esencë kishte një dramacitet e tragjizëm të thellë, që digjte e përvëlonte si zjarr”*. Dhe autori rradhiti emrat: Riza Poleshi, Selim Sula, Mane Kacani, Qazim Përnezha, Llan Kuçi, Mustafa Ndreu, Zaim Dervishi, Isuf Gjoka, Jahe Cala, etj.

Edhe kuadrot e atyre viteve, autori i përmend duke iu dhënë gjithë cilësitë e meritat e tyre, por edhe përkrahjen e kontributin për artin si shprehja e kulturës së madhe për të bukurën, të moralshmen, për kulturën e popullit tonë në përgjithësi.

Në bulevard ai shikon tre lurjanët: Ahmet Perlekën, Ahmet Kaçorrin e Lek Rajtën, të cilët hieshonin Dibrën e jo më Lurën. Sa me ndjenjë, pasion, dashuri e frymëzim e portretizon njërin prej tyre: *“Ahmet Perleka ishte burrë klasi, i ëmbël, autoritar, por edhe mjaft i këndshëm në muhabet, shtëpi e shoqëri. Ai s’kishte shkollë të madhe, por natyra e kishte përgatit me një intelekt për t’u pasur zili”*.

Sa në detaje, me forcë artistike dhe me kujdes, ai e portretizon vëllain e tij, Petritin: *“Ai ishte më bukuroshi e simpatiku ndër ne, me sytë bojëqielli, flokët e zinj me onde, fytyrën gjatoshë ngjyrë gruri, me trupin të gjatë si fildish...”*.

Kur autori përshkruan këto personazhe, të kujton stilin e mënyrën e shkrimtarit francez Honore De Balzak, pra me pak fjalë, kërkon të tregojë shumë, me një stil të kuptueshëm, tërheqës dhe rrëmbyes.

Udha e Këngës e artistit dhe regjisorit

Ishte fundprilli i vitit 1961. Ai tashmë do të këndonte në

trupën e Estradës Peshkopi. Skënderi kujton: “Për katër netë me rradhë bënim prova paradite dhe pasdite... Me datën 2 maj, Komiteti i Partisë miratoi shfaqjen me titull: “Të fala nga Korabi”, me regjisor Tefë Kroqin dhe dirigjent e muzikë Tonin Rrotën”. Frutet e saja ishin duartrokitjet dhe emocionet që përcillte tek artëdashësit që nga Tirana dhe në gjithë qytetet e Jugut të Shqipërisë. Nga *shkolla e të mençurve*, ai kishte dëgjuar një thënie: “Djali i mirë shtyn kufijtë e babës”. Shenjat e kësaj thënie të zgjuar e mjaft kuptimplotë po i realizonte me sukses.

Ndërsa mbarësinë, mirënjohjen, krenarinë për punën e bërë shkruesi Cala nuk e mban për vete sepse ai nuk është egoist, por i çiltër, i thjeshtë e zemër bardhë. Dhe ja si shprehet: “*Mjaft mirë u pritën edhe trupa e aktorëve, në veçanti interpretimi i humoristëve Adil Shehu, Hyqmet Elezi, Stefan Roçi e prestigjatori Haxhi Mata...*”. Sa me emocione përshkruan konkursin në këngë e artin dramatik, përpjekjet e tija natë e ditë, prova pas provash duke dhënë maksimumin e energjive fizike e mendore. Ai rradhit emrat e mjeshtrave të vokalit shqiptar si: Lluk Kaçaj, Ramiz Kovaçi, Mihal Ciko e Gjoni Athanas. E megjithëse e fitoi këtë konkurs ai paraqitet edhe në artin Daramatik, me kryetar jurie Andrea Malo, ku mori përgjigjen: “Hajde në shtator”.

Gëzimi ishte i papërshkruar, por atë ditë shtatori, kur ai mbante valixhen prej dërrase nuk i eci mbarë. E thirri në zyrë Jashar Mezenxhiu dhe iu shpreh me tonin e Sekretarit: “*Kemi nevojë për këngëtarë. Sa për shkollën, aty e ke. Do të shkosh vitin tjetër!*”. E kështu dëshira e gëzimi u shtypën me dhunë brenda qenies së tij pa më të voglën mëshirë.

Pas një viti autori i këtij libri kujtimesh shkon për të vazhduar studimet në Institutin e Arteve, si dhe merr pjesë në Estradën e Tiranës dhe atë të Ushtarit duke mos harruar e kujtuar me imtësi detaje e ushqyer rrespekt për udhëheqësin artistik Kujtim Spahivogli dhe pedagogët Naim Frashëri, Pjetër

Gjoka, Mihallaq Luarasi dhe Prokop Mima.

Edhe si student ai fillon të shprehë talentin e tij. Kështu fillimisht, luan me sukses rolin e Skënderbeut te tragjedia “Ai vdiq në këmbë”. Në vitin e tretë, rolin kryesor të kapiten Maksimovit te drama “Për ata që janë në det”. Ndërsa në vitin e katërt te drama e shkrimtarit Kolë Jakova “Halili e Hajria”, luajti rolin e personazhit kryesor, Halil Garrisë. Së fundmi, në jetën studentore luajti rolin e Xhafersonit te komedia e Foqion Postolit “Avokati Patl”. Dhe S. Cala konkludon: “*i bindur plotësisht, se isha i aftë të përballoja kërkesat e një teatri profesionist.....*”.

Në ngjitjen, në shkallët e viteve, autori nuk lë pas bashkëpunëtorët e tij të rinj, si kompozitorin Përparim Tomçini e Isak Shehu, muzikantin e ri Xhelil Imeri, këngëtarët e talentuar Arif Vladi e Qerim Sula, regjisorin dhe shkruesin e materialeve letrare e humoristike Inajet Shehu, aktorin e talentuar, humoristin Behar Mera, dyshen aktoreke Agim Skarra dhe Arjan Toçi, treshen e talentuar Adil Shehu, Hyqmet Elezi dhe Stefan Roçi dhe aktoren e ardhur nga Shkodra Vjollca Gega. Pasi i përshkruan me kujdes ish-kolegët e tij, duke specifikuar meritat dhe ecurinë e tij, shkruesi Cala vazhdon: “*Në vitin 1984 nis udhën krijuese edhe teatri profesionist i këtij qyteti... (Peshkopisë S.M.)*”.

Tashmë kujtimet marrin “zjarr”, kur dëshira e tij po realizohej për t’u bërë edhe aktor filmash, i përkrahur nga regjisorin dibran në kinostudion “Shqipëria e Re”, Gëzim Erebara, me filmin “Guximtarët”, në vitin 1969; pas dhjetë vjetësh në filmin kushtuar, Pesë heronjve të Vigut “Çeta e vogël”, me aktorët Ndrek Luca dhe Marie Logoreci. Vijoi me filmin “Kërcënimi”, përkrah Rajmonda Bulkut, Stavri Shkurtit Piro Kitës, etj. Dhe së fundmi në filmin “Bardhësi”, realizuar në faqet e Korabit në fshatin Zagrad, në mbi një metër borë.

E mbyllim këtë trajtesë me mendimin e tij të emancipuar, të matur, plot respekt për Dibrën, artin dhe artistët: “*Sa herë që*

flas për Dibrën, sidomos për arritjet e saj në fushat e ndryshme të artit teatral, në pikturë, letërsi e koreografi, më duket sikur akoma kam detyrime dhe laj borxhe për atë vend të mrekullueshëm...”.

Traditat dhe zakonet nga krateret e shekujve

Nuk mund të mos rrëmbehesh, kur rrjesht pas rrjeshti, paragraf pas paragrafi, përgjatë leximit të librit “Magjia e Dibrës”, të zbulosh traditat e lashta, doket e zakonet, instrumentat muzikor, vallet e këngët plotë heroizëm e melodioz, e të krenohesh me këtë pasuri të madhe të botës shpirtërore, morale e materiale të çdo fshati e të gjithë krahinës së Dibres. Lexojmë me kureshtje këto rradhë:

“...gjatë gjithë periudhave të formimit dhe të zhvillimit të tij ka krijuar doket dhe zakonet me këngët dhe vallet, veshjet dhe veglat bujqësore, ka bërë morte e dasma, ka lindur fëmijë e nënat u kanë kënduar në djepat e bukur të stilizuar e stolisur me figura e ornamente popullore me dru ahë e pishe. Kjo kulturë popullore... i ka shtyrë ndër shekuj të mbijetojnë duke punuar, luftuar e krijuar gjuhën dhe mjetet shprehëse të njerëzve, që e përbënin atë...”.

Nga kujtimet, shkruesi përshkruan Natën e Ditën e Verës si një “festival” ngjyrash, traditash, rritesh, të cilat së bashku “...shëmbëllenin me pinjollë të fiseve të lashta, që vinin nga thellësitë e shekujve për të treguar se jemi një racë e pastër...”.

Me virtuozyt e detaje të imta përshkruhet “Beteja e Baheve”, veshjet e burrave me koporane, tirqe me ngjyrë të zezë, brezi i mezit me pafundësi ngjyrash, çorapet e leshit me figura të ndryshme si yje, lule formë ndryshme, trekëndesha, kësulen e bardhë dhe opinga. Ndërsa të grave, me xhupin prej shajaku të bardhë me mori lulesh, këmisha e bardhë me qëndisje në jakë dhe dy mëngët, brekët e gjata të cilat janë të gjera dhe secili duhet të dalë pala-pala mbi çorapet me një mori

ngjyrash, ku shkëlqen brezi me lule dhe përpara varet poshterka, ndërsa në pjesën e pasme sallta, gjithashtu në kokë mbanin dy riza borë të bardha.

Secili duhej të ulej në vendin e vet. Në një dhomë me shumë burra, përcaktohej roli i atij që ulej në krye të vendit si rradha e të kërcyemes e të kënduarit në dasma, pse jo dhe e të folmes dhe ngritjes së dollive, ndarja e nishaneve të berrit në sofër, etj.

Autori pas këtyre përshkrimeve deri edhe te veglat e muratorit, kolibja e qenit, mashna, gardhet rrethuese, mullarët e kosharët e misrit, ku të gjitha krijuesi Cala i sintetizon: *“Kultura materiale e këtij populli është mjaft e gjërë... ku shprehet edhe në ornamentet popullore në të cilat janë skalitur në dyert e kullave, në mure, në ballë të oxhakut, sidomos figurat e diellit, yllit e shqiponjës. Po kështu edhe musandrat, varëset prej dërrase, që shërbenin për të varur pushkët, kaporanet...”*.

Peizazhe të dalldisura

Nuk i mungon dëshira e zjarrtë për të shprehur dashurinë mbi peizazhet natyrore e të krijuara nga dora e njeriut, ku ai magjepset, por edhe gjen qetësinë e shërimit, e njëkohësisht trufullon, kur këto vende bukurindjellëse i dëgjon apo shikon se shkatërrohen. Dhe ja penelatat e tij të përshkrimit: *“Në bulevardin me blir të Peshkopisë, ndoshta ndërtimi më me vlerë i viteve të socilizmit në atë qytet, pashë burra, gra, të rinj e të reja, që rreth xhironin me orë të tëra në atë mbrëmje, ku ajri i freskët, që zbriste nga mali i Korabit flladiste qytetarët, që s’ngopeshin nga kjo dhuratë e Zotit...”*.

Në kujtesën e të atit, Selmanit dhe të tjerëve, ai shënon me kujdes ndryshimet në paizazhin e dikurshëm që ka qenë tokë e Allahut, deri poshtë në Dohoshisht, ndërsa vetë Kameni ka qenë me dushk e lisa të vjetër. Dhe më poshtë autori sqaron,

duke depërtuar në korracën e së kaluarës: *“Fillimisht u hap si rrugë këmbësorësh, ku kalonin njerëz hallexhinj, korrierë që shpejtonin për të çuar një lajm për lindje a vdekje diku, pazarlinj me një bisht lope për dore....”*. Më pas ai nxjerr në dukje një ndryshim thelbësor, kulturor e qytetar, si dhe bukurindjellëse: *“Kur bulevardi u asfaltua, dikush e plotësoi atë me pemë bliri të cilat u bënë për të tempuj të gjallë, si kurora e artë për princërit, mbretërit dhe perandorët.”*

Ai përfytyron, fantazon e përshkruan se çfarë ndodh në të vërtetë në një hark kohor të caktuar në atë bulevard *“ku i gjithë qyteti merrte frymë e jetë nga një copë udhë e asfaltuar, ku nga njëri krah në tjetrin ishin rrjeshtuar politika, ideologjia, burgu e dajaku, ekonomia e financat, bankat, institucionet kulturore, teatri, estrada, kinemaja, teatri i kukullave e gjimnazi...”*.

Por veç entuziazmit, ngrohtësisë, kënaqësisë që ndien për qytetin e bukur verilindor, autori i librit Cala, shpreh anën tjetër të medaljes, pra si u katandis ai pas viteve '90 duke shprehur indinjatën e thellë e shtruar pyetjet për të ardhmen: *“Bulevardit i vjen pak era fshat, ashu siç i vinte para pesëdhjetë viteve, kur erdhëm ne. Po fillon një cikël i ri. A thua do të jetë në gjendje ky brez dhe të tjerë që do të vijnë pas tij ta rinojnë atë bulevard, ta bëjnë një tempull të gjallë të kulturës dibrane?”*.

Nuk i mungojnë fjalët e zgjedhura, truri i tij është një gurrë, e pashtershme kujtimesh të gjithëfarshme, ku i shpreh me finesë e shije, duke të ngjallur emocione të pandjera ndonjëherë: *“Gjatë një muaji pashë gjëra që s'do t'i kisha vënë re gjithë jetës, sepse s'do të më jepej t'i shkelja me këmbë gjithë ato fshatra, male, pyje, ara e livadhe, përrenj, kodra e stane. Profesor Çesku (Zadeja)...u mrekullua dhe në një çast pushimi, në pyjet madhështore të Arnit tha:*

- E ç'janë sinfonitë e mia para kësaj bukurie të papërsëritshme?!

Dhe kishte të drejtë! Duke lexuar këtë thënie lapidar, i dalë

nga peizazhi i mrekullueshëm i bukurive të pyjeve të këtyre anëve, nga thellësia e shpirtit të një artisti të madh, pas dyzetë e gjashtë vjetësh, duhet të themi se sinfonitë e Zadesë e sfiduan natyrën magjepsë të këtyre trevave, sepse ato janë kthyer në gërmadha të papashme e rrënjethëse nga njerëzit e politikat e qeveritarëve të këtyre njëzetë e tetë vjetëve.

Meditimi para një fotografie të Pazarit të Peshkopisë të viteve '30 të shekullit të kaluar, e që Skënderi e emërton "Pazari i kësulave të bardha"! E kundërta ndodh në vitet '50-të, po të këtij shekulli. *"...i ngjante një garnizoni ushtarak të shkatërruar nga lufta, me mure rrethuese të rrëzuara nga predhat e artilerisë, me mushka, kuaj e gomer të lodhur, kockë e lëkurë, që vinin vërdallë për të gjetur ushqim..."*.

Së fundmi, autori rrëshqet në prehërin e një të dëshpëruari nga realiteti përqark, i cili është shkatërruar e deformuar mjerueshëm. *"Bulevardi i Peshkopisë ishte i shkretë. As policë, as qen, asnjeri, as pianecë... Në asfaltin e shkoqur dhe të arnuar me mballoma zifti e betoni të bulevardit të heshtur, vetëm hapat e mia, dhe ekoja e tyre e zhurmëshme që përplasej me xhamat e dyqaneve, apartamenteve e institucioneve shtetërore...."*.

Dibra si tempull dhe rizgjim ëndrrash

Nuk mund t'a anashkalonte pa e prekur me penën e tij Dibrën si truall i filozofisë popullore, si apologje etnografike, me tradita dinjitoze e plot kulturë, si natyrë e ashpër dhe si muhabetçinjë e pjellë gjeneralësh ushtarak. Ai mendoi se mbasi shkoi për të ndjekur Institutin e Arteve, ecejaket për në Dibër, do të pakësoheshin e dalëngadalë do të zbeheshin kujtimet, por *"...Dibra sado të mundohesh për t'iu larguar, ajo t'i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare"*.

Skënderi nuk ka lënë në harresë objektivat e tij, që i kishte vënë vetes për Dibrën dhe gëzohej si fëmija, kur i realizonte

ato, fisnikërohej dhe shkollat e frymëzimit operonin thellë, duke zbuluar vyrtytet e dibranëve e cilësitë e tyre si burra e si buq, si mentar e mjeshtër të alegorive. Dhe ja çfarë “vizaton” gjallërueshëm pena e tij: *“Ëndërroja që Dibra të kishte një teatër, sepse kjo krahinë është e dalluar për zhvillimin e mendimit filozofik popullor, se dibranët e kanë të zhvilluar alegorinë, shenjë e një intelektit të fuqishëm dhe fantazisë krijuese, për të kapur tema të rëndësishme për fatet e popullit të tyre....”*.

Duke e futur me kujdes në dialog, autori ngre lart figurën e dibranes. Dhe ja sa me kursim dhe qartë e portretizon atë: *“Janë të zonjat dibranet, pak të sarta si ‘mushka të egëra’, por ta hanë dheun nën kambë. Lum kush i fut brenda, se ta kthejnë shtëpinë për së mbari”*.

Autori i librit “Magjia e Dibrës, S. Cala, thur një traktat filozofik, kur shkruan mbi Gropën e Dibrës: *“... që më dukej si një oktapod gjigand, me gjymtyrë e kthetra si të një përbindëshi”*. Jo, ajo ishte: *“vend me parime të forta morale, fetare dhe atdhetare”*.

Çfarë gatuhej në këtë guzhinë, siç e krahason autori Cala, Dibrën e Poshtme: *“... jeta e njerëzve, lindja, mbarësia e prapësia e tyre, martesat, fejesat, lidhjet miqësore, pasurimi apo varfërimi i tyre...”*.

Me elegancë, por saktësisht jepen cilësitë e vyrtytet e banorëve dibranë, të cilët dijnë: *“...t’a mbajnë pushtetin, dinë të drejtojnë, mbajnë fort njëri-tjetrin, njohin shkallët e hierarkisë dhe i respektojnë ato, por kur hijejarkët bëhen të rrezikshëm, ‘Gropa’ të heq shkamin e të bën gropën...”*.

...Hazis Ndreu e përcolli familjen Cala nga Peshkopia për së fundmi herë drejt Tiranës, duke iu thënë: *“U pafshim me hajer, mos na harro!”*. Dhe, i emocionuar sa s’ka më, mendimet që i dalin nga thellësitë e shpirtit, ai i konkretizon me penën e tij, kur shkruan: *“...dhe u largua duke më lënë me një peng të madh në zemër, si miku e shoku më i*

pazëvendësueshëm për kohët e mira e të këqia që kalova në qytetin e ëndrrave e zhgënjimeve të mëdha”.

Mënyra e ndërtimit të veprës, titujt mjaft të gjetur, fotografitë e shumta, dizenjo e paraqitjes, bashkë me përmbajtjen dhe peizazhin e mrekullueshëm të personazheve e mjediseve ku ato veprojnë, mendojnë apo zemërohen, qeshin, trufullojnë apo nxjerrin mjaltë nga goja, janë të ngjashme me themelet e muret e një kulle Dibrane, ku gjejnë mikëpritjen bujare e zemërbardhë, kushdo, lexues i thjeshtë, nxënës, student, gazetar, shkrimtar apo studiues i çfarëdo niveli moshe apo kulture.

Kur përfundon së lexuari librin e artistit e regjisorit të njohur Skënder Cala, dukesh sikur ke marrë me vete një mal me këngë, një gjerdan me emocione, që herë pas here shpërthejnë si fishekzjarre shumëngjyrëshe në qiellin e lumtur të jetës, një galeri të pafundme heronjsh e figura artistësh të mëdhenj, që të ngjallin krenari dhe të frymëzojnë. Artisti i talentuar Skënder Cala, librashitësi Cala dhe tashmë shkrimtari Cala, i cili me një mjeshtri artistike tërheqëse, me një stil të thjeshtë, të hollë, dramatik, komik, me rrëfimet e tij plot origjinalitet, ka relaizuar më së miri atë që shpreh “Mjeshtri i Madh” Bujar Kapexhiu: “Mbështilli ditët me fjalët e tyre (të njerëzve - S.M.) të bukura, të mençura, të ngrohta e të sinqerta dhe ruaji fort në kasafortën e shpirtit që një ditë t’ua japësh edhe ti të tjerëve, këtë pasuri që të kanë dhuruar”. Ndërsa në trevën dibrane, ku përshkoi udhët plotë lakore e peripeci të shumta të jetës, ku lotoi nga gëzimi e hidhërimi, ajo dhe vetëm ajo u bë djepi i frymëzimit, i suksesit, i buzëqeshjeve dhe i progresit të tij kultural, moral, profesional e prandaj shkruan: “Dibra qenka një fushë e gjerë magnetike, që sa më shumë ta shohësh, prekësh dhe përmendësh, aq më e dashur bëhet, aq më shumë ngrihet e lartësohet, si një mal i artë.

Firence 05.10. 2012.

Flet regjisori, aktori dhe këngëtari Skënder Cala:

“Për 200 ditë pune në USA, bleva një shtëpi në Tiranë”

Skënder Cala, një emër mjaft i njohur dhe i dashur në botën artistike dibrane, por dhe në atë kombëtare, prej disa vitesh ka botuar një libër të veçantë me titullin sinjifikativ “Magjia e Dibrës”. Në këtë libër, duke qenë në vijën e parë të ngjarjeve, një dëshmitar dhe njëherësh pjesë dhe autor i atyre ngjarjeve artistike që kanë ndodhur në qytetin verilindor të Atdheut, Peshkopisë, përshkruan me vërtetësi dhe shumë dashuri gjithë atë udhë vetjake, drejt artit që përkon njëherësh edhe me vetë udhën e artit dibran, pas viteve ‘50-të. “Magjia e Dibrës” është një tablo e gjerë e gjithë artit skenik, për “estradën, muzikën si dhe teatrit profesionist të Peshkopisë”.



Më hollësisht ai shprehet në intervistën e mëposhtme.

- Zoti Cala, kur keni filluar të këndonit dhe cilat kanë qenë këngët tuaja të para?

Isha i vogël, kur prindërit në raste gëzimesh familjare më vinin të këndoja. Ishte nëna ajo që më kishte formuar repertorin, kryesisht me këngë popullore shkodrane (sepse ajo ishte bijë Shkodre).

Kur ndjek sot spektaklin televiziv “Gjeniu i vogël”, midis atyre fëmijëve imagjinoj vehten, 60 vjet më parë me plot nostalgji, ndonëse skenat në ato kohë ishin vatrat familjare dhe klasat e shkollave.

Si profesionist u bëra prezent në Estradën Profesioniste të Peshkopisë, në maj të 1961. Premiera e saj e parë, “Të fala nga Korabi”, na bëri të njohur në shkallë kombëtare. Kjo shfaqje, që u dha në të gjitha qytetet e mëdha, nga Shkodra në Tiranë e gjer në Sarandë, u ndoq me interes të jashtëzakonshëm nga dhjetëra e mijëra artdashës. Humori, kënga e vallja e Dibrës befasuan në atë kohë publikun shqiptar, i cili na duartrokiste pa pushim. Ndër të tjera, këngët “Ma ke gishtin për unazë”, “Bilbili në kajsi”, “Oj Hatixhe”, na bënë të njohur, mua dhe këngëtares e mirënjohur Melita Shehu. Këto qenë dhe këngët e para të repertorit tim, të kënduara përpara mijëra spektatorëve shqiptarë.

- Duke qenë se filluat me këngën, përse konkurovat për artin dramatik. Nëse ju kujtohet, me cilat pjesë konkurovat dhe cila ishte juria?

Si te çdo i ri, edhe tek unë, ëndrra për t’u shkolluar sundonte qënien time. Shefi im i muzikës, Tonin Rrota, me një kulturë për t’u patur zili, synonte të përgatitesha për të konkuroar në “Konservator”, për kanto. Repertori i zgjedhur nga Tonini iu përgjigj kërkesave të këtij konkursi, të cilin e fitova në verën e vitit 1962. Komisioni përbëhej nga artistët

dhe pedagogët e mirënjohur Mihal Ciko, Lluk Kaçaj, Albert Papparico (Drejtor i Konservatorit), etj.

Shokët e mi të asaj kohe kishin vënë re se se tek unë kishte të dhëna prej aktori. Kjo që arësyeja që po atë ditë konkurova edhe në degën e dramës, në Institutin e Lartë të Arteve, me material të shkrimtarit rus M. Gorki dhe të madhit Fan Noli, dhe fitova. Kështu, midis dy projekteve për t'u përgatitur si artist, zgjodha të bëhem aktor. Por kënga mbeti hobi im, duke e kultivuar në qindra spektakle e koncerte, brenda e jasht Shqipërisë.

- Le të ndalemi më konkretisht te diploma, regjisura dhe emërimi...

Në Akademinë e Arteve në vitin 1967 mbrojta diplomën me dramën ruse “Për ata që janë në det” të Boris Lavreniev, dhe “Halili dhe Hajria” të dramaturgut Kolë Jakova. Pedagogët e mi, Naim Frashëri dhe Pjetër Gjoka (të dy aristë të Popullit), si dhe udhëheqësi artistik Kujtim Spahivogli, një tjetër artist dhe regjisor i madh shqiptar, të bindur për të ardhmen time artistike, më vlerësuan me notën 10-të, dhe insistuan për të më mbajtur në Teatrin Kombëtar. Por autoritetet e Dibrës nuk pranuan kurrësesi dhe dosja ime u tërhoq në Dibër për të më emëruar si aktor. Një vit më vonë, me kërkesën e Ministrisë së Kulturës specializohem për regjisorë në Akademinë e Arteve (sot Universiteti i Arteve). Pas specializimit emrohem regjisor i Pallatit të Kulturës Peshkopi.

- Cila ka qenë vepra e parë që keni vënë në skenë në Peshkopi?

Edhe pse i përket një kohe të largët, më kujtohet se me dramën “Rrënjët” të autorit Kujtim Spahivogli, konkurova dhe zumë vendin e parë në Takimin Kombëtar të Teatrove Amatore, në Durrës. Që nga ajo kohë, dashuria dhe respekti për artistët dibranë u shtua aq shumë saqë çdo premierë e re pritej

me entuziazëm. Ishin këto arësytet që edhe në atë mizerabël ekonomik, edhe Dibra të kishte në vitin 1984 Teatrin Profesionist. Në harkun kohor të 20 viteve (1970-1990) u vunë në skenë afro 100 premiera (komedi e drama), duke angazhuar në to mbi 140 aktorë. E pabesueshme, por janë faktet që flasin. Nga një lëvizje e fuqishme amatore u mundësua krijimi i Teatrit Profesionist në Dibër, me dhjetë aktorët e parë të tij: Luan Hysa, Petrit Turja, Llesh Nikolla, Irma Dani, Feriha Cala, Atli Shehu, Aleksandër Nice, Petrit Kuçi, Arian Toçi, Musa Elezi, të cilët së bashku me piktorët e skenografët Lefko Popa e Zaim Elezi; prapavijën e teknikët Luan Seferi, Medat Vlesha, Arben Zeqja, Mitat Hoxha, Petrit Xhaferri, etj, si dhe drejtorët e institucionit Adil Shehu e më vonë Hamit Lumi, të cilët do të mbeten në altarin e artit dibran si kontribuesit kryesor të mbajtjes gjallë të fuqisë artistike në Dibër. Ishte ky grupim artistik që dhe në takimet kombëtare dallohej, si për nivelin, frymën dhe disiplinën artistike, duke ardhur me flamuj e çmime të para e të dyta, duke nderuar veten dhe Dibrën.

- Cili nga udhëheqësit e asaj kohe ka parë shfaqjet tuaja? Vlerësimet dhe dështimet?

Ishte bërë zakon që trupat artistike të Peshkopisë të jepnin shfaqje sa herë që eksponentë të nomenklaturës së asaj kohe vinin nga Tirana në Dibër për punët e tyre. Shpesh merrnim lëvdata prej tyre për këto shfaqje, por jo rrallë edhe qortime që shpesh rrezikonin dhe karrierën artistike. Një rast ka qenë me ish-kryeministrin Mehmet Shehu, të cilit nuk i pëlqeu qethja dhe veshja ime skenike. Po ashtu dhe një rast me Gafur Çuçin, që anulloi shfaqjen premierë “Ethet e Olimpiadës”. Por, kishte dhe nga ata që kanë parë dhe kanë mbetur të kënaqur nga premierat tona artistike, si Rita Marko, Hysni Kapo, Haxhi Lleshi etj.

- Po në kinematografi, ç’role keni luajtur? Kush nga

artistët ju ka përkrahur dhe ndonjë detaj nga bashkëpunimi me ta?

Kinematografinë e kam pasur ëndërr, jo më pak se teatrin, por mundësinë e kisha të vogël dhe për limitin “kohë”, dhe ato pak role i kam realizuar duke sakrifikuar lejet e zakonshme në pushimet e verës. Por më ngushëllon fakti që regjisorët më besonin role kryesore, si të “Kërcënimi”, “Guximtarët”, “Çeta e vogël” e “Bardhezi”. Është fakt që shokët dhe pedagogët e mi në Tiranë ishin të shqetësuar për fatin tim artistik. Unë e ndieja këtë, aspe ata në çdo kohë përpiqeshin të më ndihmonin edhe pse isha aq larg tyre, pra në Peshkopi 200 kilometra larg Tiranës. Ishin ata që ndiqnin punët dhe mbarëvajtjen time artistike në Peshkopi. Ndjeja gëzimin e tyre, kur dëgjonin mirë për trupën time artistike. Ishin ato që këmbëngulën që unë të specializohesha për regjisorë. Ishin shokët e mi artistë dhe regjisorë, që më ftonin çdo vit për të luajtur në filma, por leja për të xhiruar më mohohej, me pretekstin absurd të “ngarkesës” me punë!

Kujtime të paharruara kam me pedagogët dhe artistët e mëdhenj, Naimin, Pjetrin, Kujtimin, Sulë Pitarkën, Kadri Roshin, Mihallaq Luarasin, Esat Oktrovën, Piro Manin dhe Gëzim Erebarën. Po ashtu dhe nga bashkëpunimi me shokët e mi, Mark Topallaj, Bujar Kapexhiu, Sheri Mita, Ymer Bala, Rifat Poga, Kujtim Shehu, Agim Doçi, Fatos Haxhiraj, Milto Kutali, Ferdinand Radi etj.

- Ku e keni gjetur veten më mirë, në aktrim, si regjisor apo si këngëtar?

Kënga mbeti për mua dashuri e parë dhe kësaj dashurie i këndova, deri kur u ndava unë prej saj dhe jo ajo nga unë.

Si aktor, koha më imponoi të isha regjisor i vetvetes. Jam i bindur se kam qenë hije e vetvetes sepse ndryshe do kisha qenë, sikur potencën time të pashfrytëzuar aktoreskte ta kishte vënë në efikasitet një regjisor tjetër. Dhe ndodhi në një takim

kombëtar të teatrove profesioniste në Tiranë, në fund të viteve ‘80-të, nën regjinë e Fatos Haxhirajt, ku unë isha i ftuar nga Peshkopia. U vlerësua një ndër katër aktorët më të mirë të takimit, krahas Ndriçim Xhepës (Tiranë), Ymer Balës (Shkodër), Vangjel Hebës (Durrës) dhe Albert Verrisë (Vlorë).

Si regjisor, edhe pse fillimet e mia i takojnë trupës amatore të Shtëpisë së Kulturës Peshkopi, kënaqësia ka qenë e madhe sepse dëshira për të bërë teatër me talentet dibrane solli rezultatin fatlum për mua në fushën e regjiturës. Më 5 maj 1984, u bë i mundur krijimi i Teatrit Profesionist të Dibrës, në arkivin e të cilit regjistroheshin dhjetëra premiera drame e komedi.

- Jeni penduar që nuk mbaruat për kanto?

Jo! Jo dhe jo! Sepse edhe kur mbarova studimet në Institutin e Lartë të Arteve për aktor, ata të Dibrës (nënkuptoj institucionet) nuk dinin se në çfarë dege jam diplomuar. Ata e dinin që kam mbaruar për këngëtar. Vonë kuptuan, kur panë sukseset e teatrit amator, se vërtet kisha mbaruar për teatër, dhe emrimi im si regjisor u vonua plot tri vjet. Pas disa vitesh, kam kuptuar se në këtë histori, autoritetet e asaj kohe kishin pjesën e keqdashjes dhe xhelozisë ndaj një artisti me origjinë malësori.

- Nga libri juaj “Magjia e Dibrës” i mirëpritur dhe i vlerësuar nga lexuesi, mësojmë se në vitet ‘90-të jeni marrë edhe me politikë. Si ndodhi kjo?

Te artistët, interesat politike renditen për nga fundi, por ndjeshmëria e tyre ndaj politikës është shumë e madhe. Mjafton të sjellim në memorie fundin e viteve ‘80-të dhe fillimin e viteve ‘90-të. A nuk ishin artistët e kryeqytetit dhe më pas edhe ata të qyteteve tjera që dhanë sinjalin e fuqishëm për përmbysjen e diktaturës së proletariatit?! Ishte momenti që edhe unë si shumë intelektualë e artistë të tjerë, të

distancohesha nga pushteti që kishte kalbëzuar shpirtin dhe jetën e një populli, nga ai pushtet, pangopësia kriminale e të cilit kishte groposur ajkën e inteligjencës shqiptare, si tek “Luciferi në rrethin e 9-të të Dantes”, që ushqej vetëm me koka njerëzish. Prandaj dhe vendosa të jap kontributin tim modest për rrëzimin e diktaturës. Me një grup intelektualësh dibranë, krijuam degën e Partisë Republikane dhe në bashkëpunim të ngushtë me Partinë Demokratike, krijuam të parin pushtet vendor demokratik pluralist, pas 50-të vitesh sistem komunist.

- Pas 40 vitesh u rikthyet në vendlindjen tuaj, Tiranë. Si e përjetuat këtë rikthim?

Bashkë me lirinë, vitet 90-të e më pas ato të pluralizmit politik, sollën lëvizjen e lirë, e cila më mundësoi edhe mua rikthimin familjarisht në Tiranë, nga ku isha larguar që 14 vjeç. U riktheva me gëzim dhe optimizëm në qytetin ku kisha lindur e kisha kaluar fëmijërinë dhe ku u shkollova, në kryeqytetin tonë të dashur, të cilin diktatura e shëndërroi në “mollë të ndaluar” për inteligjencën e provincave (përjashtuar të besuarit e nomenklaturës komuniste ose ata që kishin mikun e fortë). Shumë pak e dijnë se të vije nga Dibra në Tiranë, apo nga qytetet e provincave, nën pretekstin e biletave, policia do të kontrollonte udhëtarët, që hynin në kryeqytet.

Dëshira për të ardhur dhe punuar në Tiranë nuk shoqërohej me gjendjen time ekonomike, sepse në ditën që u rrëzua diktatura, ndonëse kisha punuar 40 vjet, në xhepin tim ndodheshin 40 lekë.

Të vjetrit thonë: “Përpara se të lindë, njeriut i lind fati!”. Siç duket fati më kishte rezervuar një surprizë të këndshme, sepse as në fanatzinë e ëndrrave nuk e kisha menduar se do të shihja Amerikën. Një garanci e ardhur prej andej nga një i afërm më mundësoi vizitën në “tokën e premtuar”. Por siç thuhet “oreksi vjen duke ngrënë”. Edhe unë, kur pashë që një

punëtor i pakualifikuar, pa moshë dhe pa ditur gjuhë të huaj si puna ime, punonte dhe merrte 50 dollarë në ditë, në një kohë, kur rroga ime mujore nuk ishte as 30 dollarë, vendosa të qëndroja në Nju Jork, për të punuar për disa kohë. Punova për 200 ditë në kompaninë “Roufi”, që merrej me mbulimin e çatave me katrama dhe zift, dhe u ktheva në Shqipëri me 10 mijë dollarë. Këto, së bashku me lekët e shtëpisë që shita në Peshkopi, më mundësuan që të blija një apartament modest në Tiranë.

- Dyzet vjet në Dibër! Çfarë kujton dhe cilat janë lidhjet që mban me të?

Dyzet vjet, një fjalë goje, por të përshkruash rrugën që ke bërë, ngjarjet që ke jetuar dhe njerëzit që ke takuar e me të cilët ke punuar, me siguri do të bësheshin 40 libra. Por, unë shkrova një libër, “Magjia e Dibrës”, dhe e kam shkruar mirë. Në faqet e tij pasqyrohet djersa, sakrifica dhe shpirti artistik i rinisë dibrane, që ushqueu shpirtërisht qytetarët e Dibrës në afro katër dekada, pa asnjë interes material. Po, për vendlindjen e babës kam shumë nostalgji. Më merr malli për gurët, drutë e ferrat. Për më tepër që atje kam varret e prindërve dhe të të parëve të mi. Por, mos harro; arti që i kisha dalë për zot me shokët e mi, bëri që t’i bija Dibrës kryq e tërthor, nga Korabi në Martanesh dhe nga Luma në Bulqizë; pëllëmbë për pëllëmbë luginës së Drinit... Ja pse kujtimet edhe sot më mbajnë gjallë dhe më bëjnë të notoju në ëndrra. (Gazeta “Telegraf”, 13 Prill 2013)



Mendimi dhe ligjërimi politik i Skënder Calës

Tek kundron portretin njerëzor dhe intelektual të Skënder Calës, në vigjilje të 80-vjetorit të ditëlindjes së tij, padyshim, një kurorë dritash tok me një admirim të pakufishëm bie përmbi të; një mision dhe një vizion i veçantë i një epoke të tërë përshkon gjithë portretin krijues të një prej ikonave të artit e kulturës sonë kombëtare.

Vështrimi i syve të tij rrezaton një dritë përjetësie, balli i shpalos urtinë dhe mençurinë, e ndërkaq fytyra shpreh fisnikërinë dhe bujarinë, kurse me qëndrimin e tij krenar dhe me krijimtarinë e tij na lë trashëgim një thesar tepër të rrallë e përplot kristale mendimesh. Ai sërish shfaqet dhe rishfaqet edhe në ligjërimin dhe mendimin e tij politik.

Teksa, para dy dekadave, do të përuronte bustin e mendimtarit e filozofit popullor Dine Hoxha, në oborrin e shkollës së Mesme të Bashkuar Muhurr, jo pa qëllim në ligjërimin e tij do të nënvizonte se: *“Shqipëria ka përjetuar në vitet 1944-1990 një prej regjimeve komuniste më totalitare të ish-Bllokut Lindor. Ekzekutimi dhe burgosja e elitës politike dhe kulturore, prania masive e Sigurimit të Shtetit, shpallja e vendit si i vetmi vend de jure ateist, në botë, mundësoi mungesën thuajse absolute të disidencës politike”*. Lidhur ngushtë kjo me emrin e Dine Hoxhës të njohur si “Filozofi popullor në oborrin Mbretëror”, si një nga këshilltarët më të afërt të Mbretit Zog I, S. Cala, si numri dy i pushtetit vendor në rrethin e Dibrës që atëherë do të shpaloste vizionin e tij për masakrën që kreu diktatura komuniste mbi elitën e kombit.

Po këtë vizion do ta shfaqte edhe në Simpoziumin “Dibra etnokulturore”, ku si i pari pushtetar vendor dibran në Dibër të Madhe do të shprehej (e duartrokitej nxehtësisht) para qindra intelektualëve të këtij qyteti me tradita qytetarie se: *“...Ka ardhur momenti që Dibra të mbrojë historinë e saj para kalemxhinjve mediokër, që për dekada të tëra u përpoqën të*

minimizojnë historinë që dibrani e shkroi me gjak". Kjo sipas tij edhe për faktin se "...përcaktimi real i rolit të Dibrës në histori është imperativ e domosdoshmëri e kohës, është një borxh i brezit tonë për të mishëruar në historiografinë shqiptare mendimin filozofik mbarëpopullor se Dibra ka qenë, është dhe do të jetë portë e shqiptarëve!"

Nëse S. Cala ka shkruar e botuar dhjetëra platforma regjisoriale, për drama të autorëve vendas e të huaj që ai ka vënë në skenë si regjisor i tyre, mendimin e tij politik e ka shfaqur me kurajo në dhjetëra artikuj të botuar në shtypin e ditës e atë periodik pluralist të çerekshekullit të fundit. Vetëm një penë e hollë, si ajo e këtij intelektualit erudit mund të shkruajë e argumentojë se "*Pas kolapsit të komunizmit, Shqipëria u gjet në një udhëkryq politik dhe ekonomik, i cili i parapriu një tranzicioni të tejzgjatur dhe sfilitës*". Dhe se: "*30-të vjet pas rënies së murit të Berlinit, duket se nostalgjia nuk është një mit tashmë, por një realitet, që reflektohet në jetën e përditshme. Ajo materializon një lloj melankolie për kohët e shkuara, duke përfshirë këtu edhe një tentativë tinzare për rehabilitimin e figurës së Enver Hoxhës, duke vënë theksin në rolin e tij "udhëheqës" si prijës i luftës për çlirimin nga pushtuesi dhe duke lënë disi në hije veprimtarinë kriminale të periudhës pas luftës*". (Gazeta "Veterani, tetor 2016). Kjo kumtesë e z. Cala analizon mungesën e politikës së kujtesës në Shqipërinë postkomuniste, institucionet e dobëta dhe praktikën tejet të shuar të përpunimit të së shkuarës duke marrë shembull praninë e nostalgjisë komuniste në politikën bashkëkohore shqiptare dhe në zhvillimin e identitetit kombëtar...

Dhe sa më shumë që e kundrojmë portretin intelektual e krijues të S. Calës, nuk ka sesi të mos na ngjallë admirim, mendimi dhe ligjërimi i tij politik, që është në koherencë me realitetin e sotëm të një kaosi institucional, thuajse pa rrugëzgjdhje, i shprehur që para 19-të vitesh, në artikullin, "Sa më shumë varfëri, aq më shumë pushtet mbi popull". (Gazeta

“55”, 27 gusht 2000). Të njëjtën filozofi shpreh dhe argumenton (tani edhe në pozitën e politologut) edhe në artikullin e botuar në “Rilindja Demokratike” me titullin “Demokracia e vrarë shqiptare”, si edhe në dhjetëra artikuj të botuar e ligjërata, që ai ka mbajtur në takime e simpoziume, në Peshkopi, Tiranë e Dibër të Madhe.

Tek Skënder Cala gjithmonë të lë përshtypje energjia krijuese, kthjelltësia e mendimit, thellësia e gjykimit, pesha e fjalës. Në tërësinë e tij, ai mbeti një shpirt i lirë, i cili me jetën dhe me veprën e tij u bë një shembëlltëri prej artisti dhe pse jo edhe prej politikani e publicisti, duke gërmuar nëpër minierat e pafundshme të dijes njerëzore, prej nga nxori veprën e tij krijuese, të stolisur me urtësi, me bukuri, e me mirësi.



Kori i qytetit Peshkopi

37 premierat që ka vënë në skenë dhe ku ka interpretuar Skënder Cala



Nga filmi "Çeta e Vogël"

1 - Flakë Kashte	1969
2 - Drita	1969
3 - Rrënjët	1971
4 - Cuca e Maleve	1971
5 - Ai vdiq në këmbë.....	1972
6 - Një dimër i shkurtër	1972
7 - Ethet e Olimpiadës.....	1973
8 - Çifti i lumtur	1974
9 - Gjëmimi i atij dimri	1974
10 - Përmbytja e Madhe.....	1975
11 - Duke u gdhirë viti 45-së	1975
12 - Përse mendohen këto male	1975
13 - Ah kjo traktoristja.....	1976
14 - Shpartallimi	1976
15 - Doktor i pacient	1979
16 - Shoku Niqifor	1980

17 - Natë pa gjumë	1981
18 - Tokë e ndezur	1981
19 - Kështu të dua	1982
20 - Pas provimit	1982
21 - Suksese në premierë	1983
22 - Përballë vehtes	1984
23 - Moshë e ngarkuar me provime	1984
24 - Qyteti i akuzuar	1985
25 - Pallati 176	1986
26 - Pranvera që s`vonoi	1986
27 - Ankohen personazhet	1987
28 - Nesër është vonë	1989
29 - Përshëndetje minatori	1989
30 - Bidermani dhe Zjarrvënësit	
31 - Maturant.....	
32 - Me fal baba	
33 - Shenomeni dhe mua.....	
34 - Hija Tjetrit	
35 - Rri urtë Kristofor	
36 - Drama satirë - Knep.....	
37 - Marrëzia e Madhështisë.....	


- Në këtë listë nuk renditen mbi 100 premiera të estradës profesionale të regjisorëve Tef Krroqi e Inajet Shehu, nga të cilët 20 premiera janë me regjinë e S. Calës. Jashtë kësaj liste janë edhe mbi 50 premiera të lëvizjes amatore të qytetit dhe fshatit. Shfaqjet plot humor e ngjyra të tyre gjallëronin në ato vite jetën e një qyteti dhe të një rrethi të varfër ekonomikisht, por të madh në shpirtin e tij artistik e njerëzor.



Nga tragjedia "Ai vdiq në këmbë", skena e princave



Ferihaja, në Dramën "Përmbytja e Madhe"



Në filmin "Çeta e vogël"



Nga drama "Cuca e maleve"




Skeç, Feriha Cala, në rolin e "Hanko Selimesë"



Luan Sllova nga Dibra e Madhe, me familje. Peshkopi, 1978



Çifti Cala, para shtëpisë së Kulturës, Peshkopi, 1973



*Te busti i Heroit,
Gjokë Doçi, Lurë*



Trojë, Turqi, 1982



Me motrën e mbetëreshës Geraldinë, në inagurimin e Bulevardit Zogu I, Tiranë 1999



Skeç, F. Cala, I. Shehu, Sh Gjoni



Gëzim Kruja, F. Cala dhe A. Skarra

- IV -

Bashkëkohësit për Skënder Calën



Banda muzikore e qytetit Peshkopi



Haxhi Mata, presigjatori i parë shqiptar, Peshkopi, 1961

Vlerë e miqësisë dhe e çasteve të paharruara të jetës studentore e artistike

Bujar Kapexhiu⁴



Përgjatë këtyre viteve, pa reshtur, kam menduar se një ditë do të ulem të shkruaj disa kujtime nga jeta studentore e më vonë të karierrës sime artistike. Mirëpo, për asnjë çast nuk kam shkruar qoftë edhe një frazë të vetme, megjithëse në pjesën më të madhe të ditës gishtërinjtë e mi shtrëngojnë penën, që lë mbi letër gjurmë vizash e germash...

Dhe ja, fare papritur, mësoj se Skënderi po shkruan një libër mbi jetën e tij. Kjo bëri që t'i braktis për pak vizat dhe linjat e vizatimeve, për të hedhur një radhë mendimesh-kujtimesh për Skënderin. Të sjell ndërmend e të shkruaj nga ato çaste të bukura e të paharruara të jetës studentore e më tej. Të bëj kështu një copë udhë me Skënderin në krah, duke e ditur mirë që në këto rrugëtime të gjata kujtimesh do të ndalemi në skenë, në klasë, në aksion, në zbor, në kafënë dhe së fundi do

⁴ Prof. dr, Mjeshtër i Madh, Nderi i Kombit.

të ulemi të çlodhemi në librarinë e vogël midis labirinthit të pallateve. Sado i shkurtër të jetë ky udhëtim për ne të dy, tashmë si bashkudhëtarë, të sigurt jemi që do jetë i bukur dhe i paharruar...

Në oborrin e madh të Teatrit Popullor, kështu quhej në kohën e diktaturës Teatri Kombëtar, grumbuj studentësh të shkujdesur dhe gazmorë bisedonin, qeshnin me zë të lartë, vraponin e përqafoheshin me njëri-tjetrin, duke deklamuar me potere, gëzimin për fillimin e vitit shkollor. Në fytyrën e të sapoardhurve është fiksuar një buzëqeshje, që për asnjë çast nuk lëviz nga dimensionet fillestare.

Dallohen studentët e viteve të fundit. Flasin me zë të lartë. Fjalët i shoqërojnë me lëvizje të duarve në ajër. E qeshura e tyre duket që është më skenike. Dallohen ndër ta artistë të njohur që lëvizin nga njëri grup te tjetri, duke u përshëndetur me studentët. Ata janë aktorë në teatër, por edhe pedagogë në Shkollën e Lartë për Aktorë. Kjo e fundit dhe Teatri kishin një oborr të përbashkët. Ky qe fati, apo privilegji i madh, se studentët do të gjendeshin gjatë gjithë kohës pranë aktorëve profesionistë, të njohur e me shumë emër në publik. Kjo ide na entuziazmonte, duke ndierë e parashikuar që vitet e shkollës do të jenë vitet më të bukura.

Grupi më i zhurmshëm, më dinamik, ata që bisedojnë me zë të lartë, që përshëndesin krahëhapur, e që në përqafim godasin me pëllëmbët e duarve kurrizin e shoku-shokut, janë studentët kryeqytetas. Dallohen nga veshjet dhe nga modeli i flokëve. Nga ky grup i zhurmshëm shkëputem dhe afrohem te grupi i heshtur.

Përshëndetemi me radhë. Kënaqësi! Shkëmbejmë buzëqeshjet dhe shtrëngimin e duarve. Do të jemi shokë kursi. Te njëri qëndroj më gjatë. Ndjeva një shtrëngim më të fortë dhe dora ime e butë humbi në dorën e tij të ashpër. I dallova buzëqeshjen midis buzëve të trasha, që u tendosën duke zbuluar një rresht dhëmbsh të bardhë e të bukur. Tipare të

theksuara, vetulla të dendura me hark, sybojqielli, ballë i gjerë, ku çlodhej në cullufe flokësh, që merrte harkun mbi ballë dhe vazhdonte përpjetë duke u bashkuar me tufën tjetër të flokëve. Hunda pak me hark...

“Quhem Skënder Cala. Vij nga Peshkopia”. Ç’zë i bukur, i plotë, i pjekur! - mendova. Këta zëra gjithmonë i kam quajtur zë me kokrra, ndryshe nga zëra të tjerë me sipërfaqe të lëmuar.

Vazhdoi prezantimin. “Kam dhënë konkurs për kanto. Kam fituar, por më pëlqen më shumë teatri...”. Kështu, për 4 vjet rresht kam pasur në kurs Skënder Calën. Për të gjithë ne studentët e kursit, Skënderi ishte autoriteti që na impononte respekt. Fjala e tij dëgjohej nga të gjithë. Njëzëri u zgjodh kryetari i klasës, një kryetar i vërtetë, me ne, midis nesh, larg nesh, por gjithmonë për ne. Njëkohësisht shok, mik, student, vëlla i madh, prind... Po, po!, herë pas here, në çaste të vështira, ndiej miqësinë, mbrojtjen dhe ngrohtësinë e tij. Edhe sot kur e kujtoj nuk më çudit fakti. Sjell ndërmend një rast kur ne studentët kishim një problem me disa sjellje e rregulla jo korrekte të trupës pedagogjike. Në rastin e një paraprovimi, ishte ai, Skënderi, që me këmbënguljen e vet në mbledhjet e këshillit pedagogjik anulonte paraprovimin, shtynte datën e provimit, justifikonte mungesat e ndonjë studenti apo shmangte përjashtimin nga shkolla të një studenti tjetër, për ndnjë gjest në kundërshtim me etikën artistike. I merrte përsipër këto detyra, njëkohësisht, duke kontribuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, pa toleruar asnjë abuzim nga studentët. Edhe pedagogët qenë të rezervuar përpara tij. Të kujdesshëm, korrektë e miqësorë. Si me një koleg. Ai qe, pra, përfaqësues i zërit studentor. Midis nesh, studentëve të kursit, për shumë probleme dëgjohehin thëniet: “Skënderi tha...”, “T’i themi Skënderit për këtë...”, “Nuk pranon Skënderi...”, “E zgjidh Skënderi...”, etj. Çdo fraze, i shtohej nga të gjithë, emri i Skënderit. Kjo ndikoi, pak e nga pak, ashtu pa u ndjerë, por u bë si stampë edhe për pedagogët kur do përcaktonin rolet për

dramat që do interpretonim si kurs.

Në rolin e komandantit... Skënderi, në rolin e Pashait... përsëri Skënderi, Gjeneralin... ta luajë Skënderi. Po princin? Sigurisht Skënderi. Drama "Halili dhe Hajria". Halili? Skënderi!

Gjithmonë e shihnin me syrin e një protagonisti, jo vetëm si figurë. Zëri i tij i fuqishëm tingëllonte i pastër e kumbues në sallë. E mbush skenën, thoshin pedagogët. M'u kujtuan fjalët, që më tha ditën e parë të prezantimit: "Kam konkuruar për kanto dhe kam fituar." Por unë çuditesha, përse nuk vazhdoi në konservator për kanto. Pëlqente teatrin. Këtë e besova, kur herë pas here Skënderin e takonte artisti i madh, këngëtari i shquar Luk Kaçaj dhe i kërkonte me ngulmim që të kthehej në konservator e të vazhdonte për kanto. Skënderi nuk pranonte.

Ne na vinte shumë keq, sepse ishim të sigurt që ai do të bëhej një këngëtar i mrekullueshëm i operas. Herë pas here, në kurs, këndonte arie të ndryshme, këngë të njohura si "Binario", "O sole mio", "Granada", etj, me një interpretim të shkëlqyer. Këtë e tregoi më vonë në aktivitetet koncertore si këngëtar në Estradën e Peshkopisë. Pas çdo kënge, duartrokite, biz, përsëritje dhe në fund të festivalit një çmim. Më kujtohet, e nuk do ta harroj për asnjë çast, mbledhjen e fundit me të gjithë studentët e kursit dhe pedagogët. Po mbyllej viti shkollor. Provimet kishin mbaruar. Takimi i fundit. Çaste paksa të tensionuara, për shkak të disa konflikteve. Thashetheme. Intriga. Fjalë fyese. Një komunikim i shurdhët midis pedagogëve. Çuditërisht ata nuk flisnin me njëri-tjetrin. Në kulmin e kësaj gjendjeje të nderur, Skënderi foli ashpër, saktë e lakonik, me zërin e plotë, që i dridhej nga emocioni dhe që tingëllonte edhe më fort në sfondin e heshtur të sallës. Ai zë i tij godiste padrejtësinë, arrogancën, hatërat, servilizmin dhe paaftësinë. Fjalët e fundit, si një nënvizim i tërë asaj ligjërate me nuanca dramatike, po më dukeshin si monologu i një drame midis studentëve dhe pedagogëve. Fraza e fundit: "Zbrita nga

mali i pastër kristal dhe po kthehem atje si uji pis i Lanës”. Heshtje. Një heshtje aq të gjatë s’e kisha ndjerë kurrë. Edhe sot, kur e kujtoj atë frazë, më duket sikur ende vazhdon ajo heshtje...

Zëri i tij i rrallë, i ngrohtë, shpërthyes në çdo cep të skenës dhe tingëllues në çdo qoshe të sallës. Edhe sot, kur e takoj në librarinë e vogël, aty mbas banakut, ai përherë është me një libër në dorë. Mikëpritja e tij shoqërohet nga zëri, që më mbush plot kënaqësi dhe në çast më duket sikur tingëllojnë nga skena qindra fjalë të bukura, të sakta, të ngrohta. Dikur, në klasë, bënim shaka duke thënë se zëri i pjekur, i trashë, tingëllues, thotë gjithmonë të vërtetën.

Të gjithë e besonin. Çmonim tek ai karakterin e fortë, singeritetin, fjalën e dhënë. Tek ai të gjithë studentët nuk shikonin vetëm shokun e klasës. Më shumë, mbrojtësin e tyre. Vajzat e klasës qenë motrat e tij. Ato ndienin mbrojtjen tek ai, nga çdo fjalë fyese, nga ndonjë sulm vulgar, apo nga një shikim grabitqar.

Dhe ne, studentët liberalë e të shkujdesur, qejflinj e “modernë”, rezervoheshim, kur përpara kishim Skënderin. “Mos!” Ai nuk ta bën të gjatë, sepse nuk i duron sjelljet e pispillosura të ndonjë “artisti” kryeqytetas. Herë pas here ai na dukej edhe si prind.

Po, po!, tamam prind. Po ju tregoj një rast: Dy studentë të vitit të fundit, dashnorë pasionantë, kohët e fundit i kishin shtuar ecejaket në klasën ku bënte mësim kursi ynë. Qarkullonin fjalë që ata të dy, pasi kishin interpretuar monologun e dashurisë, kishin filluar dialogun dhe mizanskenën me dy vajza të kursit tonë. Takoheshin në mjedise të ndryshme jashtë shkollës. Kjo shoqëri e tepruar dhe e dyshimtë e detyroi Skënderin të mbante qëndrimin e tij si mbrojtës i dinjitetit dhe nderit të kursit, që po nëpërkëmbej nga studentë me moral të dyshimtë. Vendosi të bisedojë me ta. Pasi merr informacionin e plotë e të sigurt prej tyre, duke mënjanuar

kështu thashethemet, i jep fund bisedës duke i paralajmëruar se, për çdo sjellje në kundërshtim me moralin, në fund do të përballeshin me të. Nga të dy, ai mori premtimin se kjo lidhje është e sinqertë, serioze. Pas këshillave, në fund të bisedës, në çastin e ndarjes me të dy dashnorët, nuk munguan dhe nuancat e një paralajmërimi përzier me copëza kërcënimi. Që nga ajo ditë të dy studentëve të dashuruar u buzëqeshnin të gjithë studentët e kursit tonë dhe përveç kësaj ata kishin një privilegj që nuk e kishin studentët e tjerë të viteve më të larta. Kur kursi ynë bënte provat artistike në skenë, të drejtën për të qëndruar në sallë si spektatorë e kishin vetëm ata të dy. Tashmë, ata ishin pjesë e pandarë e kursit tonë, dhe kjo, me lejen e Skënderit. Sot e kësaj dite ata janë artistë me shumë emër, familjarë të mirë e të lumtur dhe dy shoqet e kursit kujtojnë me nostalgji Skënderin, që në krahun e tyre mbrojti dashurinë e vërtetë, të pastër dhe të qëndrueshme.

Mund të shkruaj shumë faqe për Skënderin. Ndoshta më tepër se çdo mik apo i afërm i tij, sepse ka lënë shumë mbresa në jetën time studentore, si i rrallë e i veçantë në grumbullin e sa e sa studentëve.

Duke e çmuar për vlerat si njeri e artist, që ka zënë një vend të sigurt në krye të listës së miqve të mi më të mirë. Si njeri me karakter të fortë, të paepur, që nuk lëviz për asnjë çast nga kreu i listës. E them këtë se në jetë shumë shokë, të njohur, familjarë e farefis, në pistën e vrapimit miqësor, në pistën e jetës e të miqësisë, herë të afrohen e herë të largohen. Ka nga ata që largohen edhe nga pista, e braktisin vrapin miqësor, humbasin e harrohen gjatë rrugës, ashtu siç ka edhe ndonjë që të afrohet e do të të vërë stërkëmbëshin për të të rrëzuar. Skënderi ka vrapuar gjithmonë në krah, pranë meje, në këtë vrapim të përbashkët në të njëjtën korsi, në pistën pa fund të stadiumit të artit. Skënderi, sot, ashtu si shumë të tjerë, është larguar nga pista. E ka ndalur vrapin e lodhshëm dhe, ndryshe nga të tjerët, ai nuk është larguar nga stadiumi, por ka zënë

vend në tribunë dhe duartroket e brohoret me dashamirësi për shokët e tij, që e vazhdojnë këtë vrapim të lodhur. Duartroket për ecjen time, që tashmë s'mund ta quash vrapim dhe në çdo hap unë ndiej gëzimin e tij, kënaqësinë, inkurajimin, buçitjen e zërit, që më jep kurajë ta vazhdoj ecjen. Më shtyn zëri i tij i ngrohtë, zemra e tij e madhe dhe dëshira e tij e pamatë edhe për të tjera suksese. Dhe mua tani, në këta hapa të garës, më vjen keq e trishtohem. Ndiej një dhimbje thellë në shpirt duke i pëshpëritur vetes: “Përse vallë ka kaq pak njerëz të tillë, të mirë, të dashur, të respektuar? Ah, sikur të kishte më shumë!”

Dhe në vazhdim qetësohem po vetë: “S’ka gjë, edhe pse pak, qëndro përherë pranë tyre dhe shijo kënaqësinë e i vijimësisë.”

Mbështilli ditët me fjalët e tyre të bukura, të mençura, të ngrohta e të sinqerta dhe ruaji fort në kasafortën e shpirtit, që një ditë t’ua japësh edhe ti të tjerëve këtë pasuri që ta kanë dhuruar.

Faleminderit, Skënder!

Të çmoj, si një vlerë të miqësisë, të çasteve më të bukura dhe të paharruara të jetës sime studentore e artistike. Sa më gjatë, jeta jote, miqësia jonë. Mirupafshim!

Një meteor që ndriçoi Dibrën për 30 vjet

Zenel Hoxha⁵



Kur nipi ynë Halil Rama, autori i kësaj monografie, më ftoj për të kontribuar me dy fjalë se si e njoh unë artistin, “Mjeshterin e Madh”, Skënder Calën, përnjëherësh kujtesa më dërgoi në vitet e mia të fëmijërisë, veçanërisht ato të shkollës tetë-vjeçare, në Zall-Dardhë.

Ardhja e trupës së Estradës Peshkopi, në shkollën tonë, ishte një ngjarje e jashtëzakonshme për gjithë zonën, por për mua në veçanti, sepse e përjetoja me gëzim shumë të madh.

Si fëmijë shumë kureshtar me ëndrra e pasione të mëdha për të ardhmen, ndiqja me kujdes, jo vetëm programin artistik, por edhe çdo lëvizje, gjest, të artistëve në skenë.

Nga të gjithë artistët, unë ende ruaj të freskët në memorien time, portretin dhe zërin magjepsës të një artisti krejt ndryshe

⁵ Kryetar i Dhomës Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Britani e Madhe, Konsull i Nderit i Afrikës së Jugut.

nga ç'kisha parë e dëgjuar. Ishte viti 1968. Përnjëherësh m'u kujtuan fjalët e nënës sime të paharruar: "Ai nuk qenka më vete or bir!", pra nuk është si të gjithë të tjerët, është i ardhur enkas nga gjithësia. Ai për atë kohë ishte për ne një rreze drite e bashkëshoqëruar me zërin e tij kumbues, për të qetësuar shpirtrat e drobitur të një populli në vuajtje.

Skender Cala, i tillë vazhdon të jetë në memorien, në qënien time, pra shumë special, në çdo moment, që komunikoj apo kujtoj.

Jam i gëzuar nga fakti se ai lindi në të njëjtin truall nga dolën burra me emër të cilët kontribuan në të gjitha fushat e jetës, jo vetëm në krahinën e Dibrës, por jehona dhe veprat e tyre patën dhe kanë efekte kombëtare. Kujtoj: Elez Isufi, Suf Xhelili, Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, etj.

Do të dëshiroja të vazhdoja me përshkrimin tim rreth Skënder Calës, pasi veprat e tij janë të gdhendura gjatë aktiviteteve të tij artistike, si në Teatrin Kombëtar, Kinostudion "Shqipëria e Re", Estradën dhe Teatrin e Peshkopisë, në jetën e tij si qytetar dhe familjar model, por kësaj radhe do të mjaftohem me kaq duke u lënë hapësirë miqve dhe dashamirësve të tjerë të tij të shprehen gjithashtu.

Në këtë përvjetor special të Skënderit, unë dëshiroj t'i uroj jetë të gjatë e të gëzuar së bashku me zonjën e tij të nderuar, të afërmit, miqtë e tij të shumtë. Skënderi është shembulli ynë më i mirë si atdhetar dinjitoz, i cili vazhdon të kontribuoj çdo ditë me mesazhet e tij, për të pasur një Shqipëri demokratike të zhvilluar, dinjitoze, krahas vendeve të tjera të kontinentit European.

Me shumë respekt e mirënjohje,

Zenel Hoxha

Tiranë, me 24.7.2019

Nderimi për “Mjeshterin e Madh”

Neshat Ndreu



Dita e dekorimit të artistit shumëplanësh Skënder Cala me titullin “Mjeshtër i Madh”, nga Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, ka qenë nga ditët më të shënuara të jetës sime. Isha i ftuar nga kreu i shtetit për të nderuar regjisorin, aktorin dhe këngëtarin e mirënjohur, që na ka bërë të ndjehemi krenar. Me rolet e interpretuara në filma e teatro dhe me këngët e kënduara, jo vetëm në skenat shqiptare, por edhe në Turqi, Maqedoni e Kosovë, Skënder Cala është bërë i njohur dhe i dashur për artdashësit në hapësirën mbarëshqiptare.

Skënder Cala është dhe ka për të qenë një artist i dashur për shqiptarët. Jo vetëm në saj të roleve, që ka interpretuar e të këngëve që këndoi, por për magjinë që ai krijoi në mesin e admiruesve të tij, brenda e jashtë Shqipërisë.

Ai është një artist shumëdimensional, që ka pasur dhe vazhdon të ketë admirues të shumtë në Dibër, në Tiranë, në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare në botë.

Ndaj dhe e meriton plotësisht titullin “Mjeshtër i Madh”, që i ka akorduar Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Urime të përzemërta, “Mjeshtrit të Madh” Skënder Cala, krenaria e Zall-Dardhës, Dibrës dhe e gjithë Shqipërisë.

Skënder Cala hyri në jetën time si njeri e artist

Dervish Biba



I dashur Skënder!

Po e nis këtë letër me dedikimin tim, “I dashur”, sepse i tillë ke qenë për mua që kur të kam njohur. Ty, mbase nuk të kujtohet vjeshta dhe pranvera e vitit shkollor 1953-1954. Ti ishe në klasën e shtatë e unë në të pestën. Të dy ne ishim konviktorë në Shupenzë. Ishe një djalë, që vije nga Tirana. Të njoha dhe të admirova si futbollist. Nuk e di se ku e gjete atë top që na e përzgjodhe dhe na e solle në atë fushë të stisur të Shupenzës. Me shembullin tënd, na mësove sesi të luanim. Natyrisht, ne të gjithë të tjerët ishim djem nga fshati dhe ishte mbase e para herë që godisnim një top të vërtetë futbollit. Më vonë, unë u bëra futbollist me të rinjtë e “Korabit” të Peshkopisë, por zanafillën e parë nuk e harrova kurrë... kurrë...

Kur ndiqja shkollën pedagogjike dhe më pas, kur u bëra mësues në shkollat e fshatrave të Dibrës, të pashë përsëri. Kësaj rradhe, si një profesionist, në një fushë tjetër, në atë të muzikës, si këngëtar. Me zërin tënd brilant dhe me këngët tuaja të bukura popullore, pa hezituat mund të them se ti në ato vite,

nuk ishe, vetëm për mua, njeri i admiruar.

Ty të donin, jo vetëm dibranët, por edhe shkodranët dhe tiranasit e vlonjatët. Ishe ti dhe bashkohësja jote, Melita Shehu, që së bashku me poetin e këngëtarin Hazis Ndreu e muzikantin Tonin Rrota, në fillim të viteve 60-të e bëtë Estradën e Peshkopisë, nga më të njohurat në të gjithë Shqipërinë.

Më pas, të kam takuar në mjediset e Shtëpisë së Kulturës “Haki Stërmilli” të Peshkopisë. Sapo kishe mbaruar vitin e dytë të Institutit “Aleksandër Moisiu”, për aktor. T’u luta që të më orientoje për t’u përgatitur, sepse edhe mua më kishte lindur dëshira që të bëhesha aktor.

I dashur miku im!

Eshtë tamam koha që të falenderoj edhe një herë edhe pse kanë kaluar kohë. Që nga viti 1964, janë plot 55 vjet. Ti më ndihmove e më frymëzove që të mos tërhiqesha nga ëndrra e bukur për t’u bërë artist. Në ato kohë ne u bëmë bashkëstudentë në shkollën e aktorëve dhe ashtu si dikur, unë dy vjet pas teje. Ti u diplomove, jo vetëm si aktor, por edhe si regjisor. Kishe si udhëheqës kursi të paharruarin e të madhin, Kujtim Spahivoglin. Kur mbarova unë, sërish të ndoqa pas. Kësaj rradhe, në trupën e aktorëve që sapo kishe filluar të ngrije në Peshkopi.

Në janarin e vitit 1970, kur u ritakua, nisëm ëndrrën tonë të skenës. Unë aktor e ti regjisor. Kështu pra, i dashuri im Skënder, ti ishe regjisori im i parë. Jo pak, por në katër drama, rolet e të cilave më janë rrënjësuar thellë në kujtesën time. Në ato krijimet e mia të para, ti ma bëje shumë të lehtë e të qartë profesionin e vështirë e të bukur të aktorit.

Me sa më kujtohet, e filluam me dramën e Sheri Mitës “Një dimër i shkurtër”. Mbaj mend edhe një “zënkë” të vogël që e patëm së bashku, kur po bënim provat e kësaj drame. Isha me sa duket i pakënaqur me ty, sepse ti gjoja punoje pak me mua.

Ti më the, se aktori profesionist duhet ta zgjidhë vetë rolin. Më vonë e kam kuptuar domethënien e kësaj fjale. Unë duhet

të sillja e jo të prisja nga regjisori gjithçka. Ishte mësimi i parë, që merrja nga regjisori im i parë.

Më pas erdhën premierat e tjera, “Cuca e maleve”, ku unë isha në rolin e Palit. Kujtoj, se u shfaq shumë herë, ndoshta 15-20 herë, edhe pse qyteti ynë ishte i vogël. Mbaj mend që filluan të vinin edhe gra e vajza në teatër, që ishte fort e rrallë për atë qytet.

Mendoj se drama e Kujtim Spahivoglit “Rrënjët”, që vure pak më vonë në skenë të ngjiti lart, shumë lart. Me atë u konkurua në Durrës, përballë 26 trupave të Shqipërisë dhe u vlerësua me vendin e parë. I kam në kujtesë, duartrokitjet e spektatorëve durrësakë, në natën e shfaqjes. Kujtoj vlerësimet e bëra nga shume kolegë e kolege, që na mikluan. Jo më pak na gëzuan edhe fjalët e kritikës, në gazetata e revistat e kohës. Në atë natë unë mora shpërblimin e parë të jetës sime, një medalje, si aktori më i mirë në realizimin e rolit të fashistit, që u vlerësua, mes vlerësimeve të tjera që erdhën më vonë në jetë.

Padyshim, ta di për nder ty, i dashuri Skënder. Vepra e fundit ku ti ishe regjisor, për mua ishte drama kushtuar Skënderbeut, shkruar nga Kujtim Spahivogli. Ti e vure këtë në prag 60-vjetorit të Pavarsisë, në nëntor të vitit 1972.

Unë interpretoja rolin e Lekë Dukagjinit. Të lutem, mos ma censuro këtë, që do të të shkruaj më poshtë. Është vepra më e veshtirë që ti ke vënë në skenë. Në atë tragjedi lëviznin shumë personazhe, ndoshta mbi 35-së vetë. Kishte jo pak, por 13-të tablo që viheshin në skenën, relativisht të vogël të Teatrit Profesionist. Mungonin mjediset anësore. Ndriçimi ishte i pakët. Ishte puna jote dhe e scenografit Lefko Popa, që për çudi i zgjidhi të gjitha situatat, duke sjellë në sallë frymën e një epike të madhe, atë të Skënderbeut.

Kujtimet e kësaj shfaqjeje janë të pashlyeshme. Nuk po flas se si u prit kjo pjesë madhore. Kushdo që do ta njohë këtë jehonë, le të lexojë shtypin e kohës.

Do të flas pak për veten:

Më kishe caktuar rolin e Lekës. Ishte një rol shumë i vështirë dhe mua më duhet që të të falenderoj dhe të ndaj me ty krenarinë time e të them: “Faleminderit!”

Erdhi më pas viti 1973, kur unë u emërova në teatrin “Bylis” të Fierit. Aty ndihesha jo si aktor i rolit të parë, por si aktor që kisha luajtur Lekë Dukagjinin. Unë kisha tani 4 role, ndërsa teatri i Fierit kishte vënë vetëm dy premiera.

Kisha punuar e krijuar me regjisorin pasionant Skënder Calën, me atë pasion, që ishte futur tashmë edhe tek unë me forcë.

Kështu vit pas viti kishe bërë vend në jetën time, në të ardhmen time si njeri e si artist.

Këto mendime unë i kam pasqyruar në një dokumentar që u shfaq në teatrin “Bylis” me rastin e 60-vjetorit tim. Më shumë respekt e nderim të kam falenderuar. Sot dua ta përsëris këtë respekt, tashmë për këtë punë të bukur që po bën me librin tënd. Eshtë një mirënjohje që kthehet në një mirënjohje të atyre që do ta lexojnë atë.

Edhe një herë të uroj shëndet bashkë me Ferihanë dhe të gjithë njerëzit e tu të dashur.

Tiranë, nëntor 2009

Skënderi, siç e njoh...

Inajet Shehu⁶



Ishte... 24 gushti i vitit 1968... Pa dale, ishte vërtet kjo datë?... Po, po! Tamam 24 gusht ka qenë. Nuk ka si harrohet një nga ditët më të shënuara të jetës, siç është martesa. Ky emërtim erdhi ngaqë në këtë festë, shalqini e lëvozhgat e tij mbulonin çdo rrugë e rrugicë të qytetit. Pikërisht në këtë datë unë, dhëndëri 25-vjeçar, kostumosur e kollarisur, për të parën herë në jetën time të deriatëhershme, po zbrisja “maloren” që më shpinte në shtëpi, në sheshin “Bajram Curri”.

Ndërkohë më ra në sy se po ngjitej me vështirësi një “Fiat” a diçka e tillë. Mendova se ishte “Fiati” i sekretarit të parë, i vetmi në qytet ato vite, por sakaq më ra në sy targa “SH”, që do të thosh se ishte një veturë nga Shkodra. Përqëndrova shikimin brenda saj dhe në sediljen e pasme, zbardhoi diçka dhe pastaj dallova se ishte një nuse. Kur “Fiati” më rrëshqiti para syve, një dorë u zgjat nga dritarja e më përshëndeti dhe mezi njoha Skënderin, Skënder Calen, kolegun tim. Ditë më

⁶ Aktor dhe regjisor i Estradës së Peshkopisë.

vonë, Skënderi më thoshte, se i kishte pëshpëritur në vesh nuses së tij shkodrane: “Feri, e pe atë djalin me kostum që po zbriste? Jemi kolegë. Edhe ai martohet sot”.

E ku mund ta merrja me mend unë, sigurisht edhe Skënderi, se vetëm pas një kohe të shkurtër, do të ishim jo vetëm me Skënderin kolegë, por edhe me Ferihanë, të cilën do ta kisha partneren kryesore në skenë, për vite e vite me radhë.

E ç’të them për Skënderin? Në raste të tilla, të bien në mend aq e aq ngjarje, sa nuk di cilën të kujtosh. Të kujtosh ato pak vite të Skënderit këngëtar, që me zërin e tij të veçantë e ngriti këngën dibrane në nivele të reja?

Si mund të harrohen këngët e potpuritë dhe duetet e Skënderit me Melita Shehun, të punuara mjeshtërisht nga i ndjeri Tonin Rrota, tek ngrinin peshë spektatorët në çdo cep të Shqipërisë, Tetovës, Prishtinës e më gjërë!? Ishin këto vitet e shkëlqimit të këngës popullore qytetare dibrane, ku një meritë e veçantë i takonte padyshim Skënderit tonë. Pastaj, me gjithë kundërshtimin e kolegëve e shokëve, Skënderi ulet në auditorët e akademisë së Arteve, në degën aktrim. Ndër studentët e parë, student i të madhit Spahivogli, përfundoi studimet. Mendohej të emërohej në Tiranë, por autoritet e rrethit “atë talent e deshin për nevojat e Dibrës”. Skënderi nuk dekurajohet. Gjithë pasion e energji fillon punën si regjisor në shtëpinë e kulturës. Atë që e duartrokisnin para pak vitesh si këngëtar, tashmë filluan të duartrokisnin dramën dhe komeditë e vëna në skenë nga regjisor i Skënderi Cala.

Cili qytetar i atyre viteve nuk kujton dramën “Rrënjët”, me autor idhullin e tij K. Spahivoglin, apo komedinë “Pallati 176”, të cilat për nga niveli artistik nuk dalloheshin nga trupat profesioniste.

Me disa prej tyre, trupa teatrale amatore fitoi disa çmime në Olimpiada Kombëtare. Mbi këtë shtrat suksesesh, pak vite më vonë, në Peshkopi do të ngrihej Teatri Profesionist. Një institucion që nuk ishte dhuratë nga qielli, por fryt i punës,

talentit dhe këmbënguljes të regjisorit Skënder Cala.

Vite më vonë, për një periudhë, Skënderi drejtoi si regjisor trupën e Estradës Profesioniste, pjesë e së cilës isha dhe unë. Pasardhës i të ndjerit Tefë Krroqi, që i dha aq emër në vite trupës së estradës, Skënderi e mori edhe këtë detyrë gjithë pasion. I afërt me aktorët, këmbëngulës në idetë e tij, i ashpër e kritik ndaj mendimeve anakronike të nëpunësve e drejtuesve mediokër të kohës, Skënderi arriti që të shpinte edhe më tej punën e regjisorit veteran Tefë Krroqi.

Nuk na hiqet nga mendja një rast, që tregon preokupimin dhe këmbënguljen e Skënderit. Një ditë (le ta quajmë ditë, paçka se sapo kishte filluar të zbardhë) troket dera e oborrit të shtëpisë sime. Unë dhe ime shoqe vështroam njëri-tjetrin sypërgjumur, por dhe të alarmuar. Kur trokitja u përsërit, brofa nga shtrati, hodha diçka krahëve dhe zbrita i alarmuar shkallët. I heq shulin derës dhe përballem me Skënderin. E vështrova i tromaksur, kurse ai qetë-qetë më kërkoi ndjesë për orën e papërshtatëshme dhe tha shkurt: “Ka orë që më mundon një ide”. Mbylla portën dhe u futëm në kuzhinë. U ulëm, vura në furnelën e vajgurit çajnikun dhe Skënderi filloi të më shpjegojë idenë e një teme për skeç a parodi, i cila nuk e kishte lënë të vinte gjumë në sy. Filloi të trajtojë idenë e tij gjithë emocion. Çajniku filloi të ziente... Filluam të pinim çajin. Skënderi fol, unë shkruaj, ai fol, unë shkruaj.

Dhe kur materiali letrar, (një skeç i muzikuar, me sa me kujtohet) mori formën e plotë, vetëm atëherë pamë orën që kishte kaluar tetë. Por kishin kaluar katër orë pa i ndjerë. Dhe ai material do të rezultonte ndër më të suksesshmit e premierës që u shfaq dy-tri javë më pas.

E ç'të shkruash më parë për Skënderin? Për talentin? Për këmbënguljen? Për sinqeritetin? Për talentet e rinj që ngjiste në çdo premierë? Apo për artistin, që nuk pajtohej kurrësesi me konformizmin dhe servilizmin, dukuritë më evidente të atyre viteve. Ishte Skënderi ai që u jepte nerv e impuls mbledhjeve të

dikurshme të kolektivit, që përplasej edhe me të deleguarit kryesor të rrethit, për çështje jo vetëm të artit, por edhe parimore. Guximi i tij na habiste e na tulate të gjithëve. Ku e merrte guximin ky njeri të përplasej në ato vite me njerëzit më të pushtetshëm të rrethit?

Këtë pyetje ia bëja shpesh vetes. Dhe vetëm vonë, shumë vonë, arrita t'i jap përgjigje. Talenti, argumentimi dhe mospajtimi me mediokritetin ishin "armët" kryesore me të cilat ai mposhtëte eprorët e gjithëpushtetshëm, të cilët nuk i bënin dot ballë dhe shpesh u shmangeshin debateve e përplasjeve me të.

Kështu e njoh artistin, drejtuesin artistik, kolegun dhe njeriun e mirë, Skënder Cala.

Na ka çue Shkodra një fjalë...

Zef Çoba, *Shkodër*



Kanë kaluar 30-të vjet, që kur jam larguar nga qyteti i Peshkopisë e prap kam lidhje të ngushta shpirtërore me këtë qytet, me banorët e tij, me shokët e mi, ashtu si gjatë viteve që qëndrova atje. Kam qënë 22 vjeç kur nisa punë atje për herë të parë, por e them me plotë gojën, se Peshkopia u bë një qytet i dytë kaq i dashur për mua.

Vitet e qëndrimit në Peshkopi përbëjnë një kohë shumë të përkushtuar e me aktivitete të ngjeshura e intensive, në punën drejtuese organizative, studimore e krijuese, në punën që bëhej për talentet e reja. Njohja me këtë trevë, asimilimi i traditave të saj, studimi dhe kontaktet e shumta me njerëzit, kanë lënë kujtime, përshtypje dhe gjurmë të thella në ndërgjegjjen time. Rrethi i njerëzve m'u bë si një familje e shtrejtë dhe e dashur e jetës. Më rastis që shpesh të them se ne, njerëzit e artit, kemi një familje tjetër veç asaj biologjike që e kanë të gjithë. Në këtë familje të dytë ne ndajmë qëllimet, shqetësimet, realizimet e interesat e punës sonë artistike. Në jetën time, kjo familje ka pasur dhe vazhdon të ketë një vend të pazëvendësueshëm.

Ndërmjet artistëve me të cilët bashkova vullnetin në qytetin e Peshkopisë ishte edhe regjisori, aktori dhe këngëtari i

mirënjohur, Skënder Cala.

E kisha njohur e dëgjuar këtë emër në interpretimet e këngëve dibrane si në Radio Shkodra ashtu edhe në Radio Tirana. Herë si solist, herë në duet, herë në kuartet apo edhe në suitat e përpunuara me finesë nga muzikanti i talentuar Tonin Rrota. Më kishte lënë një ndjenjë të këndshme zëri i tij bariton.

Në Shtëpinë e Kulturës “Haki Stërmilli”, ku mora emërimin si përgjegjës muzike, bashkëpunova me të gjithë drejtuesit e këtij institucioni e në mënyrë të veçantë me Skënderin, sepse ai mbulonte detyrën e regjisorit.

Një arsye tjetër që më lidhi me të, ishte edhe bota e vlerave artistike që kishte ky artist. Veç detyrës së regjisorit, që ai kishte, merrte pjesë në të gjitha premierat e shfaqjet e rëndësishme që bëheshin në Shtëpinë e Kulturës, apo pranë Estradës Profesioniste si këngëtar. Skënder Cala, përherë me suksese, si një këngëtar. Publiku e donte shumë, e duartrokiste. Kur dilte për të kënduar, duhet të mendonte dhe për një këngë të dytë, sepse publiku këtë zakonisht ia kërkonte. Këtë moment të dëshiruar për secilin artist, ai e arrinte, sepse tregonte kujdes që me zgjedhjen e repertorit. Shpesh vinte në studion time dhe më kërkonte të punonim ushtrime vokale, gjë të cilën e kishte bërë edhe më parë.

Pastaj, punonim këngët e repertorit. Interpretimi i tij ishte i pasur me të gjithë shprehitë e komunikimit skenik. Me një intensitet emocional, përcillte me force te spektatori, përjetimin artistik që arrinte të realizonte. Skënderi këndonte me zemër.

Kjo bëri që në Kantatën, “Nënë Shqipëri”, që fillova të kompozoj, për ta vënë në skenë me artistët e talentuar të qytetit, në vitin 1976, mendova që ta shkruaj partin solist për bariton, duke ia besuar atë Skënderit. Suksesi ishte i paimagjinueshëm...

Pasionant dhe i përkushtuar siç ishte, ai futej me një entuziazëm, në aventura artistike jo të lehta... Mbështeste çdo ide e nismë që pasuronte traditën e sillte risi të reja.

Kjo ndodhi kur fillova të punoj me korin e Ansambllit “Dibra” që u ngrit në Shtëpinë e Kulturës. Në këtë punë madhore, pata nxitjen e të gjithëve, në mënyrë të veçantë të Skënderit. Në vitin 1977 mora një ftesë nga Festivali i Këngës në Shkodër. Kompozova një këngë me një përmbajtje krejt të veçantë në bashkëpunim me artistin e mirënjohur Hazis Ndreu dhe me këngëtarin Skënder Cala. Kënga u titullua “Na ka çue Shkodra një fjalë”, që trajtonte lidhjet historike të Dibrës me Shkodrën. Kjo këngë mori çmimin e parë, që u dorëzua nga kompozitori i mirënjohur Pjetër Gaci.

Një vit më vonë, Skënderi u emërua si regjisor i Estradës Profesioniste. Në shumë premiera të saj, ai më besoi drejtimin muzikor, një detyrë që zyrtarisht nuk e mbuloja unë.

Deri tani nuk kam takuar ndonjë jabanxhi, që ka punuar në qytetin e Peshkopisë, që nuk flet me respekt për mikëpritjen dibrane. Do më pëlqente të thosha, se hyj në të paktët që e njoha, e provova dhe e jetova atë, por nuk është kështu. Çdo jabanxhi, në çdo cep të Peshkopisë, duke përfshirë edhe fshatrat, e ka ndjerë atë dhe e ka parë me sytë e tij.

Në planin shoqëror, respekti për bashkëshortët Skënder e Feriha Cala do të mbetet i paharruar. Dera e shtëpisë së tij bujare ka qënë hapur. Në të kam gjetur ngrohtësinë e mikpritjen. Janë të panumërta rastet kur me shokun e mikun shumë të ngushtë Lefko Popën kemi provuar shijen e këndëshme të tryezës së përgatitur pa përtesë nga Feri, siç e thërrisnin shoqen e jetës së Skënderit.

Kur isha në Peshkopi, sa herë që takoja ndonjë shkodran të njohur apo të panjohur, më dukej sikur kisha takuar një njeri të afërt dhe e ftoja. Kisha dëshirë të ulesha në një tavolinë me të. E njëjta gjë ndodh edhe tani, që jam larguar nga Peshkopia, sa herë takoj ndonjë dibran. Kam dëshirë, që të flas me të, ta ftoj.

Ndërsa, kur takoj shokët apo pjesëtarët e “familjes sime artistike”, orët që kalojmë së bashku janë të dashura, të shtrenjta e të paharruara. Kjo më ndodh, sa herë takoj S. Calën.

Kur dëgjoj këtë zë kaq të fuqishëm, më duket vetja
sikur nuk jam në qytetin e vogël të Peshkopisë

Hamit Lumi⁷



Ndodh mjaft herë që kur të kërkohen vlerësime, opinione, përshtypje e mbresa nga individë të veçantë ndjehesh në vështirësi, kur puna e tyre ka kaluar pa lënë gjurmë. Ndryshe ndodh për artistin Skënder Cala, puna e të cilit për rreth 35 vjet ka patur kulmet e veta në shtëpinë e kulturës “Haki Stërmilli” Peshkopi dhe trupat profesioniste të Estradës dhe Teatrit.

Duke punuar me të për më shumë se 20 vjet, e pohoj me saktësi e bindje se Skënderi është një artist i kompletuar në fushën e këngës, të aktrimit dhe regjisorës.

Në vitet 60-të, në atë kohë mësues në Zalldardhë, binte në sy talenti i fuqishëm i tij në interpretimin e këngës popullore të kultivuar. E ky zë bariton i mrekullueshëm nuk mund të kalonte pa u vënë re nga drejtuesi i muzikës së shtëpisë së

⁷ Ish-drejtor i shtëpisë së kulturës “Haki Stërmilli” dhe i trupave profesioniste të Estradës dhe Teatrit

kulturës, Tonin Rrota. Fillon punën si profesionist në Estradën e Peshkopisë dhe shumë shpejt bëri emër si interpretues i këngëve popullore dhe të kultivuara si: “Përgjon djali tek lajthia”, ”Vetë m`ke thanë”, ”Moj Hatixhe”, “Suita vokale dibrane”, “Këngë për Isuf Murrën”. Së bashku me këngëtarët e tjerë të mirënjohur si Melita Shehu, Abdyl Sturçe, Muharrem Zajmi etj, hodhi themelet e interpretimit të këngës popullore qytetare dibrane.

Pasioni dhe përkushtimi për artin si dhe talenti i tij e çuan në Institutin e Lartë të Arteve, dega e aktrimit, duke qenë kuadri i parë dibran, në fushën e artit skenik i kualifikuar si aktor dhe regjisor. Shkolla ia rriti personalitetin artistik dhe e formuan profesionalisht në artin e fjalës.

Në punën e tij si regjisor i shtëpisë së kulturës, estradës apo teatrit, jo vetëm që nuk e braktisi këngën, por u aktivizua në të gjitha programet muzikore të institucionit dhe turnetë e organizuar brenda e jashtë atdheut, me Ansamblin “Dibra” e grupe të tjera të vendit. Emri i tij sa vinte e bëhej më i njohur si këngëtar.

Në vitin 1980, për muajin e letërsisë dhe arteve, kishin ardhur në Peshkopi artistët e popullit Avni Mula e Mentor Xhemali. Me rastin e këtij muaji, jepej koncert. Në momentin, kur sipas programit interpretoi baritoni Skënder Cala, artisti i popullit Mentor Xhemali u shpreh: “Kur dëgjoj këtë zë kaq të fuqishëm më duket sikur nuk jam në qytetin e vogël të Peshkopisë. Ky këngëtar është për salla të mëdha”.

Skënderi si regjisor i shtëpisë së kulturës, ka merita të padiskutueshme në gjallërimin dhe rritjen cilësore të lëvizjes artistike amatore. Ndërrmarrjet ekonomike dhe institucionet zienin nga veprimtaria artistike skenike.

Trupa amatore e shtëpisë së kulturës, nën regjinë e Skënderit është vlerësuar me çmime të para në takimet zonale e kombëtare si: Takimi i shtëpive të kulturës së rretheve për kulturën masive në Laç, Tropojë, takimet e ansambleve të

klasës punëtore në Durrës e Tiranë e grupet folklorike të Gjirokastrës. Të gjitha këto arritje të lëvizjes artistike amatore sollën krijimin e teatrit profesionist, ku Skënderi ka qenë regjisor për disa vjet.

Nuk mund të mos përmend një cilësi të çmuar të punës së Skënderit, si organizator i lëvizjes artistike amatore. Në punën e tij si regjisor, Skënderi shquhej në përzgjedhjen dhe seleksionimin e amatorëve. Krahas talentit me aktivizimin e amatorëve, mbështetej fort edhe në formimin e përgjithshëm kulturor. Jo rastësisht amatorët e tij ishin arsimtarë, mjekë, agronomë, ekonomistë, inxhinierë etj me arsim të lartë, duke rritur kështu autoritetin e institucionit. Disa artistë dibranë, të inkurajuar dhe ndihmuar nga Skënderi, mbaruan Institutin e Lartë të Arteve për aktrim.

Në arritjet e Skënderit ka pjesën e rëndësishme të saj, Ferihaja, bashkësorë e denjë dhe kolege pune. Një çift gjithë kulturë e qytetari.

Për Skënder Calën mund të thuhet se ai bën pjesë në plejadën e atyre artistëve dibranë që bëri emër në shtëpinë e kulturës “Haki Stërmilli” Peshkopi dhe në trupën e estradës e teatrit, dhe u dha emër atyre. Ndaj dhe ky libër është një dhuratë e bukur për Skënderin në 80-vjetorin e lindjes! Dhuratë e çmuar edhe për komunitetin e artistëve, artin dibran e më gjerë. Si përfundim dua të falenderoj autorin Halil Rama, i cili me këtë libër ka nderuar e lartësuar dhe veten.

Na ke bërë të qajmë, na ke bërë krenarë

Shaban Xhajku



Isha mësues në shkollën 8-vjeçare Grevë dhe njëkohësisht dhe përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës të po këtij fshati. Isha një nga pjesëtarët i lëvizjes amatore të rrethit. Një ditë marr një ftesë nga Skënder Cala për të marrë pjesë në një nga rolet e dramës “Cuca e Maleve”, të cilën po e vinte në skenë me shkollën e Mesme Bujqësore. Kam luajtur rolin e Nik Kacurrit.

Regjisori Skënder Cala, përveç punës krijuese dhe interpretuese me trupën amatore, e cila i merrte shumë kohë, punonte edhe me dekorin, me rekuizitën, marangoz dhe punëtor skene. Me një fjalë çdo gjë e kontrollonte, e pse jo, edhe punonte vetë për realizimin e çdo detaji. Shfaqja u dha dhe pati shumë sukses.

Ai dinte të gërshetonte përvojën e aktorëve profesioniste me atë të amatorëve që dilnin për herë të parë në skenë. Punë, punë dhe vetëm punë kishte për të. Këtë e tregon pjesëmarrja në shumë takime kombëtare të lëvizjes amatore, ku Skënderi është vlerësuar me disa çmime në rang vendi. Ai punonte me shumicën e ndërmarrjeve dhe qendrave të punës, shkollave dhe institucioneve. Kjo bëri që një pjesë e mirë e amatorëve më

të talentuar, që ai i aktivizonte, duke rritur kërkesat profesionale ndaj tyre, të rradhiteshin në nivelin e aktorëve profesionist. Si rezultat i kësaj pune dhe masivizimit të teatrit në qytetin tonë si dhe punës këmbëngulëse të Skënderit dhe artistëve amatorë, u bë e mundur ngritja e Teatrit Profesionist.

Skënderi nuk u shkëput nga lëvizja amatore, në qytetin tonë. Kujtoj që me Shtëpinë e Kulturës, drejtor i së cilës isha unë, Skënderi vuri në skenë dramën “Nesër është vonë”, shfaqje e cila u prit me mjaft interes dhe u shfaq 11 netë rriesht me sallën plot. Për punën e tij flasin vetë faktet, përkushtimi i tij, puna e kryer në ato vite, jeta aktive dhe plot vitalitet e Skënderit. Atë e deshën jo vetëm shokët me të cilët ai punonte, por ajo që më ka lënë mbresa ishte dashuria e artëdashësve të Dibrës mbarë.

Kujtoj gjithashtu që kishte bërë një kërkesë për t’u larguar nga Dibra, por unë e kisha kundërshtuar, jo vetëm se humbisnim Skënderin, por edhe Skënderi do të humbiste atë që kishte ngritur me punën e tij.

Një natë vonë, kur kishim dalë nga puna dhe po shkonim në shtëpi, po diskutonim përsëri për të njëjtin problem. Në këtë kohë i thërret një i ri, rreth të 30-ve, nga Kastrioti, i cili ishte pak i pirë dhe i drejtohet me këto fjalë: "E di që nuk më njeh dhe as emrin nuk ma di, por po të them që ne të njohim të gjithë edhe pse nuk jemi qytetarë. Ne njohim Skënderin-Skëndërbe, Skënderin-komisar, Skënderin-mësues, ne njohim Skënderin-artist të Dibrës. Na ke bërë me qa, na ke bërë krenar. Më falni se u mora pak kohë", dhe u largua.

Hë Skënder, i them unë, sa do të duhet që të njohin në një vend tjetër dhe të vlerësojnë e respektojnë si ky dibrani i pirë, që s’ia mësuam as emrin.

Ky është Skënderi, që e deshën jo vetëm shokët e punës dhe amatorët e tij, por edhe artëdashësit dibranë.

Ata i dhanë më shumë Dibrës sesa morën prej saj

Ymer Seferi



Në vjeshtën e vitit 1962, në qendër të pazarit të vjetër të Peshkopisë, përballë hanit të Izet Seferit, po jepej një shfaqje. Isha i ri, afër 13-të vjeç e zemra më gufante prej gëzimit se do të shikoja një koncert. Ishte e dielë, ditë pazari. Me qindra pazarlinj dibranë shikonin në podiumin e ngritur këngëtarët, aktorët dhe orkestrantët e Estradës së Peshkopisë.

Këndonin Melita Shehu, Muharrem Zajmi, Sadete Miftari e Besim Çutra. Atë ditë këndoi edhe një këngëtar i ri, simpatik, flokëzi, fytyrëqeshur, me trup prej sportisti që i jepte lezet skenës. Ishte tip ekspresiv dhe mjaft emocional. Kur filloi të këndojë, më mbërtheu aty në pazar, ulur në një kosh të hedhur e të shkatërruar plotësisht. Këngëtari quhej Skënder Cala.

Nuk e dija unë, adoleshenti Imer Seferi, që pas disa vitesh do të bëhesha mik e shok me të, në një punë, në një institucion, në sektorin e muzikës, unë si muzikant, fizarmoniçist e përgjegjës sektori dhe ai si këngëtar, aktor e regjisor i Estradës dhe më vonë i Teatrit Profesionist të qytetit.

Skënderi ishte për t'u admiruar si këngëtar, me kulturë, serioz, i disiplinuar, punëtor, një këngëtar shumëplanësh me zë

potent, i mirëintonuar dhe me një interpretim plot temperament, që të rrëmbente e të detyronte të përplasje duart me zor.

Skënderi interpretonte muzikë klasike, të lehtë, këngë qytetare nga të gjitha trevat dhe mbi të gjitha këngën popullore dibrane e këndonte me shpirt dhe plot emocion.

Në të gjitha skenat, brenda dhe jashtë vendit ai ka shkëlqyer me këngët “Moj Hatixhe”, “Ma ke gishtin për unazë”, “Shkurta e Hoklit”, këngët për patriotët dibranë: Elez Isufi, Sufë Xhelili dhe Isuf Murrja. Edhe sot, kur dëgjoj këto këngë më ngjallen emocione të papara, sikur Dibra po digjet në flakë e djemtë dibranë kërcejnë vallen e vdekjes mbi hasmin.

Në Estradën tonë Skënderi ishte bashkë me gruan, aktoren Feriha Shkodra, të cilët me punën dhe qëndrimin e tyre fisnik i dhanë kulturë asaj trupe. Gjithashtu kemi pasur fatin që në rritjen e emrit të kësaj trupe të ndikonin në formimin dhe forcimin kulturor edhe Tonin Rota ,me të shoqen Marien; Tefë Krroqi me Antonetën dhe Adil Shehu me Nexhin.

Këto emra i përmend plot respekt, sepse ishin për t’u respektuar e admiruar.

Ata i dhanë më shumë Dibrës se sa morën prej saj.

Sikur të kishte studiuar për kanto, çfarë baritoni do të kishte Shqipëria!

Edmond Zhulali



Isha në moshën trembëdhjetë vjeçare kur m'u afrova për të marrë pjesë në dramën “Ai vdiq në këmbë”, në rolin e Gjonit, birit të Gjergj Kastriotit (Skenderbeut).

Në atë moshë, të bëjnë përshtypje shumë gjëra e aq më tepër të imagjinosh që je biri i Gjergjit. Mua më ka mbetur në kujtesë ai rol, që ishte dhe i vetmi që kam luajtur. Por shumë përshtypje më ka bërë roli i Skënderbeut, një figurë e madhe, që interpretohej nga një aktor me zë të fortë e i fuqishëm. Këto impresione kështu kanë mbetur edhe sot tek unë, të një njeriu me dinjitet e serioz. Kjo do të ishte përshtypja ime e parë që do të krijonte figurën e artistit të madh dibran, Skënder Calës.

Do të kalonin vite dhe vazhdimisht do të shikoja Skënderin në skenën e Peshkopisë, herë si aktor e herë si këngëtar duke më befasuar me figurat e shumta që krijonte. Dhe do të vinte një ditë që unë do të isha koleg me Skënderin në qytetin e Peshkopisë, në këtë qytet me shumë kulturë e artëdashës.

Gjatë viteve që punuam bashkë, herë e shikoja si koleg, herë si prind e herë si mik i vëllait tim, Safetit, dhe familjes time. Dhe vjen një ditë që unë të kompozoj muzikë për dramat që vinte në skenë Skënderi, madje kompozova dhe orkestrova këngë për të.

Ndjeja një farë kënaqësie që unë drejtoja Skënderin duke kënduar dhe më kujtohej, vazhdimisht, kur mbante në kokë përkrenaren e Skenderbeut dhe unë i thërrisja “babë”. Zëri melodioz i një baritoni dramatik, që duartrokitej pafund në këngët e Elez Isufit, Sufë Murres, Komisarit e mjaft këngë të kompozitorit të shquar Tonin Rrota.

Nuk mund të mos më emociononte dhe mua e shpesh thojta “Sikur Skënderi të kishte studiuar për kanto, çfarë baritoni do të kishte Shqipëria”.

Të paharruara do të mbeten interpretimet e Skënderit, në role të ndryshme si drama, filma, recitime etj.

Gjatë karrierës së tij ai ka shkëlqyer si regjisor duke punuar me vetëmohim në një vend të vogël si Peshkopia, me aktorë profesionistë, amatorë, dhe duke i transformuar ato në artistë të vërtetë, që përjetonin rolet e ndryshme dhe i jepnin publikut dibran kënaqësi artistike. Nuk mund të mos kujtoj me dhjetëra të rinj me të cilët Skënderi punonte me shumë dashuri, duke qenë një mësues i vërtetë e duke i futur ato në rrugën e artit.

Skënderi shoqërohej gjithnjë nga një pasion i fortë, veti kjo e njerëzve të thjeshtë, të ndershëm e të drejtë. Gjithmonë e kujtoj zërin e fortë të Skënderit, që me një kurajo qytetare të guximshme për kohën diskutonte e debatonte. Skënderi ishte njeri, që e përkrahte përparimtarin, të guximshmen dhe të renë.

Ai është ndër të parët intelektualë dibran, që përkrahu proceset demokratike, që ndieu erën e lirisë e demokracisë që po lulëzonte mbas dimrit të gjatë komunist. Si shumë të tjerë edhe ai u vendos në Tiranë.

Tani, i pjekur e plot përvojë, do të drejtonte artin në Bashkinë e Tiranës, duke dhënë një kontribut të madh e të vlefshëm. Por ja, që vitet ikin e një jetë plot kujtime, interpretime, role të ndryshme, suksese, duartrokitje e mbi të gjitha një shoqe, një kolege e një mike e madhe si Feriha Cala, i rrinë sot në krah Skënderit duke i dhënë atij dimensionin e një artisti e njeriut të madh për Dibrën e mbarë Shqipërinë.

Njohja ime me zotin Cala

Ramazan Kica



Në maj të vitit 2017, në Bulqizë u bë një premovim i vendosjes së bustit të Gjergj Kastriotit, në përkujtim të *betejave Valkale*, mes Skënderbeut dhe Ballaban Pashës. Në një takim paraprak që u bë në ambientet e bashkisë Bulqizë, ndër të tjera, duke diskutuar për betejat e Kastriotit me osmanët në Bulqizë, u lakua dhe beteja e parë e tij, ajo kundër Ali Pashës, në verë të vitit 1444, e njohur konvencionalisht si *beteja e Torviollit*.

Pjesa më e madhe e të pranishëmve ishin të bindur që kjo betejë është bërë në *fushën e Kalasë (fushën e Farishtës - Farajshëtës)* në Valikardhë. Unë fola për dy betejat e Skënderbeut me Ballabanin, të cilat lidhen me luginën e Bulqizës, por jo fiks aty ku mendonin të gjithë të tjerët. Ndërsa për betejën e vitit 1444, mes Kastriotit dhe Ali Pashës, nuk u prenoncova. Pas meje ndërhyri Skënderi dhe tha që beteja e Torviollit është bërë në breg të Drinit Zi, në Dibër të Poshtme, te një fushë që quhet *Torra e Voles*. Gjithashtu zoti Cala sqaroi që këtë studim e ka bërë Hasis Ndreu.

Atëherë mora fjalën, duke iu drejtuar Skënderit dhe i thashë: Beteja e parë e Gjergj Kastriotit me forcat osmane nën komandën e Ali Pashës, në verë të vitit 1444, e quajtur

gabimisht *beteja e Torviollit*, nuk është bërë në Bulqizë, dhe aq më pak në rrafshin e Drinit të Zi, aty ku thua ti. Unë për këtë betejë kam studiuar shumë dhe kam bërë një libër, të cilin akoma nuk e kam botuar. Që të debatojmë për këtë, duhet që të lexosh librin tim paraprakisht. Pastaj, do të jem i gatshëm të përballlem me ju. Skënderi nuk u mërzit nga kundërshtimi i prerë që i bëra dhe për çudi, më tha që dua ta lexoj studimin tuaj, madje me shumë kënaqësi.

Shtoj, që studimi im për betejën e parë të Skënderbeut, që e largonte atë nga Bulqiza, kishte ngjallur një irritim aty, për lasje qejfmbetëse e cila kishte bërë që libri të flinte ka disa vite.

Me kaq u mbyll biseda. Pas dy muajsh Skënderi, më kërkoi librin. Ia dhashë. Të nesërmen, më telefonoi dhe më tha:

- Që kur e fillova dje, nuk e lashë deri sa e përfundova, madje shpesh jam kthyer mbrapsht, më shumë se një herë. Ke zbuluar, me të vërtetë, vendin e kësaj beteje. Nuk kam ç'të të them. Po, përse nuk e boton?

I shpjegova që i vetmi shqetësim, pas kundërshtimit nga miqtë e mij nga Bulqiza, është dhe çështja e Mokrës.

- Mokra është në Grykën e Radikës. Këtë e ka thënë Kristo Frashëri, si dhe... Këtu je gabuar ti, që e çon atje afër Pollogut e Shkupit...

- Skënder, - i kundërshtova, - Skënderbeu është nisur natën nga kampi i tij, me gjithë ushtrinë, ka kaluar Mokrën, dhe ka bërë betejën me ushtrinë osmane nën komandën e Karaxha beut në Pollog, duke e përfunduar atë pa u gdhirë dita. Nuk mund të shkojë ushtria, brenda natës, nga Gryka e Radikës në Pollog...

- Ke të drejtë...

Zoti Cala u tregua i gatshëm që të shkonim në Maqedoni...

Në qytetin e Dibrës na u tregua shumë i gatshëm për të na ndihmuar, zoti Luan Slllova, të cilit i jam mirënjohës. Pasi bëmë shumë debate me zotin Slllova, i cili ishte njohës i mirë i atyre territoreve, sepse kishte punuar si inspektor më

Ministrinë e Arsimit, shoshitëm kundërshtimet, duke qenë të kujdesshëm që të mos binim ndesh me Barletin.

Skënder Calës i jam mirënjohës jo vetëm për përkushtimin që bëri duke më shoqëruar në Maqedoni, por dhe për faktin se nguli këmbë që unë të botoja librin "Beteja e parë e Skënderbeut", me nëntitull "Beteja e Korabit".



Në ambientet e Bashkisë Bulqizë, maj 2017

Pata fatin që të jem redaktori i këtij libri. Në *dhënien e trajtës përfundimtare* të tij para botimit, si autori, z. Rama, por dhe personazhi i tij, z. Cala, më lanë dorë të lirë. Por, i ndodhur mes bindjes time, të shenjtë, për të mos i prekur mendimet dhe opinjonet e personave që kanë shkruar, dhe bindjeve të mia mbi problemet që trajton libri - zgjedha të parën. Por, një pyetje më mbeti enigmë, si çengel i varur në *honin vrastar të shkretëtirës së hipokrizisë*:

- Nëse Dibra dhe dibranët, kanë kaç shumë vlera dhe janë realisht aq lart, unë nuk kupoj, përse të gjithë ne, sapo na u dha mundësia, u larguam përgjithmonë prej tyre, duke realizuar një ëndërr që, diku, e ledhatonim duke e përkëdhelur ëmbël dhe pandaluar?!

Përgjigjia nuk vjen!, ajo tretet duke u endur...

Koha të zbardhi, por fisnikëria të mbeti

Rifat Poga



Njeriu është i pafuqishëm para kohës. Koha të mpak, të rrudh dhe të kërrus. T'i merr huret një nga një dhe çuditërisht në vend që të nxijë, të zbardh. Koha te shoku dhe kolegu im Skënder Cala, prej vitesh nuk ka arritur të bëj shumë zullume. E përse? Sepse, Skënder Cala ka ditur që t'i bëj ballë tallazeve të jetës me nder e dinjitet, pa e ulur shpinën, ndaj pushtetarëve e më të fortëve. Kam kohë që njihem me Skënderin e Ferihanë, bashkëshorten e tij, një grua shumë e përkujdesur për Skënderin. Shumë xhentile dhe plot sharm, për të respektuar deri në fund miqësitë e Skënderit. Takohem shpesh në librarinë e tyre. Rrufisim filxhanët e kafesë dhe bëjmë sinoptikën e kohës, turravrapin e saj deri në ditët që jetojmë.

Skënderit, i kujtoj gjithnjë, se si e kam njohur dhe se si është vulosur në kujtesën time. Kujtoj pritjen që i bëri publiku shkodran, në Takimin Kombëtar të Estradave Profesioniste, në vitin 1975, për interpretimin e këngës "Poeti partizan". Jo më kot e përmenda këtë këngë, sepse ishte shumë e vështirë të kapej nga ana vokale dhe profesionale. Por edhe pse ishte kënduar më parë nga Artisti i Popullit, tenori Gaqo Çako, miku

im e detyroi publikun shkodran që të kërkonte përsëritjen e këngës dhe u ngrit në këmbë. E duartrokiti fort, gjatë dhe shëndetshëm.

Miku im nuk u kërrus asnjëherë para kohës. Në vitet 1963-1968 studionim bashkë në Akademinë e Arteve. Po sjell në kohë një të vërtetë. Ne, të Veriut, pavarësisht se nuk dilnin hapur, na shikonin ndryshe. Në natyrën time, unë kam qënë pak i drojtur, me sedër. Për këtë dialogoja me Skënderin, që më jepte kurajo duke më thënë: “Ne do t’ia dalim. Edhe këta që e mbajnë veten për “qytetarë”, nuk kanë asgjë më shumë se ne”. Koha është një gjykatëse e rreptë. Ajo bën punën e vet. Skënderi ka debatuar me pedagogë dhe me autoritete të larta shtetërore dhe partiake të atyre kohëve, për të mbrojtur dinjitetin tonë, aq sa në një rast vuri në pikëpyetje edhe të ardhmen e tij. “Shpërblimi”, në fund të studimeve (i talentuar në shumë plane, këngëtar, aktor, regjisor skenik), ishte “i majmë”. Ishte projektuar, si aktor në Teatrin Popullor dhe pedagog i Mjeshtres së aktorit në Akademinë e Arteve. Atë e caktuan në Dibër. Dolën në pah aftësitë e tij, kur konkuroi në disa takime kombëtare, me shumë dinjitet, duke i ardhur Dibrës me shumë çmime të para. Po sjell para lexuesit një episod, dëshmitar i të cilit kam qënë vetë. Në Durrës zhvillohej Takimi Kombtar i Teatrove. U vendos që Flamuri i Festivalit t’i jepej Dibrës për dramën “Rrënjët” e autorit Kujtim Spahivogli, vënë në skenë nga Skënder Cala. Para se të shpalleshin çmimet erdhi një urdhër nga lart që t’i hiqej flamuri trupës së Peshkopisë dhe t’i jepej Korçës. Dibra do të merrte vendin e parë.

Koha sot nuk ka arritur t’ia marrë të gjitha huret. Është po ai Skënder simpatik, me përkushtim brenda mundësive për të ndihmuar të tjerët, në këtë kohë të trazuar edhe pse në pension. Koha të zbardhi, lum miku! Megjithatë, ajo nuk ka mundur që të heqë asgjë nga fisnikëria e këtij njeriu artist, të kultuar e kaq dashamirës.

Një jetë në skenë, dashuri mbi të gjitha dashuritë
Skënder Cala, aktori, regjisori, këngëtari i fonotekës së artë
në Radio Televizionin Shqiptar

Mevlud Buci
Shkrimtar



Kam shumë kohë që e kam peng për veten time, të shkruaj për artistët Skënder e Feriha Cala. Sigurisht për njerëz të tillë nuk është e lehtë.

Ata kanë një jetë në skenë, një jetë mes dashurishë.

Skënder Cala është dhe do mbetet artisti shumëdimensional i Dibrës dhe i kombit. Po ashtu dhe Ferihaja, bashkëshortja e e tij, lindur e rritur në Shkodër.

Dibrani i nderuar Skënder Selman Cala është nipi i Shkodrës, po dhe dhëndrri i saj.

Pasi mbaroi studimet në Akademinë e Arteve, ku u njoh dhe u dashurua me aktoren e talentuar të humorit Ferihanë, u martuan.

Ferihaja i dha jetë skenës së Dibrës. Ajo krahas emancipimit solli dhe humorin e bukur shkodran. Interpretoi me mjeshtri në Estradën e Peshkopisë, në mbi dy dekada. (dhjetëvjeçarë). Feriha Cala që një shembull për femrën e re

dibrane duke ndihmuar në emancipimin e saj. Luajti dhe si aktore dramatike në disa shfaqje teatrale. Ajo erdhi në Dibër në moshë shumë të re, saqë kur e pyesin se nga është përgjigjet: "17-të vjeçe shkova nuse te Skënderi, gjejeni se nga jam!"

Këmba a kësaj shkodraneje të re në vitet 7-80-të, shkeli në tërë krahinat dhe fshatrat e Dibrës me Estradën e Peshkopisë, duke lënë mbresa të mira kudo. Sot është në pension si edhe bashkëshorti, artisti i shquar Skënder Cala.

Skënder Selman Cala u rrit me dashuri për vendlindjen e të parëve të tij, Dibrën dhe popullin fisnik e të mençur të saj, plot histori mahnitëse si vetë natyra e saj.

Me dashuri për prindërit e tij të shkëlqyer, që aq shumë e deshën dhe sakrifikuan që djali i tyre të bëhej artist i shkolluar.

Kënga, një tjetër dashuri për Skënderin, që mbeti dhe hobi i tij i përrjetshëm. Por mbi të gjitha, dashuri mbeti teatri. Mbaroi studimet e larta në Akademinë e Arteve, dega aktor.

Vlerësimi i Akademisë në atë kohë për aktorin e ardhshëm që maksimale.

Të mëdhenj qenë dhe artistët, që e përgatitën Skënderin për në rrugën e artit. Dhe për pedagogët, Skënderi mund të flasë me orë të tëra, e nuk mbaron së qeni mirënjohës për vetitë e tyre. Kujton me krenari e mall artistët e popullit, Naim Frashëri, Kujtim Spahivogli, Pjeter Gjoka, etj, përvoja e të cilëve në orët e mjeshtres së aktorit, apo bukuria dhe mençuria e fjalës artistike që me mjeshtri zërthehej nga pedagogoet e artistët e mëdhenj Mihal Luarasi e Prokop Mima.

Në vitin 1970 Skënderi mbaroi dhe kursin pasuniversitar për regjisor teatri. Një tjetër vlerë e fituar për të marrë përgjegjësi më të mëdha, të cilat kulmuan me dhjetëra e dhjetëra premiera. Në dhjetëra çmime të para, në takime dhe olimpiada të cilat shtuan besimin te talentet e reja në Dibër për teatrin. Dhe si rezultat, deri në mundim, erdhi fryti. Në vitin 1984 miratohet Teatri Profesionist, me dhjetë aktorë. Kjo ngjarje ka qenë evenimenti më i rëndësishëm në karrierën

artistike, për regjisorin e parë të teatrit profesionist, Skënder Calën.

Të tjera shfaqje me nivel cilësor më të lartë do të ndiqnin trupën e Dibrës deri sa të përballej me trupat më të vjetra të teatrit në Shqipëri.

Por edhe këngën Skënder Cala nuk e la kurrë. Mjeshtria artistike edhe në këngë erdhi duke u rritur. Për këtë kontribut e kanë vlerësuar kompozitorët më të njohur, si Tonin Rrota, Zef Çoba, Përparim Tomçini, Edmond Zhulali e dhjetëra orkestrantë të tjerë të talentuar që e donin aq shumë.

Për Skënderin, flasin dhjetëra këngë të kënduara prej tij, që janë të incizuara në Radio Televizionin Shqiptar, në Radio Kukësi, Radio Shkodra etj, e që pasurojnë repertorin e këngëtarëve të njohur si Ibrahim Tukiçi, Sali Brari, Qemal Kërtusha e deri te më të rinjtë, si Manjola Nallbani etj.

Këngë të kënduara aq bukur nga Skënderi e Melita Shehu si “Ma ke gishtin vash o për unazë”, “Vetë më ke thënë”, “Jepma mollën”, “Burrat e Dibrës kanë lidhur besën” etj, kanë mbetur në kujtesën tonë.

Zëri i tij ka buçitur brenda e jashtë vendit, Maqedoni (1971, 1979), Kosovë (1980), Turqi (1982) dhe Itali (1999).

Një dashuri e re ka bërë vend në familjen e artistëve Skender e Feriha Cala. Është libri “Magjia e Dibrës”, që ka për autor Skënderin. Në të janë gjurmët e artistëve Cala, të paharruara për artin, për brezat, për kulturën e vendit. Talenti, kontributi, thjeshtësia, shpirtmadhësia, humanizmi dhe vitaliteti i këtyre artisteve na bën të ndihemi krenar në dibranëve.

Një jetë plot sakrifica, me punë e pasion, me emocione të papërsëritshme, që krijojnë ansamblin e një jete midis dy dashurish....

Si e njoha Skënder Calën?

Azis Keta



1. Kolonel Beshiri

Me Beshirin, vëllain më të vogël të Skënderit, ishim shokë të rinisë dhe me diferencë moshe tre vjet. Qenja e të dyve dibranë, “miq të librit” në të njëjtin korpus dhe dikaster, dhe të dy me gradën “Kolonel”, na afroi më shumë. Kishim dhe të tjera koinçidenca befasuese:

Të dy kishim nga një vëlla shtatë vjet më të madh se veten dhe të dy me emrin e njëjtë:

Skënder!

Bashkë me Beshirin shkëmbenim libra, shihnim shfaqjet artistike, ndiqnim ekipin e futbollit “Korabi” të kohës së Taxhedin Shehut dhe flisnim për “dy Skënderat”, që shpesh ktheheshin në kryefjala e çdo bisede.

Isha unë që nxisja këtë bisedë, sepse “Skënderin e Beshirit” e kisha shumë për zemër dhe përpiqesha të ndiqja shfaqjet që jepnin Estrada dhe Teatri i Dibrës, si dhe gjithë filmat, ku dhe Skënderi ishte pjesë në role të ndryshme.

Të njëjtën gjë bëja sa herë do të shkoja me shërbime në

Peshkopi ose në “festën e 3 Gushtit” në Zerqanin e kohës së Mahmut Hafizit, ku trupa artistike e Peshkopisë e “kohës Skënder Calës” jepte shfaqje.

Kur Skënderi botoi librin “Magjia e Dibrës”, interesimi i dashamirësve të tij, dhe jo vetëm, ishte i justifikuar. I imi ishte edhe më shumë, sepse libri m’u dhurua nga dy vëllezërit, Skënderi dhe Beshiri, tashmë dhe të mijtë. Ndaj dhe këto shënime modeste janë dhe për Beshirin që na mungon fizikisht, por jo shpirtërisht.

2. Kurthi artistik të “Magja e Dibrës”

Qysh në titull, libri ishte intrigues. Për ç’farë magjie bëhej fjalë?

Për “magji të keqe”, atë që të “lidh këmbët”, të mbyll fatin dhe bëhesh problem i vetes, familjes, fisit, kombit, apo për magjinë, si vlerë njerëzore, krijuese?

Enigma “zgjidhet”: Ishte kjo e dyta! Madje, “Magjia” ishte e shkallës sipërore, sepse Skënder Cala ishte, dhe është, mjeshtër i detajeve. Ai kishte shkollën e përvojës, sepse e kishte filluar si mësues dhe kishte përfunduar artist i skenës ende pa shkuar brishtë në faqe. Ishte i “rrahur me vaj e me uthull” qysh kërthi, jo vetëm në “teatrin absurd” të kohës (pse i ati kishte qenë xhandar), por edhe në skutat e ambicieve të artit, ku askush nuk e deshte të mos i besohej roli i Skënderbeut në teatër dhe të disa roleve në filma, kur në ato kohë ato numëroheshin me gishtat e dorës.

I “blinduar” me këtë “magji”, Skënder Cala, te “Magjia e Dibrës”, e merr lexuesin “përdore”, si atë plakën e Zall - Dardhës, që e trajnoi në skenë, se si të “vajojë Skënderbeun” dhe na çoj, ku ai do vetë.

Me këto aftësi të përveçme, si “Mjeshtër i Madh”, Skënder Cala na fut në botën e “Magjisë së Dibrës”, ku na shfaqet befasisht dhe profesionalisht si “gjeneral” i fushës së vet, që i

merr “gradat” shkallë-shkallë, me hapa të shpejtë, por “pa zënë në thu”.

Fillimisht solist, e me radhë: parodist, pasionant pikture, aktor, regjisor...

Pas viteve 90-të, do të ishte pjesë e proceseve politike që çuan në ndryshimin e sistemit. Në vazhdimësi, është shfaqur si qytetar e intelektual me ndjeshmëri të lartë kritike ndaj së shkuarës dhe u bë pjesë e pushtetit pluralist të kohës.

Te vepra e tij “Magjia e Dibrës”, Skënder Cala na shfaqet dhe si shkrimtar. Edhe te ky libër, Skënder Cala shëndrohet në “regjisor” të shpirtit tonë. Që pasi na ka ulur perden e shfaqjes, që ka dirigjuar po vetë, na jep historikun e zhvillimit të artit, në katër dekada, në Dibër dhe jo vetëm.

Ndaj dhe Skënder Cala, te “Magjia e Dibrës” ka “magjinë”, që të na mbaj të “lidhur”, ashtu si spektatorin në skenë, përderisa të na ketë thënë artistikisht, gjërë dhe gjatë, atë që ai kishte paramenduar me kohë.

3. Mesazhet filozofike që përcillen te magjia e “Gropës së Dibrës”

Toponimi “Gropa e Dibrës”, është i njohur në Dibër dhe jo vetëm, por magjia e Skënder Calës qëndron te detajet artistike dhe kontrastet alegorike që autori iu vendos personazheve dhe ngjarjeve historike te kjo “Gropë”.

Ku qëndron “magjia”?

Autori i vendos përballë burrat e mëdhej të Dibrës (ata të maleve), që i qëndruan besës dhe u dalluan për trimëri të mëdha, me ata të “Gropës”, që të lidhur (në ndonjë rast) me fije të dyshimta me pushtuesin, jo rrallë herë i bënë “gropën” Dibrës dhe burrave të mëdhej të saj.

Ndonjëri ndër të mëdhejtë, që zbritën nga “gjunjët e Korabit”, që të çlironin ata që kishte mbetur në “Gropë”, mbeteshin dhe vetë në të, sepse vetë “Gropa” ishte kthyer në

“thithlopë” për ta, e ndër ta, edhe për Elez Isufin. Janë njohuritë e thella historike të Skënder Calës, që na fut aristikisht në magjinë e kësaj “Gropë” dhe na lë aty, jo se na harroi, por e bën me ne (në mendim) regjisorin, ashtu siç bëri me atë “plakën e Zall-Dardhës”, për të dalë aty ku ai do - te mesazhi: “Dibra, po aq sa u vra me të huajin, po aq u vra dhe me veteveten, sidomos në kohë komunizmi”. Dhe, ku magjia?

Lexuesi, hyn me mendjen e tij te “Gropa e Dibrës” dhe del prej saj me mendjen e Skënder Calës. Është kultura e gjërë dhe njohja e thellë e alegorisë së Dibrës që e evidentojnë Skënder Calën edhe si mjeshtër të mesazheve të maskuara filozofike.

Ku magjia?

Mesazhet janë lehtësisht të asimiluesheme edhe nga niveli i mesëm i lexuesit. Sepse ky Mjeshtër, tashmë dhe si krijues letrar, nuk e kërkon mendimin te “fjalori akademik”, por te gjuha e folur e popullit. Ndaj dhe ngjarjet i shtjellon lakonisht dhe mjeshtërisht, duke i lidhur ato me të përditëshmen: Pazarin, hanin, qeleshpunuesin, kasapin dhe tellallin . Pastaj na lë aty si “huta”, për të na dhënë mesazhin e nënkuptuar: “Njerëzit duhet të jenë vigjilentë, të mos gënjehen me një thes mielli, një ditë para zgjedhjeve”.

Është kjo “magji” e Skënder Calës, si mjeshtër i detajit skenik dhe i mendimit të shkurtër alegorik, kur ai na krijon skena sa groteske aq dhe thirrje për vigjilencë. Trukun artistik e kërkon dhe e gjen në ngjarje, në dukje, rutinë.

Veçon “në tregun e gjësë” shelegët, mushqerrat dhe viçat, që do mashtroheshin nga i zoti, duke i ushqyer mirë, me misër, ujë e kripë, pikërisht një ditë para se do shiteshin si “mish peshë e gjallë”, ose do të thereshin!

Edhe në këtë rast, alegoria është therëse, shkatërruse, sepse hiqen paralelizma të nënkuptuara artistikisht: Ashtu siç mashtrohej kafsha e gjorë në “Gropë Dibre”, po ashtu ishte mashtruar një mik prej Lugjeje, ku ai i “Gropës së Dibrës”, mbasi ia kishte shtruar me bukë e mish në darkë, në mëngjes

“mikun” e kishte dorëzuar “kurban” te “Dega e Brendëshme”.

Po te “Gropa e Dibrës” autori lë të nënkuptuar edhe vrasjen e dyshimtë e Elez Isufit!

Ja pse “Gropa e Dibrës”, nëse do të tentonim përditësimin e saj në një analizë kritike dhe të hiqnim paralelizma, mund të dilnim në përfundimin: “ Në raste të veçanta, ajo ende mban erë gjaku, avullon erë gjaku dhe të turbullon gjakun”. Sepse Dibra, edhe se pse, historikisht, nxorri dhe vazhdon të nxjerrë krom, ministra e burra shteti, deputetë e kryetarë bashkishë, drejtorë policie, kryetarë të komisionit të ligjeve dhe të Gjykatës Kushteuese, ajo përsëri mbetet skaji fundor i përkujdesjes shtetërore dhe institucionale.

Ndaj dhe Skënder Cala , vendosi për të shkruar, e ndoshta për të na zgjuar:

“Pa ditur se nga vimë, nuk dimë nga shkojmë!”

4. Një peng që më mbeti “plagë shpirti”

Kur u vendos përmendorja e Skënderbeut, në përkujtim të dy betejave të mëdha në Vajkal të Bulqizës, Mjeshtri i Madh Skënder Cala ishte i ftuari kryesor i nderit, me idenë që: Në pikën kulmore të aktivitetit, që u zhvillua në sallën e shfaqjeve të Qendrës Kulturore në Bulqizë, ishte parashikuar të na rishfaqej në skenë, befasisht dhe me madhësi, Mjeshtri i Madh Skënder Cala, që do na riluante Skënderbeun, pikërisht aty ku po përkujtohej Skënderbeu.

Sepse kjo përmendore, ishte “nishan historik” i betejave të Skënderbeut në Bulqizë dhe prania e Skënder Calës në këtë aktivitet madhor, që kishte luajtur në skenë Skënderbeun, ishte një befasi e bukur.

Sepse ishte nga të vetmit aktorë, nga të mbeturit gjallë (mbas Loro Kovaçit dhe të tjerë), që kishte luajtur në skenë Skënderbeun.

Në funksion të kësaj ideje, në ish Kinostudio, (ku ishin

transferuar përkohësisht disa drejtori të Ministrisë së Kulturës dhe Sporteve), kishim paraqitur kërkesë kundrejt një garancie finaciare, të merrnim në përdorim, 24 orë, një kostum të veshjes së Skënderbeut me të cilin ishte luajtur opera Skënderbeu dhe po me këtë kostum do rishfaqej në skenë Skënder Cala në Bulqizë.

Njohja e Skënderit me këtë ide, e emocionoi shumë dhe e priti propozimin me shumë nderim dhe përkushtim. Por papërgjegjshmëria, xhelozia apo parcelizimi politik i kërkesës prej një zyrtareje të “Rilindjes” (Skënder Cala njihej si i djathtë), përmbysi gjithçka dhe ideja dështoi edhe se përpjekjet tona ishin maksimale.

Ky dështim më mbeti plagë shpirti, se ishte e vetmja mundësi që pati Bulqiza për ta patur në një moment kulmor historik të saj, Skënder Calën “Skënderbe” edhe në Vajkal, ku Skënderbeu i vërtetë kishte zhvilluar dy beteja të mëdha të nivelit kombëtar.

Por, do të ishte një tjetër djalë Bulqize, historiani i talentuar Ramazan Kica, që në nderim të këtij Mjeshtri të Madh, në kopertinë të librit të tij historik për betejën e parë të Skënderbeut me Ali Pashën, vuri foton e “Mjeshtrit të Madh” Skënder Cala. Edhe kjo, një tjetër dëshmi që bulqizakët dhe jo vetëm, ruajnë ende vlerësimin maksimal për kontributet e përveçëm të Skënder Calës në fushën e artit dhe jo vetëm.

Brezi im ishte me fat që ishte bashkëkohës me këtë Mjeshtër të këtij kalibri, provoi emocione prej tij, jo vetëm në skenë.

Mirënjohje për mirënjohjen Pak radhë për artistin Skënder Cala

Namik Selmani, Boston, 17 gusht 2019



Sot, për besë, nuk po di se kujt me ia dhënë saktësisht hisen më të madhe të mirënjohjes për këtë libër e për mundësinë për të shkruar disa mbresa. Atij dibrani, me emrin e vecantë Skënder Cala deri në palcën e palcës, që i la historisë së atij qyteti e asaj krahine, kujtime që do të jenë arkivi i kujtesës, apo punëmadhrit Halil Rama (një dibran tipik në punën e përditshme të një argati fisnik shkronjash dibrane)?

Unë nuk e kam parë Skënder Calën në skent e teatrit dibran. Unë nuk e kam parë atë në skenat e këngës, se lulet e vetme të këtij trualli do ia jepja plot bujari me fytyrën e skuqur para këtij njeriu me një botë të madhe, që ia kishte dhënë talentin, punën, shëndetin këtij qyteti, që e donte kaq shumë.

E rrodhën vitet! Më duhet ta njihja në një lagje mjaft të populluar në Tiranë, siç është lagjja ku unë kisha pak vite që jetoja.

Si film më bëri përshtypje që në një dyqan mes sa e sa kafeneve gati të panumërta, të zhurmshme, ku flitej pak ose aspak për librin, por edhe me një luks të paparë; të kishte një librari. Po. Po, një librari nga ato që këtu, në Amerikë, i sheh

edhe te mjediset e farmacive apo te supermarketet. Në vend të një shitëseje femër nga ato që jemi mësuar të shohim shpesh, ishte një burrë sqimatar. Me një buzëqeshje të ngrohtë dhe me një shqipe jashtëzakonisht të pastër, të ëmbël, me një kolorit gjuhësor dibran që kisha kohë pa e parë, pa e dëgjuar.

Dhe ishte Skënderi. Një artist dibran në kuptimin më të mirë të fjalës. Njeri artist. Shpirt artisti. Dhe miqësia me të ishte më e shtrenjtë se një shufër e florinjte.

Jetoja brenda modestisë së tij karakteristike, ashtu si janë dhe mbeten njerëzit e vërtetë, që ngjiten majave me ndershmërinë dhe aftësinë e tyre. Dhe kryebiseda niste e mbaronte me teatrin, me këngën dhe me librin, që na rrinte në sy ballaz, na rrinte pas krahëve. Na rrinte në zemër. Një jetë me librin, që të dyve, biseda me të, ia kalonte sa e sa intervistave shpesh të stisura. Intervista, ku ka vetëm qiell e pak tokë, pak ugar, pak jehonë blirësh e fëshfërtije mollësh. Pak zhurmë magjike të skenës, e cila atë e kishte shoqëruar një jetë të tërë. Mbase ato takime ishin dhe shtysa e punës disamujore me esetë që bëra për këngët dibrane: “Moj fushë e Korabit”, “Kur e përcolla ylberin”, etj. Po, më kishte bërë pak dibran më shumë Skënderi, e unë nuk dija se si t’ia shprehja mirënjohjen. Nuk dija e fjala më ngecte, pa e ngritur kurorën e nderit për të.

..Një ditë nuk e pashë më librarinë. Kishin ikur librat si ca zogj, që kushedi se ku i kishin ndërtuar çerdhet. Apo më e keqja që mbase nuk do të kenë pasur me çerdhe kaq të ngrohtë sa sytë, dora e zemra e Skënderi, që i kishte të tërë brenda vetes.

M’u dukën më të trishtuara ditët pa librarinë e pa Skënderin. Atëherë dhe tani. Sa herë që shkoj te kthesa që më dërgonte te shtëpia, e kthej kokën. Mbase e takoj. E ta shoh atë si dikur tek më zgjaste dorën duke më ftuar në atë dhomën e tij, në odën e tij, ku ai ishte vetë tymtar, vetë urtak, vetë zot. E sot mbase e shlyej pak këtë peng, e mirënjohja ndahet me Halil Ramën që e zgjon këtë fisnikëri.

Skënder Cala, një institucion i mëvetësishëm i artit dibran

Besim Ndrejoni⁸



Pata një ndjesi dhe krenari të veçantë, kur miku i përbashkët i Skënder Calës dhe i imi, studiuesi i talentuar Halil Rama, më ftoi të jepja opinionin tim në këtë ngjarje të rëndësishme, për nder të artistit, këngëtarit, shkrimtarit Skënder Calës, në 80-të vjetorin e lindjes.

E kam njohur artistin e madh dibran me përmasa ndërkombëtare në vitin 1969. Takimi i parë ka qenë në Shtëpinë e Kulturës “Haki Stërmilli”, Peshkopi. Në koridorin e këtij institucioni, na prezantoi artisti dhe kulturologu i Dibrës Hazis Ndreu.

Në vitin 1969, zona e Katër Grykëve, vendlindja ime, kishte konkuruar në shkall rrethi dhe kishte fituar çmimin e parë, si estrada amatore, dhe do të konkuronte si përfaqësuese e Dibrës në Festivalin Kombëtar të Veriut, që zhvillohej në Peshkopi. Unë isha pjesë e kësaj estrade dhe recitoja një poemë satirike të Hazis Ndreut, si dhe isha një aktor amator i talentuar, por që dilja në skenë për herë të parë. Falë talentit

⁸ President i Unionit Mbarëkombëtar të Integritimit të Burgosurve dhe Përndjekurve Politik të Shqipërisë.

tim, regjisori Sami Shehu, mësues në Qafë-Murrë i kishte bindur drejtuesit e partisë të Katër Grykëve që të intepretoja në atë festival. Në sytë e mi, të një adoloshenti malësor, pamja e Skënderit në takimin me të, më la mbresa të mëdha, si nga pamja dhe biseda. Ai ishte i gjatë, i pashëm, me flokët e zinj, me sy të këndshëm, i veshur bukur dhe me shije, por shumë i thjeshtë e dashamirës. Më dha udhëzime se si të intepretoja vjershën e skeçet dhe më porositi të zbatoja me përpikmëri porosinë e regjisorit, shkodranit të ditur, Tef Krroçi.

Festivali u zhvillua në shtator (nqs nuk gaboj), dhe ne Katërgrykasit e Dibrës u nderuam me çmim të parë. Gjithashtu unë mora çmimin e parë si aktor. Çmimin ma dorëzoi ish-Ministri i Arsimit Thoma Deliana, i cili më dha të drejtën e studimit në prezencën e autoriteteve të rrethit që të shkoja në Liceun Artistik në Tiranë. U gëzova pa masë si një fëmi malësori, pa dalë nga fshati. Fluturoja nga gëzimi për këtë fitore. Por, në Dibër, një fjalë e urtë thotë: *“Dardha e ka bishtin mbrapa”*. Kështu më ndodhi dhe mua. Kur shkova në Seksion të Arsimit, në zyrë gjeta shefin Sh. M, i cili më kishte duartrokatur në shfaqje dhe kishte qënë present kur Ministri më premtoi të drejtën për të vazhduar studimet në Liceun Artistik. Ai më pa me urrejtje dhe filloi me zë të lartë: “Partia nuk dërgon në shkollë bijtë e armiqve të saj. Ta dinte Ministri se ti je djalë armiku, nuk do të të lejonte as të ishe pjesë e shfaqjes!”.

Bubullimat e shefit më shokuan mua një djalë 13 -të vjeçar malësor, që kisha dalë në Peshkopi për herë të parë në këtë aktivitet. Dola i zverdhur nga zyra dhe në fund të shkallëve të Komitetit Ekzekutiv më shpërthyen lotët.

E tregova këtë histori timen, se në këto kushte qe njohja ime me Skënder Calën, këtë artist të madh dibran.

Kaluan tre a katër vite dhe unë çdo ditë po e vuaja luftën e klasave. Me anën e një bashkëfshatarit tim, që kishte biografi të mirë mora vesh se Peshkopia do të dërgonte në vitin 1974

një kontigjent punëtorësh në Hydrocentralin e Fierzës. E dija që autoritetet partiake e vendore të Katër Grykëve nuk më lejonin që të bëhesha pjesë e këtij kontigjenti. Kuturu u nisa për Peshkopi, *tafti-bafti*, siç thotë populli. Duke ecur bulevardit të Peshkopisë, takoj rastësisht Skënder Calën me gjithë bashkëshorten e tij, shkodranen e bukur, aktoren e talentuar, Ferin. Ajo ishte zemërmirë siç kishte pamjen. Mbasi u përshëndetëm me çiftin e bukur Cala, Skënderi më pyeti: - “Çfarë halli të ka pru në Peshkopi or Besim?”

Ju përgjigja me zë të dridhur dhe tan emocion: “Mua për biografi nuk më dërguan në shkollë, punë s’më japin, më luftojnë për biografi. Desha të iki të punoj në Fierzë. Në dorë e ka Luan Shehu, shefi i Zyrës së Punës”.

“Luanin... e ka Neri në prova e ia bën Nerit ai këtë nder”, - ishin këto fjalët e bukuroshes shkodrane që më bënë mua të më kthehej besimi se do të shkoja të punoja në Fierzë. Skënderi mbasi u mendua pak, me atë atë zemër të pastër e fisnike, më thotë: “Mos u mërzi se e rregulloj unë”. Dhe një ditë pas këtij takimi të rastësishëm me artistët e mirënjohur dibranë, Feriha e Skënderi Cala (falë kontributit dhe dashamirësisë së Skënderit), unë u nisa për të punuar në Hydrocentralin e Fierzës.

U ndamë me Artistin e madh në vitin 1974, kur falë tij unë i shpëtova urretjes së luftës së klasave në Katër Grykët dhe vazhdova jetën e nëndheshme të tuneleve me një peng: që nuk më lejuan të bëhesha aktor. Ai peng do të më shoqërojë deri në botën e amshuar.

Jeta ime do të vazhdonte tuneleve të hidrocentraleve për biografi. Ndërsa artisti i madh, nën trysninë ideologjike të diktaturës do të luftonte natë e ditë për të rritur dhe bërë prezent artin e kulturën dibrane, jo vetëm brenda vendit, por dhe jashtë tij...

Do të kalonin shumë kohë..., deri sa një ditë të bukur të vitit 2013, u takova me personalitetin e madh dibran Skenderi Cala. Tani nuk ndahemi më... Ishte po ai Skënderi i dashur dhe

impulsiv ndaj padrejtsisë...

Për të hartuar këtë portret, nuk u nisa nga mendimi se kam për të thënë mendime e vlerësime të pathëna për të, sepse në këtë drejtim mund të ndihmoj shumë pak. Them *shumë pak*, sepse vlerat e tij të shumëanëshme i kanë vënë në dukje intelektualët e kulturës dhe artit shqiptar. Shtysa kryesore për ta shkruar këtë opinion ka qenë dëshira ime që për të tillë njerëz, me vlera të veçanta, duhet shkruar vazhdimisht, derisa vlerat e tyre të përvetësohen nga shumë e shumë shqiptarë, kudo ku jetojnë, që të arrijmë edhe ne të krijojmë një shoqëri të iluminuar siç e kanë vendet e Bashkimit Europian, ku synojmë të arrijmë.

Artisti i madh Skënder Cala është një personalitet i kompletuar, i pedagogut, studiuesit shkrimtarit, regjisorit, aktorit, këngëtarit, baritonit dhe politikanit. Ai është një figurë shumëdimensionale e kulturës, letërsisë, aktrimit, muzikës dhe veprimtarisë së tij atdhetare në shërbim të demokracisë dhe kombit. Po ashtu, pjekuria dhe humanizmi i tij janë të një niveli të rrallë, që përbëjnë një pasuri të madhe, në disa fusha të trashëgimisë kulturore, letrare e artistike. Shkrimet e tij për dënimin e krimeve të komunizmit dhe ndërgjegjësimin që ai vendos në këto shkrime, na mësojnë se kujtesa dhe dënimi i këtyre krimeve nuk duhet të kryhen rrallë e për mall, por sa më shpesh, derisa ndërgjegjja e popullit shqiptar ta dënojë të keqen.

Për veprimtarinë e tij në ngritjen e institucioneve të kulturës dhe artit dibran, si teatrin profesionist dhe jehonën që ua dha këngëve të trevës së Dibrës, si brenda vendit dhe jashtë shtetit, për kontributin që dha për demokracinë në Dibër, S.Cala meriton të quhet *Institucion i mëvetësishëm i artit dhe kulturës dibrane*.

Rinia e mendimit të artisti i madh, nuk ka moshë në tërë atë udhë të gjatë; jetë plot mund, përpjekje, paepuri e përkushtim, kur vuajtjet e shpirtit për dinjitet njerëzor, në botën e errësirës

dhe diktatit, ia kalitën që herët karakterin e lartë, shëndërruan rrjedhën e kohës në personalitet shqiptar me peshë. Te artisti Skender Cala mishërohen, jo vetëm fitimtari, demokrati, atdhetari, humanisti dhe intelektual i vizionar plot urtësi, por dhe ndershmëria e guximi, si bir i denjë i kombit dhe Dibrës sonë të dashur. Dhe po e mbyll këtë shkrim me urimin e Nolit të madh: "*Paç uratën e perendisë o Skënder Cala!*"



Besim Ndrejoni dhe Skënder Cala

Epilog

Dibra e kishte zbutur e burrëruar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë dibranët

...Vite më pas, kur gjërat kishin ndryshuar dhe S.Cala ishte bërë me emër në Dibër e në gjithë Shqipërinë si artist, takoi një njeri të shkolluar, të mençur, e fjalëpakë.

Ai ishte Hazis Ndreu. Të zhbironte me sytë e tij të kthjellët, të thellë, të mëdhenj, e mjaft shprehës. Pasi kishin ndenjur ca kohë bashkë e u miqësuaam, teksa i tregoi ëndrrën e frikshme, që kishte parë natën e parë të kthimit nga Tirana për në vendlindjen e të parëve të tij, i kërkoi bashkëbiseduesit t'ia interpretonte atë ëndërr.

- Dëgjo Skënder, - i tha me atë zërin e tij të plotë e të magjishëm, - ti ke hequr shumë e persëri s'do të hiqen të këqiat. Do të kesh përplasje në jetë për të drejtën, por do të vuash e atë s'ke për ta gjetur. Skënder, mos u rrek të largohesh nga ky vend se kurrë s'do ta realizosh edhe pse je djalë i zoti dhe i talentuar. Dibra të ka bërë magji dhe nga kjo magji s'do shpëtosh.



B. Cala, Gjen. Parllaku, S. Cala, H. Rama, promovim libri

Dhe ikën vitet një nga një, herë të mbara e herë të prapa, herë me shpresa të vakura e herë merrte zjarr se Zoti do ia çelte udhën për të shkuar në Tiranë, aty ku kishte dëshirë të shpërfaqte punën dhe talentin e tij...

Nisën t'i dalin rrudhat e t'i ashpërsohej portreti. Thellë në vetvete ndiente se po plakej bashkë me qytetin, me bulevardin me pemët e blirit, me pallatet që po rrjepeshin nga koha.

Dashurinë e qytetit e ndiente më shumë, edhe të njerëzve gjithashtu.

Bashkëudhëtarë të Skëndër Calës në rrugëtimin drejt artit ishin dy dashuri të mëdha, Korabi hijerëndë dhe Drini plak që e kishte zbutur e burrëruar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë dibranët.

Në këtë rrugëtim të gjatë, ai gjeti frymëzimin për këngët, që u bënë aq të dashura për artdashësit, jo vetëm dibranë, por nga e gjithë Shqipëria dhe nga hapësira mbarëshqiptare në botë.



Me artistët G. Radoja e R. Ndrenika



Me artistët M. Kabashi e R. Ndrenika



Promovim Libri, nga H. Rama



Gjatë ceremonisë së dekorimit të S.Calës me titullin “Mjeshtër i Madh”



Me Artistin e Popullit Sulejman Pitarka



S.Cala në rolin e Skënderbeut te tragjedia “Ai vdiq në këmbë”



Kursi i diplomës së Skënderit dhe pedagogët



*Brigada Kulturore, 1966. (Lurë - Guri i Bletës - Vlashaj - Lajthizë)
Ndër të tjerë, S. Cala, Çesk Zadeja, Halil Shoti, Shqipe ?,
Natasha Spiro, Dervish Biba, Rifat Poga, Faiku nga Elbasani*



Grupi i pleqve të Krujës, i ftuar në Peshkopi



Në Parkun e Liqenit Artificial, Tiranë



*Në promovimin e librit
"Lutfi Ndreu, mësues dhe artist"*



*Gjatë ceremonisë së dekorimit të S. Calës me Titullin
“Mjeshtër i Madh”*



*Me Heroin e Popullit Rrahman Parllaku
dhe autorin e librit Halil Rama*



S. dhe F. Cala, Zef Çoba, Haki Vleshi



Mbrojtje diplome "Për ata që janë në detë"



Me petagogun Pjetër Gjoka, në "Halili dhe Hajria"



Skeç, Skarra, Vladi, Cala

Curriculum Vitae



Skënder S. Cala u lind në Tiranë më 5 nëntor 1939. Mësimet e para i mori në vendlindje.

Në 1954 familja shpërngulet në Dibër.

1954-1956: Mësues, edhe pse 15 vjeç, në Ndërshen Reç, Fushë-Lurë, Arras, Vilë Dardhë.

1956-1960: Mbaron gjimnazin e punonjësve të arsimit në Tiranë.

1960-1961: Mësues në të parën shkollë fillore në Sorricë të Dibrës.

1961-1963: Këngëtar në Estradën profesioniste në Peshkopi dhe mësues në shkollën “Demir Gashi”.

1963-1967: Diplomohet aktor në Institutin e Lartë të Arteve “A. Moisiu”, Tiranë.

1967-1968: Diplomohet si oficer rezervë në kursin 6-mujor, Burrel.

1968-1969: aktor dhe këngëtar në Estradën Profesioniste, Peshkopi

1970-1971: Mbaron kursin për regjisor teatri.

1971-1984: Regjisor i Shtëpisë së Kulturës Peshkopi.

1984-1992: Regjisor i Teatrit Profesionist Peshkopi.

1991: Së bashku me një grup intelektualësh formon degën e Partisë Republikane, Peshkopi.

1992-1995: Në zgjedhjet e para pluraliste zgjidhet si n/kryetar i të parit pushtet demokratik të Dibrës.

1995-2000: Transferohet në Tiranë, si shef i sektorit të Artit, pranë Drejtorisë së Kulturës, Bashkia Tiranë.

2000: Del në pension. Së bashku me bashkëshorten dhe shoqen e jetës, për disa vite, hapin dhe administrojnë një librari të vogël.



Trupa profesioniste e Peshkopisë, 1986



Orkestrina e çiftelive, Peshkopi



Gjimnazisti S. Cala



Haziz Ndreu, Selim Alliu, S. Cala



Ansamblu Dibra në Turqi, 1982

Letër falënderimi!

Drejtuar zotit Halil Rama, autorit të librit⁹

Zoti Rama!
I nderuar mik!

Ju faleminderit!

Vepra juaj - të bëhet një investim ekonomik-intelektual pa asnjë lloj mundësie përfitim në sfond - flet sa vetë jeta. Aq më shumë kjo, në kuptimin e mundësisë ekonomike të jetesës - nga një njeri i zakonshëm. Realisht, unë nuk di, qoftë dhe një të vetëm rast të tillë si xhesti juaj. Keni faktuar që jeni apostull i oshtimës së vuajtjes dhe dhimbjes fisnike. Me veprën tuaj jeni ngjitur afër provanisë.

I nderuar mik!

Nën shtytjen e valës së emocionit të brendshëm, një mori pyetjesh dhe ankimesh më vërshojnë me aq vrull drejt gojës.

Përballë jush, si pronarët e *sarajeve të Plutonit*, qëndron këshilli bashkiak Dibër - jep tituj me prapaska të ndyra dhe bën "qytetar nderi" Kryeministrin, duke dëftuar që shprehja e At Zef Pllumit "*Kaq shumë rrugaçë paska nxerrë ky popull i vogël*", është e vërtetë. Ky këshill bashkiak më ka krijuar një lëmsh diku brenda, një lëmsh që sa më shumë më rritet ndijimi i pështirosjes për ta, aq më lart më ngjitet në grykë.

⁹ Libri për Skënder Calën është shkruar dhe botuar nga Halil Rama, pa asnjë përfitim financiar, përveç sponsorizimeve modeste nga dy miq të nderuar të tij. Zoti Cala, sot është thjeshtë një pensionist i zakonshëm, ndërsa z. H. Rama, me këtë monografi e përjetëson Artistin - "Mjeshtër i Madh", në Panetonin e Vlerave.

Jeta njerëzore nuk është gjë tjetër veçse bashkim i përkohshëm i shpirtit me materjen; por, fatkeqësisht, ndodh që shpirti në vend që të bashkohet normalisht me një materje, ai rrënohet duke rënë në një gërmadhë, me të cilën mbyll atë *cikël*. Na prekën në sedër miku im! Por nuk është vetëm kaq; duke na veshur me turpin, i cili nga natyra është përvëlues, na kanë shkaktuar dhe dhimbje. Duke udhëtuar drejt të njëjtit hiç, sa larg jeni prej tyre miku im!, prej atyre që jeni mbrytur nga balta e të njëjtës tokë.

I nderuar mik!

Libri, duke qenë jehona më besnike e zemrës së atij që e ka shkruar, është e vetmja provë e shpirtit delikat që ka rrëmuar ndër thesaret më të pasura të dashurisë njerëzore dhe që bashkërron me kënaqësinë e të tjerëve. Aq më shumë kjo, sot, kur po përjetojmë fatkeqësinë më të madhe njerëzore - të mos ndjerit e dashurisë.

Shpejtësia e shkëmbimit të ndjesive në zemër, e cila është foleja e vetme e shpirtit, na bind se sa e shkurtër është jeta. Por ju, i nderuar mik, me këtë veprim, në këtë *shkurtesë kalimtare*, ia keni arritur të ndezni një flakë të vogël që xixëllon, e cila pret erën që t'i fryjë për ta gjallëruar; që të shuaj, sado pak, varfërinë shpirtërore që po kultivojmë. Duke të uruar si *primum agmen*, le të shpresojmë, që në këtë mision, të mos jesh *Unkasi i mohikanëve*.

R. Kica, redaktori i librit.
Shtator, 2019.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rama, Halil

Skënder Cala : “Mjeshtër i Madh” në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare : monografi / Halil Rama ; red.

Ramazan Kica. – Tiranë : M & B, 2019

200 f. : me foto ; 14.5 x 20.5 cm.

ISBN 978-9928-256-95-9

I.Cala, Skënder për atë

1.Arti shqiptar 2.Artistë 3.Biografia 4.Shqipëri

7. 071(496.5) (092)





929(496.5) [Cala, Skënder]



“Kontributi i jashtëzakonshëm i Skënder Calës për artin tonë kombëtar, vepra e tij, janë një shëmbëlltysë e pashoqe, që ka lënë gjurmë të thella në mbresat e çdo shqiptari dhe jam i bindur që do të vazhdojë të jetojë brez pas brezi si një dëshmi e artit, kinematografisë dhe folklorit shqiptar.”

BUJAR NISHANI

BOTIME TE AUTORIT



BOTIMET M&B

ISBN 978-9928-256-95-9



9 789928 256959 >

ÇMIMI : 700 Lekë